



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO



KËSHILLI PROKURORIAL I KOSOVËS
TUŽILAČKI SAVET KOSOVA - KOSOVO PROSECUTORIAL COUNCIL

RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2023

Prishtinë, 2024

Këshilli Prokurorial i Kosovës

Raporti i punës për vitin 2023



© Këshilli Prokurorial i Kosovës 2024

Publikuar nga Këshilli Prokurorial i Kosovës. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Përmbajtja e këtij materiali nuk mund të rishtypet, shumëzohet ose përcjellët në çfarëdo forme tjetër elektronike, mekanike, të fotokopjohet ose regjistrohet pa miratimin me shkrim nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.



SHKURTESAT

KËSHILLIKëshilli Prokurorial i Kosovës
PSHProkurori i Shtetit
ZKPSHZyra e Kryeprokurorit të Shtetit
PAProkuroria e Apelit
PSRKProkuroria Speciale e Republikës së Kosovës
PTHProkuroria Themelore
DKRDepartamenti i Krimeve të Rënda
DMDepartamenti për të Mitur
DPDepartamenti i Përgjithshëm
SekretariatiSekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës
NjësitiNjësiti për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorive
ZMNVZyra për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave



Përmbajtja

I. PJESA E PARË	7
Përmbledhje ekzekutive	7
1. Vizioni.....	8
2. Misioni	8
3. Mandati i Këshillit.....	8
II. PJESA E DYTË	9
4. Aktivitetet e Këshillit	9
4.1. Rekrutimi i prokurorëve të Shtetit.....	9
4.2. Procesi i përzgjedhjes së Kryeprokurorit të Prokurorisë Speciale dhe Kryeprokurorëve të prokurorive themelore të Prishtinës dhe Gjakovës.....	10
4.3. Monitorimi i Planit strategjik të sistemit prokurorial 2022-2024.....	10
4.4. Transferimi dhe avancimi i prokurorëve.....	11
4.5. Disiplinimi i prokurorëve	11
4.6. Trajnimi i prokurorëve	12
4.6.1. Zyra e Kryeprokurorit Shtetit.....	14
4.6.2. Prokuroria e Apelit	15
4.6.3. Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës.....	15
4.6.4. Prokuroria Themelore e Prishtinës	16
4.6.5. Prokuroria Themelore e Prizrenit	16
4.6.6. Prokuroria Themelore e Pejës.....	17
4.6.7. Prokuroria Themelore e Mitrovicës.....	17
4.6.8. Prokuroria Themelore e Gjakovës	18
4.6.9. Prokuroria Themelore e Ferizajt	18
4.6.10. Prokuroria Themelore e Gjilanit	19
4.7. Miratimi i akteve nënligjore, strategjive dhe dokumenteve të tjera	19
4.8. Miratimi i vendimeve	20
4.9. Aktivitetet e Kryesuesit të Këshillit	20
4.9.1. Takimet me partnerët ndërkombëtarë	20
4.9.2. Pjesëmarrja e Kryesuesit në konferenca dhe në tryeza.....	20
4.10. Puna e komisioneve të Këshillit	21
4.10.1. Komisionet e përhershme	21
4.10.1.1. Komisioni për Çështje Normative	22



4.10.1.2.	Komisioni për Buxhet, Financa dhe Personel	22
4.10.1.3.	Komisioni për Vlerësimin e Performancës së Prokurorëve	23
4.10.1.4.	Komisioni për Administrimin e Prokurorive.....	26
4.10.2.1.	Komisioni për Rekrutim.....	27
4.10.2.2.	Komisioni për Rishqyrtim.....	28
4.10.2.3.	Komisioni për Transferim dhe Avancim të Prokurorëve.....	28
4.10.2.4.	Paneli vlerësues për procesin e emërimit të Kryeprokurorëve	28
4.10.2.5.	Komisioni mbikëqyrës për monitorimin e rasteve të korrupsionit dhe krimeve ekonomike që rrjedhin nga Plani Strategjik i sistemit prokurorial 2022-2024.....	28
4.10.2.6.	Komisioni rekrutues për pozitën e shpallur për Drejtor të Përgjithshëm të SKPK-së dhe Drejtor të NJSHPP-së.....	29
4.10.2.7.	Komisioni për Rishqyrtim për pozitën Drejtor i Përgjithshëm i SKPK-së dhe Drejtor i NJSHPP-së.....	29
III.	PJESA E TRETË	30
5.	Buxheti i Këshillit.....	30
5.1.	Ndryshimet Buxhetore gjatë vitit 2023	31
5.2.	Realizimi i buxhetit për vitin 2023.....	32
5.3.	Paraqitja e shpenzimeve për të gjitha programet dhe kategoritë ekonomike	33
5.3.1.	Paga dhe mëditje	33
5.3.2.	Mallra dhe shërbime.....	34
5.3.3.	Shërbime komunale	37
5.3.4.	Investime kapitale	38
5.4.	Të hyrat.....	41
5.5.	Donacionet	41
IV.	PJESA E KATËRT	42
6.	Bashkëpunimi me institucione dhe organizata të tjera.....	42
V.	PJESA E PESTË	43
7.	Raporti vjetor i punës së Prokurorit të Shtetit për vitin 2023	43
7.1.	Kallëzimet – lëndët penale në punë.....	43
7.2.	Lëndët e bartura nga viti 2022 në vitin 2023	45
7.3.	Lëndët e pranuar gjatë vitit 2023.....	46
7.4.	Lëndët e zgjidhura	47
7.5.	Lëndët e pazgjidhura.....	50



7.6.	Lëndët në punë, të zgjidhura dhe të pazgjidhura	50
7.7.	Krahasimi i lëndëve të pranura dhe të zgjidhura mes vitit 2022 dhe 2023	51
7.8.	Trajtimi i rasteve me procedura alternative dhe të veçanta.....	52
7.9.	Parashtruesit e kallëzimeve penale	53
7.9.1.	Parashtruesit e kallëzimeve penale të kryesve madhor të veprave penale (PP)	54
7.9.2.	Parashtruesit e kallëzimeve penale të kryesve të mitur të veprave penale (PPM)	54
7.10.	Kallëzimet penale sipas prokurorive	55
VI.	PJESA E GJASHTË	57
8.	Aktivitetet e Sekretariatit të Këshillit	57
8.1.	Zyra e Drejtorit	58
8.1.1.	Njësia e Auditimit të Brendshëm.....	59
8.1.2.	Njësia e Prokurimit	60
8.1.3.	Njësia për Komunikim Publik.....	62
8.1.4.	Njësia për Panele Hetimore	64
8.1.5.	Njësia për Integrim Evropian dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare	64
8.1.6.	Koordinatori i Komisioneve të Përhershme të Këshillit	65
8.1.7.	Zyrtari Certifikues.....	66
8.2.	Departamenti për Burime Njerëzore.....	66
8.2.1.	Divizioni për Paga dhe Shërbime të Prokurorëve.....	67
8.2.2.	Divizioni për Staf Administrativ.....	67
8.3.	Departamenti për Buxhet dhe Financa	68
8.3.1.	Divizioni për Buxhet dhe të Hyra.....	69
8.3.2.	Divizioni për Financa	70
8.4.	Departamenti për Administratë dhe Shërbime të Përgjithshme.....	70
8.4.1.	Divizioni për Arkivim	71
8.4.2.	Divizioni për Logjistikë dhe Mirëmbajtje	71
8.4.3.	Divizioni për Siguri dhe Transport	71
8.4.4.	Divizioni për Përkthim dhe Lekturim.....	72
8.5.	Departamenti për Teknologji Informative.....	72
8.5.1.	Divizioni i Infrastrukturës (rrjet dhe server).....	75
8.5.2.	Divizioni për Sisteme Elektronike (softuer)	77
8.6.	Departamenti Ligjor.....	78
8.7.	Projekti TIK/SMIL.....	79



VII. PJESA E SHTATË	83
9. Aktivitetet e Njësitit për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorisë.....	83
9.1. Zyra për Verifikim Prokurorial.....	83
9.1.1. Mbështetja e komisioneve të Këshillit.....	83
9.2. Zyra për Monitorim dhe Analitikë	84
9.2.1. Mbështetja e komisioneve të Këshillit.....	84
9.2.2. Hartimi i raporteve	84
9.2.3. Aktivitete të tjera	85
9.3. Zyra për Statistika	86
9.4. Zyra për Trajnime dhe Zhvillim Profesional	89
10. Sfidat	90

I. PJESA E PARË

Përmbledhje ekzekutive

Raporti i punës për vitin 2023 paraqet aktivitetet dhe veprimtarinë e zhvilluar njëvjeçare të Këshillit Prokurorial të Kosovës në kuadër të realizimit të vizionit dhe mandatit kushtetues dhe ligjor, si institucion i pavarur në ushtrimin e funksioneve të veta, me qëllim të sigurimit të një sistemi prokurorial të pavarur, profesional dhe të paanshëm.

Ky raport përbëhet nga pjesë të standardizuara të realizimit të punëve gjatë vitit 2023, të cilat pasqyrojnë aspekte të veçanta për Këshillin, me ç' rast në *pjesën e parë* apo *hyrëse* janë paraqitur vizioni, misioni, struktura, kompetencat dhe baza ligjore e funksionimit të Këshillit, kurse në *pjesën e dytë*, aktivitetet e Këshillit, si: rekrutimi i prokurorëve të Shtetit, përzgjedhja e Kryeprokurorëve të Prokurorisë Speciale dhe Prokurorive Themelore të Prishtinës dhe Gjakovës, transferimi dhe avancimi i prokurorëve, aktivitetet e Kryesuesit të Këshillit, hartimi dhe miratimi i akteve nënligjore (rregulloreve, udhëzimeve administrative dhe vendimeve), dokumentet strategjike dhe aktivitetet e trupave të Këshillit (komisioneve të përhershme dhe komisioneve ad hoc).

Raporti vjetor i punës për vitin 2023 i Këshillit, në *pjesën e tretë*, përmban të dhëna për buxhetin e sistemit prokurorial, me ç' rast vëmendje të veçantë kanë pasur shpenzimet për kategoritë e pagave dhe mëditjeve, mallrave dhe shërbimeve, shpenzimeve komunale dhe investimeve kapitale për të gjitha programet buxhetore të Këshillit.

Në *pjesën e katërt* të këtij raporti pasqyrohet bashkëpunimi vendor dhe ndërkombëtar.

Në *pjesën e pestë* është paraqitur Raporti vjetor i punës së Prokurorit të Shtetit për vitin 2023, i cili përfshin kallëzimet penale në punë, lëndët e bartura, lëndët e pranuar, lëndët e zgjidhura dhe të pazgjidhura, trajtimin e rasteve me procedura alternative dhe parashtruesit e kallëzimeve penale.

Gjithashtu, në vijimësi të *pjesës së gjashtë* prezantohen aktivitetet e Sekretariatit në kuadër të menaxhimit të burimeve njerëzore, buxhetit dhe financave, shërbimeve të përgjithshme, teknologjisë informative dhe komunikimit publik, si dhe Projekti TIK/SMIL. Ndër të tjera, në këtë dokument të rëndësishëm, në *pjesën e shtatë*, prezantohet edhe puna e Njësitit për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorisë, e cila ka në fokus mbështetjen e proceseve të shqyrtimit të performancës së prokurorëve, rekrutimit të prokurorëve, përpilimin e raporteve statistikore dhe analitike, mbikëqyrjen e regjistrave në prokurori dhe trajnimin e prokurorëve, ndërsa në fund janë paraqitur sfidat kryesore, me të cilat është ballafaquar Këshilli gjatë vitit 2023.

1. Vizioni

Vizioni i Këshillit është një sistem prokurorial që njihet për profesionalizëm, llogaridhënie, paanshmëri dhe që ka besim të lartë të qytetarëve të Kosovës që ofrohet nga shërbimi i prokurorisë, i cili është efikas, efektiv dhe etik.

2. Misioni

Misioni i Këshillit është sigurimi i sistemit të pavarur, të paanshëm, profesional dhe efektiv i hetimit dhe i ndjekjes penale nga prokurorë të rekrutuar në bazë të meritës, të vlerësuar në bazë të rezultateve në punë dhe të mbikëqyrur sipas standardeve të larta, i cili siguron zbatimin e ligjit në mënyrë të drejtë e pa dallime dhe i trajton në mënyrë meritore viktimat e krimit.

Këshilli Prokurorial i Kosovës do të ofrojë mbikëqyrje, menaxhim, analiza, politika efektive dhe administrim të nivelit të duhur për të siguruar që Prokurori i Shtetit ka të gjitha burimet që i nevojiten për të ofruar një shërbim prokuroriale me performancë të lartë, llogaridhënese dhe të qasshme për qytetarët e Kosovës.

3. Mandati i Këshillit

Mandati i Këshillit buron nga Kushtetuta dhe ligji, që e përcaktojnë atë si një institucion të pavarur në ushtrimin e funksioneve prokuroriale.

Në muajin mars të vitit 2019 është miratuar Ligji nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, i cili ka përcaktuar detyrat, përgjegjësitë, organizimin dhe funksionimin e Këshillit Prokurorial të Kosovës.

Përgjegjësitë kryesore kushtetuese dhe ligjore të Këshillit janë si në vijim:

- a. Siguron që prokurorët të veprojnë në mënyrë të pavarur, profesionale dhe të paanshme gjatë kryerjes së të gjitha funksioneve prokuroriale;
- b. Vendos për organizimin, menaxhimin, administrimin dhe mbikëqyrjen e funksionimit të prokurorive sipas ligjit përfshirë edhe numrin e prokurorëve në secilin prokurori;
- c. Rekruton dhe propozon te Presidenti kandidatët për emërim dhe riemërim për prokurorë dhe kryeprokurorë përfshirë edhe Kryeprokurorin e Shtetit;
- d. Përgatit, dërgon dhe mbikëqyrë buxhetin e Prokurorit të Shtetit dhe Këshillit Prokurorial;
- e. Në bashkëpunim me Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit zhvillon politikat dhe strategjitë prokuroriale për luftimin efektiv të kriminalitetit;
- f. Vlerëson, ngritë në detyrë, disiplinon, shkarkon, transferon dhe ofron mbështetje për trajnimin e prokurorëve;
- g. Zhvillon standardet për rekrutimin, organizimin dhe shpalljen e provimit për kualifikimin e prokurorëve;
- h. Miraton aktet nënligjore në funksion të zbatimit të detyrave dhe përgjegjësi të tij, në pajtim me legjislacionin në fuqi;

- i. Përgatitë raport vjetor për veprimtaritë dhe shpenzimet e Prokurorit të Shtetit dhe Këshillit si dhe raporton para publikut për zbatimin e objektivave të saj të përcaktuara në mënyrë specifike dhe të bazuar në indikatorë të matshëm.

II. PJESA E DYTË

4. Aktivitetet e Këshillit

Këshilli ka përmbushur mandatin e vet ligjor gjatë vitit 2023 përmes organizimit të takimeve të rregullta, në të cilat janë marrë vendime të ndryshme për procesin e rekrutimit, transferimit, avancimit të prokurorëve, procedurave të disiplinimit dhe procesit të vlerësimit të performancës së prokurorëve, si dhe përmes zhvillimit të aktiviteteve tjera të trupave të Këshillit.

Në këtë aspekt, Këshilli ka menaxhuar buxhetin vjetor të dedikuar për sistemin prokurorial të Kosovës, është angazhuar në përmirësimin e kushteve infrastrukturore për prokurorët dhe për stafin mbështetës, si dhe ka ngritur kapacitetet profesionale të prokurorëve dhe stafit mbështetës, bashkëpunimit, propozimit, koordinimit dhe mbikëqyrjes së trajnimeve të ndryshme, përfshirë kryesisht Akademinë e Drejtësisë, por edhe partnerët vendorë dhe ndërkombëtarë.

Megjithatë, në radhën e aktiviteteve kryesore të Këshillit përgjatë vitit 2023 mund të përmendim: proceset e rekrutimit të prokurorëve, përzgjedhjen e Kryeprokurorëve të Prokurorisë Speciale, Prokurorisë Themelore të Prishtinës dhe Prokurorisë Themelore të Gjakovës, përzgjedhjen e Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe Drejtorit të Njësitit për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorisë, vlerësimin e performancës, disiplinimin, transferimin, avancimin e prokurorëve dhe zhvillimin e kapaciteteve.

Gjithashtu, trupat e Këshillit kanë zhvilluar aktivitete të ndryshme në kuadër të realizimit të mandatit të tyre dhe në shërbim të funksionimit dhe mbarëvajtjes së rregullt të sistemit prokurorial.

4.1. Rekrutimi i prokurorëve të Shtetit

Në vazhdim të procesit të filluar gjatë vitit 2022 për rekrutimin e njëzetedy (22) prokurorëve të rinj, në muajin mars 2023 janë dekretuar nga Presidentja njëzetënjë (21) prokurorë të rinj dhe kanë filluar trajnimin fillestar 1 vjeçar në Akademinë e Drejtësisë. Pas hyrjes në fuqi në qershor të vitit 2023 të Ligjit Nr. 08/L-167 për Prokurorin e Shtetit këta prokurorë kanë filluar të ngarkohen me lëndë edhe gjatë periudhës së trajnimit fillestar.

Në zbatim të transparencës publike, procesi i rekrutimit ka qenë i hapur dhe janë ftuar për monitorim partnerët ndërkombëtar, të gjitha mediumet dhe organizatat e shoqërisë civile. Ky proces është monitoruar nga përfaqësues të OSCE, EULEX dhe EUKOJUST.

4.2. Procesi i përzgjedhjes së Kryeprokurorit të Prokurorisë Speciale dhe Kryeprokurorëve të prokurorive themelore të Prishtinës dhe Gjakovës

Gjatë vitit 2023, Këshilli ka zhvilluar tri procese të emërimit të kryeprokurorëve të prokurorive të Republikës së Kosovës si: procesin e emërimit të Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Gjakovë, i shpallur në muajin gusht 2023, procesin e emërimit të Kryeprokurorit të Prokurorisë Speciale si dhe të Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë të shpallur në muajin tetor 2023.

Bazuar në Rregulloren 06/2019 për emërimin e Kryeprokurorit të Shtetit dhe kryeprokurorëve të prokurorive të Republikës së Kosovës si dhe plotësim ndryshimin e saj, Këshilli ka themeluar Panelet Vlerësuese dhe Komisionet për Rishqyrtim.

Këshilli ka publikuar koncept dokumentet e të gjithë kandidatëve si dhe intervistat janë zhvilluar në prani të partnerëve ndërkombëtarë si dhe përfaqësuesve të OJQ-ve.

Pas përfundimit të të gjitha procedurave duke përfshirë intervistimin, vlerësimin, poentimin, të drejtën në kundërshtim dhe vlerësimin e kundërshtimeve, Këshilli më 11 dhjetor 2023 votoi kandidatin z. Blerim Isufaj për emërim në pozitën e Kryeprokurorit të Prokurorisë Speciale, kandidatin z. Zejnullah Gashi për emërim në pozitën e Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë si dhe kandidatin z. Enis Gashi për emërim në pozitën e Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Gjakovë.

4.3. Monitorimi i Planit strategjik të sistemit prokurorial 2022-2024

Në fillim të vitit 2022, Këshilli Prokurorial i Kosovës kishte miratuar Planin Strategjik të sistemit prokurorial 2022-2024 dhe kishte themeluar Grupin Punues për monitorimin e zbatimit të këtij Plani. Ky grup gjatë vitit 2023 ka hartuar dhe dërguar në Këshill raportet për zbatimin e planit strategjik për periudhën janar – dhjetor 2022 dhe janar – qershor 2023.

Grupi monitorues gjatë monitorimit ka pasur këto të gjetura:

Për periudhën raportuese janar – qershor 2023 nga 164 aktivitetet e planifikuara 17 janë të përfunduara tërësisht, 108 janë përmbushur për periudhën raportuese, 5 janë në proces apo kanë pak zhvillime, 26 janë të planifikuara për periudhat e ardhshme raportuese dhe 8 nuk kanë zhvillime.

Gjatë pranimit të informatave dhe përpilimit të raportit, grupi punues ka dalë me disa rekomandime për aktivitetet për të cilat duhet të ndërmerren veprime për tu përmbushur duke pasur parasysh afatet kohore, si në vijim:

- Të trajtohet analiza e PSRK-së për zbatimin e Strategjisë për Krime të Luftës si dhe të merret qëndrim për iniciativën për hartim të Strategjisë së re apo jo;
- Të hartohet udhëzuesi me rekomandime për trajtimin e rasteve PPP;

- Të ndërmerren më shumë aktivitete për fuqizimin e Zyrës për Mbrojtje dhe ndihmë viktimave.
- Të zhvillohen aktivitete për zbatimin e Kodit të Etikës dhe trajnime në këtë drejtim.
- Të finalizohen aktivitetet për zbatimin e Rregullores për Veprimtarinë, Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Administratës së KPK-së;
- Të identifikohen aktivitetet nga njësitë përgjegjëse që kanë të bëjnë me ngritje të kapaciteteve (trajnime) për të cilat nuk është ndërmarrë ende veprime dhe të fillohet angazhimi në drejtim të përmbushjes së tyre;
- Të zhvillohen planet për kampanja informuese siç parashihen me këtë Plan;
- Të organizohen takime me media dhe shoqëri civile në drejtim të fuqizimit të komunikimit të ndërsjellët dhe aktiviteteve të përbashkëta.
- Të finalizohet Plani i reagimit emergjent.

4.4. Transferimi dhe avancimi i prokurorëve

Me qëllim të plotësimit të nevojave të prokurorive të Republikës së Kosovës dhe bazuar në analizat e hartuara nga Njësi të Shqyrtimit të Performancës së Prokurorive si dhe me mbështetjen e Komisionit për Administrimin e Prokurorive, Këshilli, përmes Komisionit për Transferim dhe Avancim të Prokurorëve, ka zhvilluar disa procese, si në vijim:

- Avancimin e gjashtë (6) prokurorëve të shtetit në Prokurorinë e Apelit, në dy procese të shpallura gjatë vitit 2023;
- Avancimin e dy (2) prokurorëve të shtetit në Prokurorinë Speciale;
- Avancimin e pesë (5) prokurorëve të shtetit në Departamentin për Krime të Rënda të Prokurorisë Themelore në Prishtinë;
- Avancimin e një (1) prokurori të shtetit në Departamentin për Krime të Rënda të Prokurorisë Themelore në Prizren;
- Avancimin e dy (2) prokurorëve të shtetit në Departamentin për Krime të Rënda të Prokurorisë Themelore në Prishtinë;
- Avancimin e dy (2) prokurorëve të shtetit në Departamentin për të Mitur të Prokurorisë Themelore në Prishtinë;

Gjithashtu, në kuadër të plotësimit të nevojave dhe kërkesave të Prokurorisë Themelore në Mitrovicë për arsye të numrit jo të mjaftueshëm të prokurorëve dhe si pasojë e gjendjes së krijuar në këtë prokurori, Këshilli përmes procesit të shpallur sipas Rregullores 02/2021 për Transferimin dhe Avancimin e Prokurorëve, gjatë vitit 2023 ka transferuar në mënyrë të përhershme dy (2) prokurorë nga Departamenti i Përgjithshëm i Prokurorisë Themelore në Ferizaj në Departamentin e Përgjithshëm të Prokurorisë Themelore në Mitrovicë.

4.5. Disiplinimi i prokurorëve

Gjatë vitit 2023, Këshilli ka pranuar tetë (8) kërkesa për fillim të procedurës disiplinore ndaj prokurorëve nga autoriteti kompetent (kryeprokurorët e prokurorive) dhe ka themeluar shtatë (7) panele hetimore. Një panel hetimor ka zhvilluar hetimin për dy lëndë të bashkuara.

Këshilli, deri më tani, përmes paneleve hetimore, ka zhvilluar procedura disiplinore dhe ka shqiptuar këto masa disiplinore ndaj prokurorëve, të cilat kanë marrë formën përfundimtare:

Vendimet e Këshillit për lëndët e vitit 2023:

- Vërejtje jo publike me shkrim (me marrëveshje)
- Vërejtje publike me shkrim (me marrëveshje)
- Vërejtje jo publike ke shkrim (me raport)
- Vërejtje publike me shkrim (me raport)
- Ulje të pagës për 30% për një vit

Panelet hetimore janë duke i zhvilluar hetimet disiplinore për dy raste të vitit 2023.

Gjatë vitit 2023, Këshilli ka pranuar 72 njoftime dhe 72 vendime (18 hudhje dhe 54 refuzime) nga Autoriteti Kompetent.

Të gjitha vendimet e formës përfundimtare janë duke u publikuar në uebfaqen e sistemit prokurorial, përveç vërejtjes jopublike me shkrim, siç parashihet me ligj.


4.6. Trajnimi i prokurorëve

Gjatë vitit 2023, nga dyqind e dy (202) prokurorë, Akademia e Drejtësisë, në bashkëpunim me institucione të tjera ndërkombëtare, ka trajnuar njëqindetridhjetënjë (131) prokurorë të Shtetit në Programin e Trajnimeve të Vazhdueshme, dhe njëzetënjë (21) prokurorë në Programin e Trajnimit Fillestar. Nga numri i përgjithshëm i prokurorëve, në trajnime nuk kanë marrë pjesë pesëdhjetënjë (51) prokurorë. Akademia e Drejtësisë së Kosovës ka angazhuar nëntëmbëdhjetë (19) prokurorë në cilësinë e trajnuesve si dhe janë realizuar nëntëdhjetë (92) tema të trajnimit.


Disa nga temat që prokurorët i kanë ndjekur në trajnime të vazhdueshme lidhen me të drejtën penale materiale dhe atë procedurale, si: hetimi dhe ndjekja e rasteve të dhunës në familje, masat për sigurinë e pranisë së të pandehurit në procedurë, marrja në pyetje, shkathtësitë e përfaqësimit në gjykim, trafikimi i njerëzve dhe kontrabandimi i migrantëve, pastrimi i parave, krimi i organizuar, krimi kibernetik, korrupsioni, krimet ekonomike, etj. Po ashtu, prokurorët kanë marrë pjesë në trajnime me tema për liritë dhe të drejtat e njeriut të përcaktuara me legjislacionin vendor dhe ndërkombëtar, etikë profesionale dhe tema për zhvillim të shkathtësive të buta.

Trajnimet kryesisht janë realizuar nga Akademia e Drejtësisë dhe partnerët, si: Ambasada Amerikane, Ambasada Britanike, Këshilli i Evropës dhe UNDP-ja.

Në vijim pasqyrohen numri i përgjithshëm i prokurorëve dhe pjesëmarrja në trajnime të vazhdueshme:




Grafikoni 1: Pjesëmarrja e prokurorëve në trajnime të vazhdueshme




Grafikoni 2: Pjesëmarrja e prokurorëve në trajnim në të gjitha prokuroritë e Kosovës

4.6.1. Zyra e Kryeprokurorit Shtetit




Grafikoni 3: Pjesëmarrja në trajnime e prokurorëve të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit

4.6.2. Prokuroria e Apelit




Grafikoni 4: Pjesëmarrja në trajnime e prokurorëve të Prokurorisë së Apelit

4.6.3. Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës




Grafikoni 5: Pjesëmarrja në trajnime e prokurorëve të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës

4.6.4. Prokuroria Themelore e Prishtinës




Grafikoni 6: Pjesëmarrja në trajnime e prokurorëve të Prokurorisë Themelore të Prishtinës

4.6.5. Prokuroria Themelore e Prizrenit




Grafikoni 7: Pjesëmarrja në trajnime e prokurorëve të Prokurorisë Themelore të Prizrenit

4.6.6. Prokuroria Themelore e Pejës




Grafikoni 8: Pjesëmarrja në trajnime e prokurorëve të Prokurorisë Themelore të Pejës

4.6.7. Prokuroria Themelore e Mitrovicës




Grafikoni 9: Pjesëmarrja në trajnime e prokurorëve të Prokurorisë Themelore të Mitrovicës

4.6.8. Prokuroria Themelore e Gjakovës




Grafikoni 10: Pjesëmarrja në trajnime e prokurorëve të Prokurorisë Themelore të Gjakovës

4.6.9. Prokuroria Themelore e Ferizajt



Grafikoni 11: Pjesëmarrja në trajnime e prokurorëve të Prokurorisë Themelore të Ferizajt

4.6.10. Prokuroria Themelore e Gjilanit



Grafikoni 12: Pjesëmarrja në trajnime e prokurorëve të Prokurorisë Themelore të Gjilanit

Në këtë kontekst, në kuadër të bashkëpunimit me Akademinë, Këshilli ka hartuar dokumentin “Politikat e trajnimit për prokurorë dhe stafin administrativ të sistemit prokurorial” dhe Planin e nevojave për trajnimin e prokurorëve dhe stafit administrativ, me anë të të cilit është kërkuar nga Akademia që të përgatisë programe trajnimi adekuate dhe të ftojë prokurorë në trajnime sipas specifikave.

4.7. Miratimi i akteve nënligjore, strategjive dhe dokumenteve të tjera

Në kuadër të ndryshimeve ligjore të ndërlidhura me sistemin prokurorial si dhe Planit të punës për vitin 2023, Këshilli, ka hartuar dhe miratuar akte nënligjore.

Gjatë vitit 2023, Këshilli ka miratuar gjashtë (6) rregullore, si në vijim:

1. Rregullore Nr. 01/2023 për Komisionin Këshillëdhënës për Etikën e Prokurorëve;
2. Rregullore Nr.02/2023 për Veprimtarinë, Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Administratës në Këshillin Prokurorial të Kosovës;
3. Rregullore Nr. 03/2023 për Shtesat dhe Kompensimet për të Punësuarit në Sistemin Prokurorial;
4. Rregullore Nr.04/2023 për Plotësimndryshimin e Rregullores Nr.06/2019 për Emërimin e Kryeprokurorit të Shtetit dhe Kryeprokurorëve të Prokurorive të Republikës së Kosovës;
5. Rregullore Nr. 05/2023 për Organizimin e Brendshëm dhe Funkcionimin e Prokurorit të Shtetit të Kosovës dhe
6. Rregullore Nr.06/2023 për Qasje në Dokumente Publike.

Këshilli po ashtu ka miratuar edhe udhëzuesin si në vijim:

1. Udhëzim 01/2023 për Hartimin e Akteve Normative të KPK-së.

Në hartimin e këtyre akteve nënligjore janë angazhuar komisionet dhe trupat e tjerë ndihmës të Këshillit dhe Sekretariatit si dhe me mbështetjen e partnerëve ndërkombëtarë.

4.8. Miratimi i vendimeve

Këshilli, gjatë vitit 2023, ka mbajtur 14 takime dhe ka marrë 208 vendime nga fushëveprimtaria e vet. Këto vendime kanë të bëjnë me rekrutimin, transferimin dhe avancimin e prokurorëve, disiplinimin dhe vlerësimin e performancës së prokurorëve, administrimin e prokurorive, menaxhimin e buxhetit, miratimin e dokumenteve strategjike dhe planeve të punës, procesin e integriteteve evropiane dhe vendime të tjera të cilat i përkasin bashkëpunimit institucional.

4.9. Aktivitetet e Kryesuesit të Këshillit

Gjatë vitit 2023, duke u bazuar në kompetencat ligjore për përfaqësimin e Këshillit para publikut, institucioneve vendore dhe ndërkombëtare, Kryesuesi i Këshillit ka zhvilluar veprimtari përfaqësuese, si: takime, vizita dhe ka marrë pjesë në konferenca, vizita studimore dhe tryeza të ndryshme.

4.9.1. Takimet me partnerët ndërkombëtarë

Kryesuesi i Këshillit ka pasur takime të rregullta me përfaqësuesit e Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë, në kuadër të frymës së bashkëpunimit dhe mbështetjes, të cilat shteti amerikan i ofron gjithnjë për sistemin prokurorial në Kosovë.

Kryesuesi ka zhvilluar takime edhe me përfaqësues të institucioneve të tjera ndërkombëtare, si: të Zyrës së BE-së në Prishtinë, Ambasadës së Mbretërisë së Bashkuar, UNDP-së dhe agjencive të tjera të Kombeve të Bashkuara, EULEX-it, Ambasadës së Norvegjisë, Ambasadës së Holandës, Këshillit të Evropës, USAID-it, OSCE-së, GIZ-it etj.

Gjatë këtyre takimeve është biseduar për projektet e ndryshme në mbështetje të sistemit prokurorial të Kosovës, të cilat realizohen në kuadër të financimit dhe përkrahjes së institucioneve të lartcekura.

4.9.2. Pjesëmarrja e Kryesuesit në konferenca dhe në tryeza

Në përmbushje të mandatit për përfaqësim të Këshillit, Kryesuesi ka marrë pjesë edhe në konferenca dhe në tryeza pune, si në vijim, në:

- Konferencën Vjetore të Prokurorëve;
- Takimet tremujore të Komitetit Drejtues të Projektit EUKOJUST;
- Takimet e Këshillit për Demokraci dhe të Drejtat e Njeriut;
- Konferenca për krim kibernetik;
- Takim me delegacionin e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës;
- Programi MFK-së për Qeverisje Transparente dhe Përgjegjëse TAG;
- Tryezë diskutimi për mekanizmin kombëtar për parandalimin e torturës;

- Konferenca “Të bashkuar për drejtësi” (USAID-MD);
- Takim- Projekti kundër Krimet Ekonomik në Kosovë (PECK III);
- Takim me ekspert të CEPEJ/CCPE, në kuadër të projektit Bashkimi Evropian-Këshilli i Evropës KoSEJ III;
- Takim i Grupit Punues për Vlerësimin e Performances se Gjyqtarëve dhe Prokurorëve (KGJK-KPK);
- Takim i organizuar nga ambasada amerikane lidhur me ndërmjetësimin;
- Mbledhja e pestë e KMIE;
- Takim me OPDAT, “Koordinimi Ndërinstitucional në luftimin e trafikimit me njerëz”;
- Takim me Ambasadorin Britanez lidhur me Proceset e Rekrutimit të Kryeprokurorit të PSRK dhe Kryeprokurorit PTH Prishtinë;
- Takim me Agjencinë për Informim dhe Privatësi lidhur me ngritjen e transparencës në Sistemin Prokurorial përmes qasjes në dokumente publike;
- Takim me delegacionin nga Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës, lidhur me aplikimin e Kosovës në Këshillin e Evropës;
- Punëtori e organizuar nga KÇN, lidhur me hartimin i Rregullores për Organizimin e Brendshëm dhe Funksionimin e Prokurorit të Shtetit;
- Takim lidhur me prezantimin e “Udhëzuesit për Konfiskim në Kosovë”;
- Takim me përfaqësuesit e OSBE-së, lidhur me rastet e monitoruara të krimit të organizuar dhe korrupsionit për periudhën korrik 2021 – qershor 2023;
- Konferencë: Dita e Konkurrencës 2023: Përfitimet e konkurrencës së drejtë në Kosovë
- Punëtori: Metodologjia CEPEJ për ngritjen e efikasitetit të Gjykatave Dhe Zyrave Prokurorisë në bazë të raporteve statistikore dhe dashbordeve në SMIL;
- Takim me përfaqësues nga donator Norvegjez për SMIL;
- Punëtorja e Grupit Punues për hartimin e strategjisë për komunikim publik në sistemin prokurorial;
- Takimi i parë i Komitetit Drejtues të përfituesve të Programit “Horizontal Facility III”;
- Takim me përfaqësues të EUKOJUST dhe zyrës së BE-së, lidhur me Mundësinë e përkrahjes për zbatimin e sistemeve elektronike.

Në kuadër të përfaqësimit të prezantuar më lart, Kryesuesi ka adresuar në vazhdimësi pikëpamjet, punën e Këshillit dhe zhvillimet në sistemit prokurorial, në varësi të agjendave të këtyre forumeve.

4.10. Puna e komisioneve të Këshillit

Këshilli realizon mandatin e vet përmes komisioneve të përhershme dhe atyre që themelohen për një mandat të caktuar – ad hoc. Në vijim do të paraqesim punën e komisioneve gjatë vitit 2023.

4.10.1. Komisionet e përhershme

Të gjitha komisionet e përhershme, të cilat funksionojnë në kuadër të Këshillit kanë rregullat e tyre të punës dhe fushëveprimtarinë e ushtrojnë në pajtim me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, Planin Strategjik të sistemit prokurorial 2022-2024, Planin e punës së Këshillit dhe planet e punës së komisioneve.

4.10.1.1. Komisioni për Çështje Normative

Gjatë vitit 2023, Komisioni ka mbajtur 41 takime, ku përveç anëtarëve të Komisionit kanë marrë pjesë edhe përfaqësues nga organizatat ndërkombëtare që mbështesin punën e Komisionit dhe të sistemit prokurorial në përgjithësi dhe përfaqësues të shoqërisë civile. Po ashtu, takimet e Komisionit janë mbështetur nga Sekretariati i Këshillit. Komisioni ka organizuar edhe dy punëtori për hartimin e draftrregulloreve.

Komisioni ka trajtuar çështjet lidhur me bazën juridike për aktet nënligjore dhe dokumentet e tjera normative, para miratimit të tyre në Këshill, përkatësisht, nëse ato janë në pajtueshmëri me ligjet në fuqi dhe rregulloret ekzistuese të Këshillit dhe gjatë hartimit të akteve ka shqyrtuar çështjet që lidhen me metodologjinë dhe teknikën unike të hartimit. Për më tej, Komisioni ka bashkërenduar punët edhe me komisionet e tjera të Këshillit për t'i harmonizuar dhe unifikuar procedurat e punës dhe organizimit të tyre.

Komisioni ka bashkërenduar aktivitetet për hartimin e akteve me partnerët ndërkombëtarë, konkretisht me: Ambasadën e Amerikës, Ambasadën e Mbretërisë së Bashkuar, përfaqësuesit e Bashkimit Evropian dhe shoqërinë civile, të cilët kanë dhënë kontributin e tyre profesional për draftimin e akteve.

Në kuadër të transparencës me publikun në draftimin e akteve nënligjore, Komisioni ka aplikuar dëgjimin publik përmes publikimit të akteve në uebfaqen zyrtare të Këshillit Prokurorial, për të pranuar komentet nga përfaqësuesit ndërkombëtarë, shoqëria civile dhe profesionistët e fushës.

4.10.1.2. Komisioni për Buxhet, Financa dhe Personel

Komisioni për Buxhet, Financa dhe Personel ka realizuar 7 takime pune gjatë vitit 2023, me ç' rast ka trajtuar çështje të ndryshme për buxhet, financa dhe personel si në vijim:

- Komisioni ka aprovuar plotësimin dhe ndryshimin e planit të personelit për vitin 2023
- Komisioni ka shqyrtuar dhe miratuar raportin vjetor financiar për vitin 2022, si dhe ka shqyrtuar projektet kapitale të vitit 2023.
- Komisioni ka shqyrtuar kornizën afatmesme të shpenzimeve dhe e ka aprovuar me ndryshimet lidhur me numrin shtesë të prokurorëve dhe stafit administrativ si dhe shpërndarjen e numrit të kërkuar në tri vite të ardhshme.
- Komisioni ka shqyrtuar dhe aprovuar raportet financiare sipas programeve dhe kategorive ekonomike në baza tremujore. Gjithashtu, komisioni ka shqyrtuar kërkesën për shpalljen e pozitave të lira të sistemit prokurorial.
- Komisioni ka shqyrtuar kërkesën buxherore për sistemin prokurorial për vitin 2024 si dhe vlerësimet e hershme për vitet 2025-2027. Në kuadër të kësaj, u diskutuan nevojat për mbështetjen buxhetore, të cilat janë prezantuar nga të gjitha nivelet e prokurorive të vendit, si dhe mënyrat e arsyetimit sa më të mirë të Kërkesës buxhetore, sidomos për pjesën që kalon kufirin e përcaktuar nga Ministria e Financave. Për më tej,

- Është arsyetuar kërkesa mbi kufijtë buxhetorë (është kërkuar rritja e numrit të punëtorëve për 200 pozita për periudhën 2024-2026, ku vetëm për vitin 2024 janë kërkuar 171 pozita (24 prokuror dhe 147 nëpunës civil), rritja e buxhetit në kategorinë e pagave dhe mëditjeve për 1,692,165€, si dhe rritja e buxhetit në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve për 1,238,729€);
- Është miratuar kërkesa buxhetore nga Këshilli Prokurorial i Kosovës;
- Kërkesa është dërguar në Kuvendin e Kosovës si dhe në Ministrinë e Financave dhe Transfereve.
- Komisioni ka shqyrtuar dhe aprovuar kërkesën për transfer të mjeteve financiare brenda programeve buxhetore, si dhe kërkesën për paraqitjen e kursimeve buxhetore.
- Komisioni ka shqyrtuar kërkesën e Këshillit Drejtues të Odës së Avokatëve të Kosovës për rritje prej 100% të tarifave për avokatë.


4.10.1.3. Komisioni për Vlerësimin e Performancës së Prokurorëve

Komisioni, në muajin shkurt 2023 nga eprorët ka pranuar vlerësimet vjetore (2022) për 170 prokurorët me mandat të përhershëm. Për dymbëdhjetë (12) prokurorë nuk është bërë vlerësimi vjetor i punës: shtatë (7) prokurorë në mandatin fillestar, Kryeprokurori i Shtetit dhe katër (4) prokurorë anëtar të Këshillit me detyrë të pezulluar të prokurorit. Eprorët i kanë vlerësuar 170 prokurorët, për punën gjatë 2022, me nivelet e vlerësimit si në vijim:

- Katërbëdhjetë (14) prokurorë apo 8% me nivelin “Dalluar”,
- Njëqind e dyzet e dy (142) prokurorë apo 84% me nivelin “Mirë”,
- Katërbëdhjetë (14) prokurorë apo 8% me nivelin “Mjaftueshëm”
- Zero (0) prokurorë apo 0% me nivelin “Pamjaftueshëm”.

#	PROKURORË	DALLUAR	MIRË	MJAFTUESHËM	PAMJAFTUESHËM	
1	Kryeprokurorët	10	9	1		
2	ZKPSH	8	8			
3	Apel	6	6			
4	PSRK	16	16			
5	PTh.Prishtinë	47	11	33	3	
6	PTh.Prizren	21		18	3	
7	PTh.Pejë	13		13		
8	PTh.Gjilan	10	2	6	2	
9	PTh.Mitrovicë	20		17	3	
10	PTh.Ferizaj	13	1	10	2	
11	PTh.Gjakovë	6		6		
Gjithsej:		170	14	142	14	0

Tabela 1: Numri total i prokurorëve të vlerësuar



Grafikoni 13: Lakorja sipas udhëzuesit të KPK-së dhe lakorja e vlerësimeve nga eprorët

Në kuadër të kompetencave komisioni për vlerësimin e performancës së prokurorëve gjatë vitit 2023 ka mbajtur 22 takime pune, ka përfunduar gjashtë (6) procese të vlerësimit të performancës së prokurorëve dhe ka bërë vlerësimin e pesëdhjetë e dy (52) prokurorëve, për dy prej të cilëve ka bërë rivlerësimin e performancës në zbatim të vendimit të Këshillit pas miratimit të kundërshtimit të parashtruar nga prokurorët, prej të cilëve:

- Dyzet e tetë (48) prokurorë me mandat të përhershëm,
- Katër (4) nga (6) prokurorët e planifikuar për t'u vlerësuar, me mandat fillestar¹.

Komisioni i ka vlerësuar prokurorët me nivelet si në vijim (*shih tabelën në vijim*):

- Një (1) me nivelin "Dalluar" apo 2%,
- Tridhjetë e tre (33) me nivelin "Mirë" apo 63%,
- Tetëmbëdhjetë (18) me nivelin "Mjaftueshëm" apo 35%.

Rivlerësimi për fatos ajvazin dhe Qazim Xharra

Proceset	#prokurorëve	Dalluar	Mirë	Mjaftueshëm	Pamjaftueshëm
Procesi I	8	1	6	1	
Procesi II	8		4	4	
Procesi III	9		7	2	
Procesi IV	11		8	3	
Procesi V	12		7	5	
Procesi VI	4		1	3	
Gjithsej:	52	1	33	18	0

Tabela 2: Proceset e vlerësimit

-Në procesin e parë (I) janë vlerësuar tetë (8) prokurorë me mandat të përhershëm, me nivelet e vlerësimit si në vijim:

- Një (1) prokuror (apo 12.5%) me nivelin "Dalluar",
- Gjashtë (6) prokurorë (apo 75%) me nivelin "Mirë",
- Një (1) prokuror (apo 12.5%) me nivelin "Mjaftueshëm",
- Zero (0) prokurorë (apo 0%) me nivelin "Pamjaftueshëm".

¹ Dy prokurorë nuk i janë nënshtruar procesit të vlerësimit pasi që për shkaqe objektive nuk e kanë përfunduar trajnimin fillestar. Dy prokurorëve të shtetit, me vendim të Këshillit, i'u është zgjatur afati i trajnimit fillestar në Akademinë e Drejtësisë. Pas përfundimit të trajnimit fillestar do i nënshtrohen vlerësimit të performancës.

-Në procesin e dytë (II) janë vlerësuar tetë (8) prokurorë me mandat të përhershëm, me nivelet e vlerësimit si në vijim:

- Zero (0) prokurorë (apo 0%) me nivelin "Dalluar",
- Katër (4) prokurorë (apo 50%) me nivelin "Mirë",
- Katër (4) prokurorë (apo 50%) me nivelin "Mjaftueshëm",
- Zero (0) prokurorë (apo 0%) me nivelin "Pamjaftueshëm".

-Në procesin e tretë (III) janë vlerësuar nëntë (9) prokurorë me mandat të përhershëm, me nivelet e vlerësimit si në vijim:

- Zero (0) prokurorë (apo 0%) me nivelin "Dalluar",
- Shtatë (7) prokurorë (apo 78%) me nivelin "Mirë",
- Dy (2) prokurorë (apo 22%) me nivelin "Mjaftueshëm",
- Zero (0) prokurorë (apo 0%) me nivelin "Pamjaftueshëm".

-Në procesin e katërt (IV) janë vlerësuar njëmbëdhjetë (11) prokurorë me mandat të përhershëm, me nivelet e vlerësimit si në vijim:

- Zero (0) prokurorë (apo 0%) me nivelin "Dalluar",
- Tetë (8) prokurorë (apo 73%) me nivelin "Mirë",
- Tre (3) prokurorë (apo 27%) me nivelin "Mjaftueshëm",
- Një (1) prokuror (apo 9%) me nivelin "Pamjaftueshëm".

-Në procesin e pestë (V) janë vlerësuar dymbëdhjetë (12) prokurorë me mandat të përhershëm, me nivelet e vlerësimit si në vijim:

- Zero (0) prokurorë (apo 0%) me nivelin "Dalluar",
- Shtatë (7) prokurorë (apo 58%) me nivelin "Mirë",
- Pesë (5) prokurorë (apo 42%) me nivelin "Mjaftueshëm",
- Zero (0) prokurorë (apo 0%) me nivelin "Pamjaftueshëm".

-Në procesin e gjashtë (VI) ishte planifikuar vlerësimi i parë i gjashtë (6) prokurorëve në kuadër të mandatit fillestar. Këshilli me vendim iu ka zgjatur afatin e përfundimit të trajnimit fillestar dy prokurorëve, ndërsa pas përfundimit të trajnimit do të vlerësohen nga komisioni. Katër prokurorët tjerë janë vlerësuar me nivelet si në vijim:

- Zero (0) prokurorë (apo 0%) me nivelin "Dalluar",
- Një (1) prokurorë (apo 25%) me nivelin "Mirë",
- Tre (3) prokuror (apo 75%) me nivelin "Mjaftueshëm",
- Zero (0) prokurorë (apo 0%) me nivelin "Pamjaftueshëm".

4.10.1.4. Komisioni për Administrimin e Prokurorive

Komisioni për Administrimin e Prokurorive, gjatë vitit 2023 ka mbajtur ka mbajtur rreth 13 takime të ndryshme ndër to 8 takime të rregullta pune, 2 punëtori dhe disa takime tjera në kuadër të fushëveprimtarisë së vet.

Fillimisht, Komisioni ka mbajtur punëtorinë e parë në muajin shkurt të vitit 2023 ku janë diskutuar aktivitetet dhe sfidat e Komisionit dhe prokurorive gjatë vitit paraprak si dhe janë specifikuar objektivat e Komisionit dhe aktivitetet për vitin 2023 me qëllim të adresimit të sfidave të paraqitura. Pjesëmarrës në punëtori ishin zyrtarë nga njësitë e SKPK dhe NJSHP si dhe administratorë.

Punëtorja e radhës u mbajt në muajin korrik 2024 me temën: Monitorimi i zbatimit të SMIL-it, ku kanë marrë pjesë administratorë dhe personel nga të gjitha prokuroritë e Kosovës. Përveç çështjeve që kanë të bëjnë me zbatimin e SMIL-it nëpër prokurori, në këtë punëtori u diskutuan edhe çështje që kanë të bëjnë me infrastrukturën dhe burimet njerëzore. Të dy këto punëtori u mbështetën nga projekti EUKOJUST.

Gjatë këtij viti, Kryetari i Komisionit ka mbajtur takim në Drejtorinë e Policisë Rajonale në Prishtinë, ku është pritur në takim nga Drejtori i kësaj drejtorie, z.Basri Shabani, me bashkëpunëtorë. Ky takim u realizua në kuadër të bashkëpunimit të ndërsjellë lidhur me shkëmbimin elektronik të të dhënave përmes sistemeve që janë vënë në zbatim, me ç'rast janë diskutuar çështje me interesit të përbashkët dhe rrjedhimisht edhe sfidat, me të cilat ballafaqohen institucionet prokuroriale dhe ato të Policisë së Kosovës. Sidomos, gjatë këtij takimi, janë diskutuar në mënyrë të detajuar aspektet që kanë të bëjnë me sigurimin e numrit personal për të gjitha llojet e palëve, regjistrimin e tyre, regjistrimin e veprave penale, trajtimin me kujdes të dyfishimit të lëndëve (sidomos ato të krimeve ekonomike), bashkëngjitjen e dokumenteve adekuate dhe dërgimin e kopjeve fizike në prokurori, si procedura të nevojshme që lehtësojnë punën e përbashkët në raportet ndërmjet Prokurorisë dhe Policisë.

Për më tepër, Kryetari i Komisioni ka mbajtur takim me Komisionin për Administrimin e Gjykatave. Qëllimi i këtij takimi ishte diskutimi i detajuar i sfidave që janë duke u shfaqur gjatë procesit të punës së prokurorëve dhe gjyqtarëve në SMIL dhe intensifikimi i angazhimit të përbashkët të këtyre dy komisioneve për lehtësimin e veprimtarisë së punës në këtë projekt madhor të sistemit të drejtësisë në Republikën e Kosovës. Rrjedhimisht, përfaqësuesit e këtyre komisioneve të KPK-së dhe KGJK-së janë pajtuar për nevojën e formimit të Grupit të përbashkët të punës së përdoruesve, i cili do të përbëhet nga prokurorë dhe gjyqtarë, si dhe nga stafi profesional, grup ky, i cili do të ketë për detyrë identifikimin dhe dhënien e propozimeve të komisionet për rregullimin dhe përmirësimin e procesit të punës gjatë vendosjes së të dhënave dhe procedimin e tyre për miratim në takimet e të dy këshillave përkatës. Po ashtu, diskutimet u përqendruan në mënyrat e thjeshtësimin të procedurave të futjes së të dhënave përmes SMIL-it dhe lehtësimin e ndjeshëm të shkëmbimit të tyre ndërmjet instancave prokuroriale dhe gjyqësore në përgjithësi dhe Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit dhe Gjykatës Supreme në veçanti.

Sa i përket zbatimit të SMIL-it, Komisioni me datë 14 mars 2023 ka themeluar një grup punues për monitorimin e zbatimit të Sistemit për Menaxhimin Informativ të Lëndëve (SMIL) në prokuroritë e Republikës së Kosovës përmes së cilit ka caktuar mbikëqyrës të secilit regjion në përbërje nga zyrtarë të NJSHPP dhe DTI.

Komisioni për administrimin e prokurorive gjatë takimeve dhe aktiviteteve të realizuara gjatë vitit 2023 ka trajtuar çështjet si:

- ngarkesa e prokurorive me lëndë dhe analiza për numrin e nevojshëm të prokurorëve në prokuroritë themelore për rekrutim, avancim dhe transferim;
- monitorimi i zbatimit të SMIL-it në prokuroritë themelore, Prokurorinë e Apelit dhe ZKPSH;
- saktësia e shënimeve statistikore të raporteve të SMIL-it;
- infrastruktura dhe burimet njerëzore në sistemin prokurorial;
- harmonizimi me legjislacionin në fuqi të formave shabllon;
- Vlerësimi i raporteve statistikore aktuale dhe mundësia e kalimit në gjenerim të raporteve përmes SMIL-it;
- Përkrahja e ekspertëve të CEPEJ lidhur me raportet statistikore;
- Bashkëpunimi me KGJK dhe Policinë e Kosovës;

Komisioni për administrimin e prokurorive ka marrë këto vendime:

- Raporti vjetor i Punës së Komisionit për vitin 2022;
- Miratohet Plani i punës së Komisionit për vitin 2023;
- Themelohet Grupi Punues për monitorimin e zbatimit të Sistemit për Menaxhimin Informativ të Lëndëve (SMIL) në prokuroritë e Republikës së Kosovës
- Themelohet Grupi Punues për harmonizimin me legjislacionin në fuqi të formave shabllon (thirrjet për dëshmitar dhe thirrjet për të pandehurin) që përdoren nga prokuroritë;
- Propozim në Këshill për themelimin e Grupit punues të përdoruesve të SMIL-it të përbërë nga Kryeprokuror dhe prokurorë;

4.10.2. Komisionet ad hoc

Bazuar në kompetencat ligjore, Këshilli themelon edhe komisionet ad hoc, me qëllim të realizimit të aktiviteteve specifike, ku me vendim përkatës përcakton përbërjen dhe fushëveprimtarinë e tyre.

Në këtë kuadër, gjatë vitit 2023, kanë funksionuar këto komisione ad hoc:

4.10.2.1. Komisioni për Rekrutim

Këshilli themeloi Komisionin për Rekrutim, gjatë vitit 2022 i cili komision vazhdoi punën edhe gjatë vitit 2023 deri në dekretimin e kandidatëve për prokurorë të shtetit, në këtë përbërje: Kryesuesi i Këshillit, Kryesues si dhe katër anëtarë tjerë, ndërsa anëtarë rezervë - dy prokurorë.

4.10.2.2. *Komisioni për Rishqyrtim*

Këshilli themeloi Komisionin për Rishqyrtim, gjatë vitit 2022 i cili komision vazhdoi punën edhe gjatë vitit 2023 deri në dekretimin e kandidatëve për prokurorë të shtetit në përbërje: Zëvendës Kryesuesi i Këshillit, Kryesuesi i Komisionit, dy anëtarë tjerë të rregullt dhe dy anëtarë rezervë me mandat për shqyrtimin e ankesave të kandidatëve për prokurorë. Pas shqyrtimit të ankesave, të gjithë kandidatët janë njoftuar me shkrim lidhur me vendimet e komisionit.

4.10.2.3. *Komisioni për Transferim dhe Avancim të Prokurorëve*

Gjatë vitit 2023, Komisioni për Transferim dhe Avancim të Prokurorëve të Shtetit ishte në këtë përbërje: u.d. Kryeprokurori i Shtetit në rolin e kryesuesit, dy anëtarë të rregullt dhe tre anëtarë rezervë.

Aktivitetet e këtij komisioni janë përfshirë në transferimin dhe avancimin e prokurorëve në pikën 4.4. të këtij raporti.

4.10.2.4. *Paneli vlerësues për procesin e emërimit të Kryeprokurorëve*

Gjatë vitit 2023, Këshilli pas tërheqjes së shortit, ka zgjedhur përbërjen e paneleve vlerësuese të ndara për proceset e emërimit të Kryeprokurorëve të Prokurorisë Speciale, Prokurorisë Themelore në Prishtinë dhe si dhe Prokurorisë Themelore në Gjakovë nga Kryesuesi i Këshillit në rolin e kryesuesit të panelit dhe katër anëtarë tjerë të rregullt. Këto panele kishin mandat shqyrtimin e aplikacioneve të kandidatëve, intervistimin e tyre, poentimin dhe vlerësimin si dhe propozimin e kandidatëve më të suksesshëm në Këshill për votim.

4.10.2.5. *Komisioni mbikëqyrës për monitorimin e rasteve të korrupsionit dhe krimeve ekonomike që rrjedhin nga Plani Strategjik i sistemit prokurorial 2022-2024*

Pas miratimit të Planit strategjik të sistemit prokurorial 2022-2024, Këshilli, më 17 maj 2022, themeloi Komisionin mbikëqyrës për monitorimin e rasteve të korrupsionit dhe krimeve ekonomike që rrjedhin nga Plani Strategjik i sistemit prokurorial 2022-2024. Në muajin dhjetor 2022 përbërja e Komisionit u plotësua/ndryshua në përbërje prej tre anëtarësh: një anëtar i Këshillit, një prokuror nga ZKPSH-ja dhe një prokuror nga Prokuroria e Apelit.

Ky grup punues ka mbikëqyrur punën e prokurorive themelore për trajtimin dhe zgjidhjen më të shpejtë të lëndëve të pazgjidhura të veprave penale të korrupsionit dhe krimeve ekonomike, për të cilën ka raportuar para Këshillit lidhur me të gjitha konstatimet për të gjeturat dhe rekomandimet konkrete.

Komisioni mbikëqyrës për monitorimin e rasteve të korrupsionit dhe krimeve ekonomike gjatë vitit 2023 ka mbajtur 4 takime dhe ka realizuar 7 vizita në të gjitha prokuroritë themelore.

Në kuadër të këtij Komisioni janë hartuar raporti vjetor (2022) dhe raporti gjashtë (6) mujor (janar-qershor 2023).

4.10.2.6. Komisioni rekrutues për pozitën e shpallur për Drejtor të Përgjithshëm të SKPK-së dhe Drejtor të NJSHPP-së

Pas shpalljes së konkursit, Këshilli, me datë 21 tetor 2022 themeloi Komisionin rekrutues për pozitën e shpallur për Drejtor të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit dhe Drejtor të NJSHPP-së në përbërje prej pesë anëtarësh: Kryesuesi i Këshillit, kryesuesi i Komisionit, dy anëtarë të Këshillit, një prokuror nga prokuroritë themelore dhe një zyrtar i lartë nga Sekretariati.

Mandati i këtij Komisioni ishte shqyrtimi i aplikacioneve të kandidatëve, intervistimi, vlerësimi, poentimi dhe propozimi në Këshill i kandidatit më të suksesshëm.

Pas zhvillimit të të gjitha procedurave rekrutuese, Këshilli në takimin e datës 30 nëntor 2023 zgjodhi Drejtorin e Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit dhe Drejtorin e Njësitit për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorisë të cilët filluan mandatin e tyre me datë 15 dhjetor 2023.

4.10.2.7. Komisioni për Rishqyrtim për pozitën Drejtor i Përgjithshëm i SKPK-së dhe Drejtor i NJSHPP-së

Më 08 nëntor 2022, Këshilli themeloi Komisionin për Rishqyrtim për pozitën e shpallur për Drejtor të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit dhe Drejtor të NJSHPP-së në përbërje prej tre anëtarësh: një anëtar i Këshillit, një prokuror nga ZKPSH dhe një zyrtar i lartë nga Sekretariati i Këshillit. Ky Komision kishte mandat shqyrtimin e ankesave të kandidatëve.

III. PJESA E TRETË

5. Buxheti i Këshillit

Këshilli menaxhon buxhetin vjetor për Këshillin dhe Prokurorin e Shtetit në mënyrë të pavarur dhe mban përgjegjësi për mbikëqyrjen e shpenzimeve, alokimin e fondeve, mirëmbajtjen e llogarive të sakta dhe aktuale, si dhe auditimin financiar.

Bazuar në Ligjin Nr.08/L-193 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023, Këshillit i janë ndarë 964 pozita si dhe buxhet prej 15,913,983.00€, në katër programe buxhtore dhe katër kategori ekonomike. Buxheti i Këshillit Prokurorial për vitin 2023 është më i ulët për 1,230,195.00€ se sa buxheti fillestar i vitit 2022.

Kërkesa e Këshillit për buxhetin e vitit 2023 ka qenë për rritjen e numrit të prokurorëve dhe stafit administrativ për 178 pozita si dhe buxheti shtesë prej 21,267,112.00€, mirëpo kërkesa është aprovuar pjesërisht nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Kërkesa e Këshillit sipas kategorive ekonomike ka qenë si në vijim:

- Janë kërkuar 178 pozita të reja, ndërsa janë aprovuar vetëm 26 pozita (4 prokurorë për krime të luftës, 16 bashkëpunëtorë profesional, 1 ekspert ushtarak, 1 psikolog si dhe 4 zyrtar ligjorë).
- Janë kërkuar 15,599,753€ në kategorinë e pagave dhe mëditjeve, ndërsa janë aprovuar 11,505,353€. Diferenca në mes të kërkesës së KPK-së dhe buxhetit të aprovuar për kategorinë e pagave dhe mëditjeve është 4,094,400€.
- Janë kërkuar 3,958,729€ në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve, ndërsa janë aprovuar 2,720,000€. Diferenca në mes të kërkesës së KPK-së dhe buxhetit të aprovuar për kategorinë e mallrave dhe shërbimeve është 1,258,729€.

Kërkesa e KPK-së për kategorinë e shërbimeve komunale dhe investimeve kapitale është aprovuar sipas planifikimit.

Nr.	Kategoria ekonomike	Prokuroritë dhe Administrata	Prokuroria Speciale	Njësia për Mbrojtje dhe Ndihmë	Njësia Kundër Krimeve Ekonomike	KPK
1	Pagat dhe mëditje	9,710,323	1,536,573	243,967	14,490	11,505,353
2	Mallra dhe Shërbime	2,329,720	323,980	45,900	20,400	2,720,000
3	Shpenzime Komunale	154,800	41,830	3,000		199,630
4	Investime Kapitale	1,489,000	0.00			1,489,000
Totali		13,683,843	1,902,383	292,867	34,890	15,913,983

Tabela 3: Buxheti fillestar sipas programeve të Këshillit dhe sipas kategorive ekonomike

5.1. Ndryshimet Buxhetore gjatë vitit 2023

Gjatë vitit 2023 buxheti i aprovuar i Këshillit në kategorinë e investimeve kapitale ka pësuar ndryshime në projekte të caktuara, duke mos tejkaluar kufirin e përcaktuar me ligj të buxhetit. Bazuar në nenin 9 të Ligjit për Buxhetin e vitit 2023 lidhur me ndarjen dhe rindarjen e fondeve të bartura si dhe obligimet e pakryera financiare nga viti paraprak, Këshilli ka bërë rialokimin e mjeteve buxhetore sipas nevojave.

Këshilli me Vendimin DPSKPK/Nr.307/2023 të datës 12 korrik 2023, ka kërkuar transfer të mjeteve financiare në vlerë prej 74,301.00€ nga kategoria e investimeve kapitale, përkatësisht projektit 18570 “Ndërtimi dhe Përmirësimi i Infrastrukturës Fizike të Sistemit Prokurorial” në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve për mbulimin e kostos sipas Marrëveshjes në mes të Këshillit Prokurorial të Kosovës me Policinë e Kosovës. Në vendim është përfshirë edhe kostoja për mirëmbajtje të objektit të Pallatit të Drejtësisë për të cilin deri në muajin maj 2023 ka qenë obligim i Ministrisë së Punëve të Brendshme. Mjetet janë ndarë sipas nën kodeve të poshtëshënuara:

- 13953 sigurimi i objekteve vlera prej 64,436.00€, si dhe
- 14020 mirëmbajta e objekteve vlera prej 9,865.00€.

Në mungesë të mjeteve buxhetore në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve Këshilli me kërkesën DPSKPK/Nr.525/2023 i është drejtuar Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve për transfer të mjeteve financiare nga kategoria e investimeve kapitale, përkatësisht 137,904€ nga projekti 18570 “Ndërtimi dhe Përmirësimi i Infrastrukturës Fizike të Sistemit Prokurorial” në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve të programit 33500 Prokuroritë dhe Administrata.

Bazuar në vendimin Nr.16/174 të datës 22 nëntor 2023, Qeveria ka aprovuar kërkesën e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve për kursime dhe ndarje të mjeteve buxhetore, ku nga kategoria e investimeve kapitale , projekti 18570 “Ndërtimi dhe Përmirësimi i Infrastrukturës Fizike të Sistemit Prokurorial” ka transferuar 79,000€ në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve të programit 33500 Prokuroritë dhe Administrata.

Bazuar në Kërkesën DPSKPK 496/2023 për kursimet e Këshillit Prokurorial të Kosovës, Qeveria me Vendimin Nr.40/178 të datës 13 dhjetor 2023 ka marrë 500,000.00€ nga projekti 18566 “Blerja e tokës për Prokurorinë Themelore Mitrovicë”.

Gjithashtu, me Vendimin Nr.69/2023 të datës 27 dhjetor 2023, Qeveria e Kosovës ka aprovuar transferin e mjeteve buxhetore në kuadër të kategorisë së shpenzimeve “paga dhe shtesa” për mbulimin e mungesës së mjeteve buxhetore për ekzekutimin e pagave për muajin dhjetor 2023. Si rrjedhojë e kësaj, Këshilli i janë marrë 612,435.55€.

Buxheti përfundimtar i Këshillit për vitin 2023 është 14,801,546.98€.

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Transferi	Vendimi Nr.16/174 22.11.2023	Transferi	Vendimi Nr.40/178 13.12.2023	Vendimi Nr.69/2023 27.12.2023	Buxheti përfundimtar
Paga dhe Mëditje	11,505,353.00	-				(612,436.05)	10,892,916.95
Mallra dhe Shërbime	2,720,000.00	74,301.00	79,000.00	137,904.00			3,011,205.00
Shpenzime Komunale	199,630.00	-					199,630.00
Investime Kapitale	1,489,000.00	(74,301.00)	(79,000.00)	(137,904.00)	(500,000.00)		697,795.00
	-						
Totali	15,913,983.00				(500,000.00)	(612,436.05)	14,801,546.95

Tabela 4: Ndryshimet e buxhetit fillestar në raport me buxhetin përfundimtar


5.2. Realizimi i buxhetit për vitin 2023

Gjatë vitit 2023 Këshilli ka realizuar 95.56% të buxhetit përfundimtar. Sipas kategorive ekonomike buxheti është realizuar si më poshtë:

- Paga dhe mëditje 100.00%,
- Mallra dhe shërbime 96.07%,
- Shpenzime komunale 66.4%, si dhe
- Investime kapitale 32.4%.

Përshkrimi	Buxheti përfundimtar	Realizimi i buxhetit	Realizimi i buxhetit në %
Paga dhe Mëditje	10,892,917	10,892,600	100.00%
Mallra dhe Shërbime	3,011,205	2,892,947	96.07%
Shpenzime Komunale	199,630	132,589	66.42%
Investime Kapitale	697,795	225,795	32.36%
Totali	14,801,547	14,143,932	95.56%

Tabela 5: Buxheti përfundimtar si dhe realizimi i buxhetit sipas kategorive ekonomike



Grafikoni 14: Buxheti si dhe realizimi i buxhetit sipas kategorive ekonomike

5.3. Paraqitja e shpenzimeve për të gjitha programet dhe kategoritë ekonomike

Me qëllim të prezantimit të informatave të ndryshme janë të paraqitur më poshtë informata të detajuara të shpenzimeve për secilën kategori të shpenzimeve, në formë përshkuese, në formë tabelore dhe me grafikone për katër programet buxhetore të Këshillit.

5.3.1. Paga dhe mëditje

Bazuar në Ligjin Nr.08/L-193 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023, në kategorinë e pagave dhe mëditjeve Këshillit i janë ndarë 11,505,353.00€, e që është për 321,122.00€ më i lartë se sa buxheti fillestar i vitit 2022.

Gjatë vitit 2023 Këshilli bazuar në Vendimin KPK/Nr.767/2023 të datës 13 tetor 2023, i plotësuar dhe ndryshuar me Vendimin KPK/Nr.940/2023 të datës 30 nëntor 2023 lidhur me pagesat e kujdestarive (pagesa retroaktive që nga hyrja në fuqi të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik) ka proceduar për pagesë 230,155.00€ për kujdestari, si dhe 125,396.39€ pagesa retroaktive (anëtarët e KPK-së, punë jashtë orarit të rregullt).

Pagat e muajit nëntor dhe dhjetor për programin 37500 Njësia Kundër Krimeve Ekonomike nuk janë proceduar nga Thesari, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.

Bazuar në Vendimin Nr.69/2023 të datës 27 dhjetor 2023, Qeveria e Kosovës ka aprovuar transferin e mjeteve buxhetore në kuadër të kategorisë së shpenzimeve “paga dhe shtesa” për mbulimin e mungesës së mjeteve buxhetore për ekzekutimin e pagave për muajin dhjetor 2023. Si rrjedhojë e kësaj, Këshillit i janë marrë 612,435.55€, dhe atë sipas programeve:


- Prokuroritë dhe Administrata (606,226.90€),
- Prokuroria Speciale (69,330.84€),
- Njësia Kundër Krimeve Ekonomike (2,415.00€), si dhe

- Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave i janë shtuar 65,537.16€ për mbulimin e një pjese të pagës të muajit nëntor, si dhe pagën e plotë të muajit dhjetor 2023.

Gjatë vitit 2023 Këshilli ka realizuar 10,892,600.48€, ose 100% të buxhetit përfundimtar.

Përshkrimi	Prokuroritë dhe Administrata	Prokuroria Speciale	Njësia për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave	Njësia Kundër Krimeve Ekonomike	Totali	Shpenzimet në raport me totalin e shpenzimeve
Pagat neto	7,601,116.33	1,218,395.63	261,147.01	9,832.50	9,090,491.47	83.46%
Sindikata	212.45	-	24.80		237.25	0.00%
Tatimi	638,120.75	109,182.65	18,870.59	1,092.50	767,266.49	7.04%
Kontributi i punëmarrësit	432,165.13	69,831.73	14,730.77	575.00	517,302.63	4.75%
Kontributi i punëdhënësit	432,165.13	69,831.73	14,730.77	575.00	517,302.63	4.75%
Vendimet gjyqësore	-	-	-	-	-	
Totali	9,103,779.79	1,467,241.74	309,503.94	12,075.00	10,892,600.47	

Tabela 5: Shpenzimet e kategorisë paga dhe mëditje për vitin 2023 të ndara sipas nën kodeve ekonomike dhe programeve buxhetore



Grafikoni 15: Shpenzimi i pagave dhe mëditjeve

Në kuadër të pagave dhe shtesave përfshihen pagat dhe shtesat e prokurorëve dhe stafit administrativ të sistemit prokurorial.

Grafikoni 2 pasqyron shpenzimet e pagave në përqindje për secilin program buxhetor në raport me totalin e shpenzimeve të Këshillit.

5.3.2. Mallra dhe shërbime

Bazuar në Ligjin Nr.08/L-193 për Buxhetin e vitit 2023, në kategorinë për mallra dhe shërbime Këshillit i janë ndarë 2,700,000€, e që ishte për 324,183€ më i lartë se sa buxheti fillestar i vitit 2022.

Bazuar në vendimin Nr.16/174 të datës 22 nëntor 2023, Qeveria e Kosovës ka aprovuar kërkesën e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve për kursime dhe ndarje të mjeteve buxhetore,

ku nga kategoria e investimeve kapitale, projekti 18570 “Ndërtimi dhe Përmirësimi i Infrastrukturës Fizike të Sistemit Prokurorial” janë transferuar 79,000€ në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve të programit 33500 Prokuroritë dhe Administrata.

Kërkesa DPSKPK /Nr.525/2023 e Këshillit Prokurorial të Kosovës lidhur me transfer të mjeteve financiare në vlerë prej 137,904.00€ nga kategoria e investimeve kapitale, përkatësisht projekti 18570 “Ndërtimi dhe Përmirësimi i Infrastrukturës Fizike të Sistemit Prokurorial” në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve të programit 33500 Prokuroritë dhe Administrata, është aprovuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.

Bazuar në aktet nënligjore dhe nevojat e sistemit nga programi buxhetor 32200 Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës janë marrë 58,619.39€ për mbulimin e obligimeve të programit buxhetor 33500 Prokuroritë dhe Administrata.

Gjatë vitit 2023, Këshilli ka realizuar 96.07% të buxhetit përfundimtar për këtë kategori, ku sipas programeve buxheti është realizuar si më poshtë:


- Prokuroritë dhe Administrata ka realizuar 97.3% të buxhetit,
- Prokuroria Speciale ka realizuar 92.1% të buxhetit,
- Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave 79.1% të buxhetit,
- Njësia Kundër Krimeve Ekonomike 39.4% të buxhetit të ndarë për këtë program.

Në tabelën nr.6 është paraqitur buxheti përfundimtar si dhe realizimi i buxhetit sipas programeve buxhetore



Pershkrimi	Kodet ekonomike	Buxheti përfundimtar	Prokurorit dhe Administrata	Prokuroria Speciale	Njësia për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave	Njësia Kundër Krimeve Ekonomike	Totali	Totali në % në krahasim me buxhetin përfundimtar	Shpenzimet në raport me totalin e shpenzimeve
Shpenzimet e udhëtimit		71,629.00	39,862.83	21,280.96	1,860.00	7,490.25	70,494.04	98%	2.44%
Shpenzimet e udhëtimit brenda vendit	13130	-	-	-	-	-	-	0%	0.00%
méditja e udhëtimit brenda vendit	13131	2,000.00	768.00	384.00	688.00	48.00	1,888.00	94%	0.07%
Akomodimi i udhëtimeve zyrtare brenda vendit	13132	-	-	-	-	-	-	0%	0.00%
Shpenzimet tjera të udhëtimit brenda vendit	13133	-	-	-	-	-	-	0%	0.00%
Shpenzimet e udhëtimit zyrtar jashtë vendit	13140	-	-	-	-	-	-	0%	0.00%
Méditjet	13141	52,700.00	30,708.38	17,064.89	1,164.00	3,683.80	52,621.07	100%	1.82%
Akomodimi	13142	11,950.00	5,832.82	1,959.75	-	3,308.45	11,101.02	93%	0.38%
Shpenzime tjera	13143	3,979.00	1,633.15	1,872.32	8.00	450.00	3,963.47	100%	0.14%
Shpenzime të transportit	13144	1,000.00	920.48	-	-	-	920.48	0%	0.03%
Shërbimet e telekomunikimit		135,680.00	122,443.58	7,208.56	4,103.39	240.00	133,995.53	99%	4.63%
Shpenzimet internet	13310	6,200.00	5,733.88	-	-	-	5,733.88	92%	0.20%
Shpenzimet e telefonisë mobile	13320	83,650.00	72,696.65	6,603.26	4,103.39	240.00	83,643.30	100%	2.89%
Shpenzimet postare	13330	38,000.00	37,378.80	605.30	-	-	37,984.10	100%	1.31%
Kablli optik	13340	7,830.00	6,634.25	-	-	-	6,634.25	85%	0.23%
Shpenzimet për shërbime		1,164,621.25	993,385.74	88,381.77	-	-	1,081,767.51	93%	37.39%
Shërbimet e arsimit dhe trajnimit	13410	-	-	-	-	-	-	0%	0.00%
Shërbimet e përfaqësimit dhe Avokaturës	13420	1,093,637.25	923,421.83	88,152.77	-	-	1,011,574.60	92%	34.97%
Shërbimet e ndryshme shëndetësore	13430	1,100.00	112.00	229.00	-	-	341.00	31%	0.01%
Shërbime të ndryshme intelektuale	13440	1,700.00	1,651.44	-	-	-	1,651.44	97%	0.06%
Shërbimi shtypje-jo marketing	13450	-	-	-	-	-	-	0%	0.00%
Shërbime kontraktuese tjera	13460	67,684.00	67,680.47	-	-	-	67,680.47	100%	2.34%
Shërbime teknike		20.00	20.00	-	-	-	20.00	-	-
Shpenzimet për anëtarësim	13480	500.00	500.00	-	-	-	500.00	0%	0.02%
Shpenzimet e varrimit	13490	-	-	-	-	-	-	0%	0.00%
Blerja e mobiljeve dhe pajisjeve		209,560.40	192,048.14	19,721.40	-	-	211,769.54	101%	7.32%
Mobile	13501	151,450.00	151,450.00	-	-	-	151,450.00	100%	5.24%
Telefona	13502	-	-	-	-	-	-	0%	0.00%
Kompjuter	13503	46,810.40	29,980.00	16,830.40	-	-	46,810.40	100%	1.62%
Hardwer	13504	-	-	-	-	-	-	0%	0.00%
Pajisje tjera	13509	11,300.00	7,768.14	2,891.00	-	-	10,659.14	94%	0.37%
Blerja e librave	13510	2,850.00	2,850.00	-	-	-	2,850.00	-	-
Blerje tjera		87,519.60	75,797.78	7,034.90	1,495.83	-	84,328.51	96%	2.91%
Furnizim për zyrë	13610	83,419.60	72,014.66	6,785.70	1,495.83	-	80,296.19	96%	2.78%
Furnizim me ushqim dhe pije	13620	4,000.00	3,684.50	249.20	-	-	3,933.70	98%	0.14%
Furnizim Pastrimi	13640	100.00	98.62	-	-	-	98.62	0%	0.00%
Furnizim me veshmbathje	13650	-	-	-	-	-	-	0%	0.00%
Derivate dhe lëndë djegëse		185,319.00	152,332.00	16,883.97	12,131.70	-	181,347.67	98%	6.27%
Vaj	13710	-	-	-	-	-	-	0%	0.00%
Naftë për ngrohje qendrore	13720	50,600.00	50,588.10	-	-	-	50,588.10	100%	1.75%
Dru	13760	4,590.00	4,590.00	-	-	-	4,590.00	100%	0.16%
Derivate për gjenerator	13770	235.00	170.76	-	-	-	170.76	73%	0.01%
Karburant për vetura	13780	129,894.00	96,983.14	16,883.97	12,131.70	-	125,998.81	97%	4.36%
Shërbimet e sigurimit dhe regjistrimit		343,446.00	337,316.44	2,315.30	2,637.31	-	342,269.05	100%	11.83%
Regjistrimi i automjeteve	13950	5,440.00	3,425.00	600.00	525.00	-	4,550.00	84%	0.16%
Sigurimi i automjeteve	13951	18,470.00	14,787.65	1,635.30	2,042.31	-	18,465.26	100%	0.64%
Taksa komunale për regjistrim të veturave	13952	600.00	430.00	80.00	70.00	-	580.00	97%	0.02%
Sigurimi i ndërtesave	13953	318,936.00	318,673.79	-	-	-	318,673.79	100%	11.02%
Mirëmbajtja		269,870.00	236,170.37	24,300.76	8,407.70	-	268,878.83	100%	9.29%
Mirëmbajtja e veturave	14010	46,200.00	32,723.24	5,022.58	8,407.70	-	46,153.52	100%	1.60%
Mirëmbajtja e ndërtesave	14020	149,365.00	130,260.80	19,067.98	-	-	149,328.78	100%	5.16%
Mirëmbajtja e TI	14040	67,205.00	67,156.53	45.00	-	-	67,201.53	100%	2.32%
Mirëmbajtja e mobiljeve dhe ndërtesave	14050	7,100.00	6,029.80	165.20	-	-	6,195.00	87%	0.21%
Qiraja		457,259.00	334,303.03	103,579.04	5,337.67	-	443,219.74	97%	15.32%
Qiraja për ndërtesa	14110	256,400.00	183,623.89	72,743.64	-	-	256,367.53	100%	8.86%
Qiraja për pajisje	14130	26,827.00	20,139.94	1,693.76	1,281.67	-	23,115.37	86%	0.80%
Qiraja për vetura	14140	173,532.00	130,039.20	29,141.64	4,056.00	-	163,236.84	94%	5.64%
Qiraja për hapsira tjera	14150	500.00	500.00	-	-	-	500.00	0%	0.02%
Shpenzimet e marketingut		8,280.00	1,460.00	-	-	-	1,460.00	18%	0.05%
Reklama dhe konkurse	14210	-	-	-	-	-	-	0%	0.00%
Botime e publikime	14220	8,280.00	1,460.00	-	-	-	1,460.00	18%	0.05%
shpenzimet për informim publik	14230	-	-	-	-	-	-	0%	0.00%
Shpenzimet e përfaqësimit		49,580.00	45,625.72	1,625.40	327.55	300.00	47,878.67	97%	1.66%
Drekat zyrtare	14310	49,580.00	45,625.72	1,625.40	327.55	300.00	47,878.67	97%	1.66%
Shpenzimet- vendimet e gjykatave		-	4,369.75	-	-	-	4,369.75	0%	0.15%
Vendimet e gjykatave	14410	4,369.75	4,369.75	-	-	-	4,369.75	0%	0.15%
Tatimi në qira		21,201.00	15,161.38	6,006.36	-	-	21,167.74	100%	0.73%
Tatimi në qira	14510	21,201.00	15,161.38	6,006.36	-	-	21,167.74	100%	0.73%
Totali		3,003,965.25	2,550,276.76	298,338.42	36,301.15	8,030.25	2,892,946.58	96%	

Tabela 6: Buxheti përfundimtar si dhe realizimi i buxhetit sipas programeve buxhetore



Grafikoni 16: Shpenzimi i mallrave dhe shërbimeve

Grafikoni 16 pasqyron shpenzimet e mallrave dhe shërbimeve në përqindje për secilin program buxhetor në raport me totalin e shpenzimeve të Këshillit.

5.3.3. Shërbime komunale


Buxheti fillestar i kategorisë ekonomike shërbimet komunale është 199,630.00€ e që është i njëjtë si buxheti i vitit 2022.

Në tabelën nr.7 janë paraqitur, shpenzimet sipas programeve dhe nën kodeve ekonomike të kategorisë shërbime komunale.

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Prokuroritë dhe Administrata	Prokuroria Speciale	Njësia për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave	Totali i shpenzimeve	Totali në %	Shpenzimet në raport me totalin e shpenzimeve
Rryma	110,000.00	63,635.39	11,002.66		74,638.05	67.85%	56.29%
Uji	11,000.00	4,633.97			4,633.97	42.13%	3.49%
Mbeturina	6,300.00	3,966.66	894.20		4,860.86	77.16%	3.67%
Ngrohja qendrore	25,730.00	22,285.78	4,640.70		26,926.48	104.65%	20.31%
Telefonia fikse	46,600.00	20,311.68	299.61	918.51	21,529.80	46.20%	16.24%
Totali	199,630.00	114,833.48	16,837.17	918.51	132,589.16	66.42%	

Tabela 7: Shpenzimet sipas programeve dhe nën kodeve ekonomike të kategorisë shërbime komunale

Përmes grafikoneve prezantohen shpenzimet komunale për nënkategoritë ekonomike.



Grafikoni 17. Shpenzimet komunale

Gjatë vitit 2023, Këshilli ka realizuar 66.42% të buxhetit të ndarë për këtë kategori, ku sipas programeve buxhetore, buxheti është realizuar si më poshtë:

- Prokuroritë dhe Administrata ka realizuar 74.2% të buxhetit,
- Prokuroria Speciale ka realizuar 40.3% të buxhetit,
- Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave 30.6% të buxhetit të ndarë për këtë kategori.

5.3.4. Investime kapitale

Buxheti fillestar për kategorinë e investimeve kapitale për vitin 2023 është 1,489,000€.

Bazuar në nenin 9 të Ligjit për Buxhetin e vitit 2023 lidhur me ndarjen dhe rindarjen e fondeve të bartura si dhe obligimet e pakryera financiare nga viti paraprak, për mbulimin e obligimeve të mbetura nga viti 2022 janë rialokuar mjete buxhetore nga projektet kapitale të vitit 2023.

Në tabelën nr.7 janë paraqitur ndryshimet të krijuar sipas rialokimit të mjeteve për mbulimin e obligimeve të bartura në vitin 2023.

Emri i projektit	Nr i projektit	Buxheti fillestar	Obligimet sipas kontratës	Neni 9	Buxheti pas ndryshimeve sipas Nenit 9	Koment
Sistemi për Menaxhimin Informativ të Lëndëve (SMIL)	18004	50,000		(10,000)	40,000	10,000 euro kalojnë në projektin "18084 Salla e Konferencës"
Skeneri i kontrollit dhe Sigurisë	18059	0	44,203		44,203	44,203 euro merren nga projekti "18570 Ndërtimi dhe Përmirësimi i Infrastrukturës Fizike të Sistemit Prokurorial"
Sistemi Elektronik për menaxhimin e buxhetit dhe financave	18058	1,000	0	(1,000)	0	1,000 euro kalojnë në projektin "18084 Salla e Konferencës"
Sistemi Elektronik për menaxhimin e rasteve në ZMNV	18069	3,000			3,000	
Instalimi i sistemit të sigurisë kundër zjarrit në arkiva	18565	10,000			10,000	
Blerja e tokës PTH Mitrovicë	18566	500,000			500,000	
Sistemi elektronik për menaxhimin e dokumenteve	18584	1,000		(1,000)	0	1,000 euro kalojnë në projektin "18084 Salla e Konferencës"
Renovimi i Ndërtesës së PSRK-së	18062	0	56,010		56,010	
Sistemi elektronik për Menaxhimin e Dosjes së Prokurorëve	15217	6,000			6,000	
Sistemi elektronik për Menaxhimin e veturave	15218	1,000		(1,000)	0	1,000 euro kalojnë në projektin "18084 Salla e Konferencës"
Avancimi i sistemit për efikasitet të energjisë	18568	0			0	
Salla e konferencave	18084	20,000	57,863		77,863	
Pajisjet harduerike dhe softuerike të teknologjisë informative	18086	20,000			20,000	
Ndërtimi dhe përmirësimi i infrastrukurës fizike të sistemit prokurorial	18570	500,000		(140,076)	359,924	39,863 kalojnë në kalon në projektin "18084 Salla e Konferencës"; 56,010 kalojnë në projektin "18062 Renovimi i PSRK"-së, si dhe 44,203 kalojnë në projektin "18059 Skeneri i kontrollit dhe sigurisë".
Mjetet e transportit	15216	360,000			360,000	
Dizajnimi dhe furnizimi me mobile KPK dhe PSRK	18573	5,000		(5,000)	0	5,000 euro kalojnë në projektin "18084 Salla e Konferencës"
Aparat Digjital	19081	12,000			12,000	
Totali		1,489,000.00	158,076.00	(158,076.00)	1,489,000.00	

Tabela 8: Buxheti dhe ndryshimet buxhetore në projekte kapitale

Gjatë muajit korrik 2023 me Vendimin DPSPK/Nr.307/2023 janë transferuar nga kategoria e investimeve kapitale në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve 74,301.00€, për mbulimin e kostos së Marrëveshjes në mes të Këshillit Prokurorial të Kosovës me Policinë e Kosovës si dhe kostos për mirëmbajtje të objektit të Pallatit të Drejtësisë për të cilin deri në muajin maj 2023 ka qenë obligim i Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Në mungesë të mjeteve buxhetore në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve Këshilli me kërkesën DPSPK/Nr.525/2023 i është drejtuar Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve për transfer të mjeteve financiare nga kategoria e investimeve kapitale, përkatësisht 137,904€ nga projekti 18570 "Ndërtimi dhe Përmirësimi i Infrastrukturës Fizike të Sistemit Prokurorial" në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve të programit 33500 Prokuroritë dhe Administrata.

Bazuar në vendimin Nr.16/174 të datës 22 nëntor 2023, Qeveria e Kosovës ka aprovuar kërkesën e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve për kursime dhe ndarje të mjeteve buxhetore, ku nga kategoria e investimeve kapitale, projekti 18570 "Ndërtimi dhe Përmirësimi i Infrastrukturës Fizike të Sistemit Prokurorial" ka transferuar 79,000€ në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve të programit 33500 Prokuroritë dhe Administrata.

Bazuar në Kërkesën DPSPK 496/2023 për kursimet e Këshillit Prokurorial të Kosovës, Qeveria e Kosovës me Vendimin Nr.40/178 të datës 13 dhjetor 2023 ka tërhequr 500,000.00€ nga projekti 18566 "Blerja e tokës për Prokurorinë Themelore Mitrovicë".

Në tabelën nr.8 është i paraqitur buxheti fillestar, realizimi si dhe ndryshimet gjatë vitit 2023

Emri i projektit	Fondi burimor	Nr i projektit	Buxheti Fillestar	Transfer	Vendimi Nr.16/174 22.11.2023	Transfer	Vendimi Nr.40/178 13.12.2023	Buxheti përfundimtar	Realizimi	Realizimi i shprehur në %	Shpenzimet në raport me totalin e shpenzimeve
Sistemi për Menaxhimin Informativ të Lëndëve (SMIL)	10	18004	50,000					40,000	4,700	12%	2%
Skeneri i kontrollit dhe Sigurisë	10	18059	0					44,203	43,912	99%	19%
Furnizimi dhe instalimi i raftëve lëvizëse për arkiv	10	18064	0								
Sistemi Elektronik për menaxhimin e buxhetit dhe financave	10	18058	1,000					0			
Sistemi Elektronik për menaxhimin e rasteve në ZMNV	10	18069	3,000					3,000			
Instalimi i sistemit të sigurisë kundër zjarrit në arkiva	10	18565	10,000					10,000			
Blerja e tokës PTH Mitrovicë	10	18566	500,000				(500,000)	0	0	0%	
Sistemi elektronik për menaxhimin e dokumenteve	10	18584	1,000					0			
Renovimi i Ndërtësës së PSRK-së	10	18062	0					56,010	24,868	44%	11%
Sistemi elektronik për Menaxhimin e Dosjes së Prokurorëve	10	15217	6,000					6,000	2,124	35%	1%
Sistemi elektronik për Menaxhimin e veturave	10	15218	1,000					0			
Avancimi i sistemit për efikasitet të energjisë	10	18568	0								
Salla e konferencave	10	18084	20,000					77,863	77,863	100%	34%
Furnizim me licenca	10	18085	0								
Pajisjet harduerike dhe softuerike të teknologjisë informatike	10	18086	20,000					20,000	17,875	89%	8%
Ndërtimi dhe përmirësimi i infrastrukurës fizike të sistemit prokurorial	10	18570	500,000	(74,301)	(79,000)	(137,904)		68,719	54,453	79%	24%
Mjetet e transportit	10	15216	360,000					360,000			
Dizajnimi dhe furnizimi me mobile KPK dhe PSRK	10	18573	5,000					0			
Aparat Digjital	10	19081	12,000					12,000			
Totali			1,489,000.00					697,795.00	225,795	32.36%	

Tabela 9: Projektet kapitale

Gjatë vitit 2023, Këshilli ka realizuar 32.36% të buxhetit përfundimtar të ndarë në këtë kategori.

Projekti 18566 “Blerja e tokës PTH Mitrovicë”- Këshilli Prokurorial i Kosovës ka bërë përpjekje të vazhdueshme për të siguruar parcelën për ndërtimin e objektit të Prokurorisë Themelore në Mitrovicë por nuk pasur asnjë përgjigje nga niveli komunal sa i përket kësaj çështjeje dhe për këtë arsye ky projekt nuk është zbatuar gjatë këtij viti.

Projekti 18570 “Ndërtimi dhe përmirësimi i infrastrukurës fizike të sistemit prokurorial”- në të cilën përveç objektit të PTH Mitrovicë përfshihet edhe ndërtimi i objektit për PTH Prizren. Këshilli me kërkesë i është drejtuar institucioneve përgjegjëse për ndarjen e një parcele afër parcelës së ndarë për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, por ende nuk ka ndonjë përgjigje pozitive. Për këtë arsye gjatë vitit 2023 nga ky projekt janë bërë disa transfere në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve për të mbuluar shpenzimet e krijuara për këtë vit.

Projekti 18004 “Sistemi për Menaxhimin Informativ të Lëndëve-SMIL”- Gjatë vitit 2023 janë planifikuar të bëhen rreth 20 avancime të reja në SMIL, ku në kuadër të këtij numri përfshihen edhe raportet. Fillimisht iu është dhënë prioritet avancimeve të cilat kanë qenë të nevojshme të bëhen si rezultat i ndryshimeve ligjore. Megjithatë, kontarta nuk është zbatuar sipas planifikimeve të bëra për këtë vit nga ana e operatorit teknik, andaj ndaj operatorit teknik janë marra masa ndëshkuese sipas bazës ligjore dhe kushteve të kontratës.

Projekti 18069 “Sistemi Elektronik për Menaxhimin e Rasteve në ZMNV”- është ende në proces të prokurimit.

Projekti 15217 “Sistemi Elektronik për Menaxhimin e Dosjes së Prokurorëve”- në pjesë është përfunduar, ndërsa procesi për pjesën e mbetur është anuluar.

Projekti 15216 “Mjetet e Transportit” – proceduarat e prokurimit për zbatim të këtij projekti janë zhvilluar nga AQP dhe në fund të vitit 2023 procesi ka qenë në fazën e ankesave.

5.4. Të hyrat

Duke u bazuar në nenin 230, paragrafin 1.2 të Kodit të Procedurës Penale, sistemi prokurorial ka filluar të inkasojë të hyra nga qershori i vitit 2018 në dobi të fondit për kompensimin e dëmit të viktimave të veprave penale dhe në bazë të raportit të të hyrave për sistemin prokurorial. Totali i të hyrave për vitin 2023 është 47,760.00 euro.

Prokuroria Themelore Prishtina	Prokuroria Themelore Pejë	Prokuroria Themelore Mitrovicë	Prokuroria Themelore Gjilan	Prokuroria Themelore Ferizaj	Prokuroria Themelore Prizren	Prokuroria Themelore Gjakovë	Totali
45,900.00	210.00	300.00	800.00	550.00	-	-	47,760.00

Tabela 11: Inkasimi i të hyrave sipas prokurorive

5.5. Donacionet

Gjatë vitit 2023, Këshilli nga organizatat ndërkombëtare ka përfituar mbështetje me një kosto prej gjithësejt 360,431€.

Mbështetja nga donatorët është ofruar kryesisht në formë të shërbimeve dhe buxheti është menaxhuar nga vet donatorët.

Aktivitetet (trajnime, tryeza etj)	Vlera në euro
AMBASADA BRITANIKE	113,000
AMBASADA AMERIKANE	190,766
EUKOJUST	11,506
KoSEJ III	10,159
IMG	35,000
TOTALI	360,431

Tabela 12: Donacionet

IV. PJESA E KATËRT

6. Bashkëpunimi me institucione dhe organizata të tjera

Këshilli ka vazhduar politikën e bashkëpunimit të hapur dhe profesional me të gjitha institucionet vendore dhe ndërkombëtare.

Një bashkëpunim ndërinstitucional i veçantë është zhvilluar me institucionet vendore, si me: Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Qeverinë e Republikës së Kosovës, Akademinë e Drejtësisë, Ministrinë e Drejtësisë, Odën e Avokatëve të Kosovës dhe Policinë e Kosovës, ndërsa me institucionet, donatorët dhe partnerët ndërkombëtarë, bashkëpunimet më të rëndësishme janë zhvilluar me Ambasadën Amerikane, Ambasadën Britanike, Zyrën e BE-së në Prishtinë, UNDP-në dhe agjencitë e tjera të Kombeve të Bashkuara, Qeverinë e Norvegjisë, EULEX-in, Këshillin e Evropës, IRZ-në, GIZ-in, etj.

Një pjesë e rëndësishme e bashkëpunimit është shprehur edhe në proceset e integritetit evropian, me ç'rast të gjitha kapacitetet e Këshillit janë përgjigjur në çdo kohë ndaj kërkesave për raportim.

V. PJESA E PESTË

7. Raporti vjetor i punës së Prokurorit të Shtetit për vitin 2023

Raporti i punës së Prokurorit të Shtetit për vitin 2023 paraqet punën e Prokurorit të Shtetit të realizuar nga të gjitha prokuroritë e Kosovës. Ky raport është hartuar duke u bazuar në të dhënat statistikore të përgatitura nga prokuroritë, të përpunuara në nivel vendi nga zyrat përkatëse në kuadër të sistemit prokurorial.

Raporti ka një strukturë e cila iu mundëson lexuesve që të orientohen dhe të kuptojnë lehtësisht proceset e punës së Prokurorit të Shtetit dhe të informohen për rezultatet e punës, duke i paraqitur ato në mënyrë të thjeshtësuar, nga disa këndvështrime.

Në këtë raport, puna e Prokurorit të Shtetit është paraqitur sipas strukturës si më poshtë:

- Raporti i punës në nivel vendi sipas numrit të kallëzimeve-lëndëve penale të bartura nga viti paraprak, të pranuar, të zgjidhura dhe të pazgjidhura;
- Raporti për parashtruesit e kallëzimeve penale;
- Raporti i punës sipas prokurorive;
- Raporti i punës sipas departamenteve; dhe
- Raporti i punës sipas efikasitetit të prokurorive;

7.1. Kallëzimet – lëndët penale në punë

Prokurori i Shtetit (PSH) gjatë vitit 2023 ka pasur në punë gjithsejtë 141,230 kallëzime – lëndë penale (regjistrat: PP, PPM, PPN, NJN, PPP, lëndët e PA-së dhe ZKPSH-së).

Nga ky numër i lëndëve:


- 89,137 ose 62.78% janë të trashëguara/bartura si lëndë të pazgjidhura nga vitet paraprake; dhe
- 52,093 ose 36.88% janë pranuar në punë gjatë vitit 2023;

Gjatë këtij viti, nga ky numër i lëndëve:

- 41,973 se 29.71% e lëndëve në punë gjatë vitit 2023, janë zgjidhur apo proceduar në organet kompetente;
- 99,257 ose 70.28% e të gjitha lëndëve në punë kanë mbetur pa u zgjidhur;


Efikasiteti i lëndëve të zgjidhura gjatë vitit 2023 është:

- 10,120 kallëzime-lëndë penale janë zgjidhur më pak se që janë pranuar gjatë periudhës raportuese, apo
- 19.42% kallëzime – lëndë penale më pak se që janë pranuar.




Grafikoni 18: Numri i lëndëve në punë, të bartura, të pranuar, të zgjidhura dhe të pazgjidhura gjatë vitit 2023

Lidhur me numrin e personave që kanë qenë të përfshirë në lëndët me kryes të njohur madhor (PP) dhe të mitur (PPM) që janë trajtuar qofshin ato të bartura, të pranuar, të zgjidhura apo të pazgjidhura kemi situatën si më poshtë:



Grafikoni 19: Numri i rasteve të personave në punë, të bartura, të pranuar, të zgjidhura dhe të pazgjidhura gjatë vitit 2023

Numri i personave që kanë qenë të përfshirë në lëndët me kryes të njohur madhor (PP) dhe të mitur (PPM) që janë trajtuar qofshin ato të bartura, të pranuar, të zgjidhura apo të pazgjidhura në PSRK dhe sipas departamenteve kemi situatën si më poshtë:




Grafikoni 20: Numri i rasteve të personave në punë, të bartura, të pranuar, të zgjidhura dhe të pazgjidhura gjatë të vitit 2023 në PSRK dhe sipas departamenteve të PTH

7.2. Lëndët e bartura nga viti 2022 në vitin 2023

Nga viti 2022 në vitin 2023 janë bartur gjithsej 89,137 lëndë-kallëzime penale në të gjitha departamentet dhe sipas të gjithë regjistrave të prokurorive. Sipas regjistrave për të gjitha llojet e kallëzimeve-lëndëve penale, gjendja e lëndëve të bartura është si më poshtë:

- 8,769 kallëzime penale të kryesve madhor (PP) të veprave penale ose 9,83%;
- 681 kallëzime penale të kryesve të mitur (PPM) të veprave penale ose 0,76%;
- 67,202 lëndë penale me kryes të panjohur (PPP) të veprave penale ose 75,39%;
- 11,860 lëndë të ndryshme penale (PPN/M) ose 13,30%;
- 610 lëndë të ndihmës juridike ndërkombëtare (NJN) ose 0,68%;
- 0 lëndë në Prokurorinë e Apelit (PA) ose 0,% dhe
- 15 lëndë në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit (ZKPSH) ose 0,01%.




Grafikoni 21: Kallëzimet - lëndët penale të bartura nga viti 2022

7.3. Lëndët e pranuar gjatë vitit 2023

Gjatë vitit 2023 janë pranuar në punë 52,093 kallëzime-lëndë penale, prej të cilave sipas regjistrave në Prokurorinë e Shtetit, janë si më poshtë:

- 22,972 kallëzime penale të kryesve madhor (PP) të veprave penale ose 44,09%;
- 1,868 kallëzime penale të kryesve të mitur (PPM) të veprave penale ose 3,58%;
- 7,772 lëndë penale me kryes të panjohur (PPP) të veprave penale ose 14,91%;
- 9,515 lëndë të ndryshme penale (PPN/M) ose 18,26%;
- 291 lëndë të ndihmës juridike ndërkombëtare (NJN) ose 0,55%;
- 8,272 lëndë në Prokurorinë e Apelit (PA) ose 15,87% dhe
- 1,403 lëndë në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit (ZKPSH) ose 2,69%.




Grafikoni 22: Kallëzimet – lëndët penale të pranuar në punë gjatë vitit 2023

7.4. Lëndët e zgjidhura


Nga 41,973 kallëzime-lëndë penale që janë zgjidhur gjithsej sipas regjistrave të prokurorive përfshirë këtu edhe ZKPSH-në, Prokurorinë e Apelit dhe PSRK-në, pasqyrohet situata si më poshtë:

- 20,430 kallëzime penale të kryesve madhor (PP) të veprave penale ose 48,67%;
- 1,391 kallëzime penale të kryesve të mitur (PPM) të veprave penale ose 3,31%;
- 2,784 lëndë penale me kryes të panjohur (PPP) të veprave penale ose 6,63%;
- 7,220 lëndë të ndryshme penale (PPN/M) ose 17,20%;
- 465 lëndë e ndihmës juridike ndërkombëtare (NJN) ose 1,10%;
- 8,272 lëndë në Prokurorinë e Apelit (PA) ose 19,70 %, dhe
- 1,411 lëndë në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit (ZKPSH) ose 3,36%.




Grafikoni 23: Kallëzimet - lëndët penale të zgjidhura gjatë vitit 2023

Norma e zgjidhjes së lëndëve nga Prokurori i Shtetit në vitin 2023 sipas indikatorëve të CEPEJ paraqitet si më poshtë:




Grafikoni 24: Norma e zgjidhjes së lëndëve nga Prokurori i Shtetit gjatë vitit 2023 sipas indikatorëve të CEPEJ (lëndët e zgjidhura në raport me lëndët e pranuar)

Krahasuar me vitin 2021 norma e zgjidhjes së lëndëve sipas indikatorëve të CEPEJ, paraqitet si më poshtë:



Grafikoni 25: Norma e zgjidhjes së lëndëve nga Prokurori i Shtetit mes viteve 2021 v. 2023 sipas indikatorëve të CEPEJ (lëndët e zgjidhura në raport me lëndët e pranura)

Krahasuar me vitin 2022 norma e zgjidhjes së lëndëve sipas indikatorëve të CEPEJ, paraqitet si më poshtë:




Grafikoni 26: Norma e zgjidhjes së lëndëve nga Prokurori i Shtetit mes viteve 2022 v. 2023 sipas indikatorëve të CEPEJ (lëndët e zgjidhura në raport me lëndët e pranura)

7.5. Lëndët e pazgjidhura

Në fund të vitit 2023, të pazgjidhura kanë mbetur 99,257 kallëzime-lëndë penale, prej të cilave janë:


- 11,311 kallëzime penale të kryesve madhor (PP) të veprave penale ose 11,39%;
- 1,158 kallëzime penale të kryesve të mitur (PPM) të veprave penale ose 1,16%;
- 72,190 lëndë penale me kryes të panjohur (PPP) të veprave penale ose 72,73%
- 14,155 lëndë të ndryshme penale (PPN/M) ose 14,26%;
- 436 lëndë të ndihmës juridike ndërkombëtare (NJN) ose 0,43%;
- 0 lëndë në Prokurorinë e Apelit (PA) ose 0%, dhe
- 7 lëndë në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit (ZKPSH) ose 0,00%;



Grafikoni 27: Kallëzimet- lëndët penale të pazgjidhura në fund të vitit 2023

7.6. Lëndët në punë, të zgjidhura dhe të pazgjidhura

Numri i kallëzimeve-lëndëve penale në punë, të zgjidhura dhe ato të mbetura në fund të vitit 2023, sipas regjistrave pasqyrohen në grafikonin në vijim.




Grafikoni 28: Kallëzimet – lëndët penale në punë, të zgjidhura dhe të pazgjidhura në fund të vitit 2023

Sipas pasqyrimit në grafikonin më lartë, numri më i madh i kallëzimeve–lëndëve penale në punë i përket:

- Kryesve të panjohur të veprave penale (PPP), me 74,974 ose 53,08%;
- Kryesve madhor të veprave penale (PP), me 31,741 ose 22,47%;
- Lëndë të ndryshme penale (PPN/M), me 21,375 ose 15,13%.
- Kallëzimet penale të kryesve të mitur (PPM), me 2,549 ose 1,80%;
- Lëndët penale të Prokurorisë së Apelit me 8,272 ose 5,85%;
- Lëndët e ZKPSH-së 1,418 ose me 1,00%.
- Lëndët e ndihmës juridike ndërkombëtare (NJN) 901 ose me 0,63%.

7.7. Krahasimi i lëndëve të pranuar dhe të zgjidhura mes vitit 2022 dhe 2023

Në grafikonin në vijim pasqyrohet krahasimi i kallëzimeve-lëndëve penale (PP, PPM, PPN/M dhe PPP) të pranuar dhe të zgjidhura në mes të vitit 2022 dhe vitit 2023:



Grafikoni 29: Krahasimi i lëndëve të pranuar në punë dhe të zgjidhura në mes të vitit 2022 dhe 2023 për regjistrat PP, PPM, PPN/M dhe PPP

Numri i kallëzimeve penale të kryesve madhor (PP) të pranuar në punë gjatë vitit 2023, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2022, është zvogëluar për 286 kallëzime penale ose 1.22%. Ndërsa numri i kallëzimeve penale të kryesve madhor (PP) të zgjidhura gjatë vitit 2023, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2022, është zvogëluar për 1,234 kallëzime penale ose 5.69%.

Numri i kallëzimeve penale të kryesve të mitur (PPM) të pranuar në punë gjatë vitit 2023, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2022, është rritur për 285 kallëzime penale ose 18.00%. Ndërsa numri i kallëzimeve penale të kryesve të mitur (PPM) të përfunduara gjatë vitit 2023, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2022, është zvogëluar për 271 kallëzime penale ose 16.30%.


Numri i lëndëve penale të ndryshme (PPN), të pranuar në punë gjatë vitit 2023, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2022, është rritur për 312 ose për 3.39% të lëndëve. Ndërsa numri i lëndëve penale të ndryshme (PPN), të përfunduara gjatë vitit 2023, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2022, është zvogëluar për 1,392 ose për 16.16% të lëndëve.

Numri i lëndëve me kryes të panjohur të veprave penale (PPP), të pranuar në punë gjatë vitit 2023, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2022, është rritur për 358 ose 4.82%. Ndërsa numri i lëndëve me kryes të panjohur të veprave penale (PPP), të përfunduara gjatë vitit 2023, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2022, është rritur për 14 ose 0.50%.

7.8. Trajtimi i rasteve me procedura alternative dhe të veçanta

Trajtimi i rasteve me procedura alternative synon dhënien e drejtësisë në një kohë sa më të arsyeshme dhe shkarkimin e prokurorëve nga barra e numrit të madh të lëndëve. Po ashtu, procedurat e veçanta (për dhënien e urdhrit ndëshkimor) kanë një rëndësi mjaft të madhe në punën dhe efikasitetin e PSH-së.

Si rezultat i punës, Prokurori i Shtetit me procedura alternative ka zgjidhur 2,746 raste gjatë vitit 2023 me 4,154 persona. Prej tyre 116 raste me 153 persona me pezullim të përkohshëm të procedurës, 23 raste me 26 persona sipas kushteve kur ndjekja nuk është e detyrueshme, 2,252 raste me 3,570 persona në procedurën e ndërmjetësimit, dhe 355 raste me 405 persona me aktakuzë për marrëveshjen e pranimit të fajësisë.



Grafikoni 30: Lëndët e zgjidhura me procedura alternative

Nga të dhënat e mësipërme rezulton se nga numri total i rasteve të zgjidhura (20,335 kallëzime penale - PP në të gjitha prokuroritë themelore) nga Prokurori i Shtetit përmes procedurave alternative janë zgjidhur 2,746 raste apo 13,50% e rasteve të zgjidhura PP me 4,154 persona apo 16,34% të personave të zgjidhur PP.


Ndërsa lidhur me aktakuzat me urdhrat ndëshkimor, PSH gjatë vitit 2023 ka zgjidhur 2,651 raste.

7.9. Parashtruesit e kallëzimeve penale

Në këtë pjesë do të paraqiten të dhënat lidhur me parashtruesit dhe numrin e parashtruesve të kallëzimeve penale për lëndët të cilat janë pranuar në punë gjatë vitit 2023.

7.9.1. Parashtruesit e kallëzimeve penale të kryesve madhor të veprave penale (PP)

Gjatë vitit 2023, për lëndët me persona madhor (PP), Prokuroritë Themelore dhe PSRK kanë pranuar në punë gjithsej 22,972 kallëzime penale me 29,699 persona. Këto kallëzime penale janë parashtruar nga:




Grafikoni 31: Parashtruesit e kallëzimeve penale PP

Nga të dhënat statistikore për parashtruesit e kallëzimeve penale, vërehet se numri më i madh i kallëzimeve penale është parashtruar nga Policia e Kosovës me 18,623 kallëzime penale ose 75,96%.

7.9.2. Parashtruesit e kallëzimeve penale të kryesve të mitur të veprave penale (PPM)

Departamentet për të Mitur (DM-të) të Prokurorive Themelore në periudhën raportuese kanë pranuar 1,867 kallëzime penale ndaj 2,755 personave të mitur. Këto kallëzime penale janë parashtruar nga:

Parashtruesit e kallëzimeve penale PPM



Grafikoni 32: Parashtruesit e kallëzimeve penale nga PPM

Nga ky grafikon shihet se numri i më i madh i kallëzimeve penale është parashtruar nga Policia e Kosovës me 1,831 kallëzime ose 98,07% nga të gjitha kallëzimet penale PPM.

7.10. Kallëzimet penale sipas prokurorive

Mbështetur në statistikat për numrin e kallëzimeve penale të pranuar gjatë vitit 2023, në tabelën në vijim pasqyrohet numri i kallëzimeve penale të pranuar për kryesit madhor (PP), kryesit e mitur (PPM), lëndë të ndryshme penale (PPN) dhe kryesit e panjohur të veprave penale (PPP) sipas kompetencës territoriale të prokurorive themelore dhe PSRK-së:

PTH+PSR K	Regjistri PP		Regjistri PPM		Regjistri PPN		Regjistri PPP		Gjithsej	
	Kallëzim et e pranuara	Nr. i kryesve	Kallëzim et e pranuara	Nr. i kryesve	Kallëzim et e pranuara	Nr. i kryesve	Kallëzim et e pranuara	Nr. i kryesve	Kallëzi met e pranuara	Nr. i kryesve
Prishtinë	8,852	11,161	779	1062	2,537	NA	3,742	NA	15,910	12,223
Prizren	2,633	3,521	195	335	1601	NA	750	NA	5,179	3,856
Pejë	2,746	3,461	182	274	1415	NA	612	NA	4,955	3,735
Gjilan	2,184	2,685	126	177	1095	NA	525	NA	3,930	2,862
Mitrovicë	2,397	2,987	172	228	745	NA	921	NA	4,235	3,215
Ferizaj	2,122	2,748	200	327	863	NA	1019	NA	4,204	3,075
Gjakovë	1,930	2,555	213	352	1050	NA	199	NA	3,392	2,907
PSRK	108	581	1	1	209	NA	4	NA	322	582
Gjithsej	22,972	29,699	1,868	2,756	9,515	NA	7,772	NA	42,127	32,455

Tabela 13: Kallëzimet - lëndët penale të pranuar për kryesit madhor (PP), kryesit e mitur (PPM), lëndë të ndryshme penale (PPN) dhe kryesit e panjohur (PPP) të veprave penale sipas prokurorive

VI. PJESA E GJASHTË

8. Aktivitetet e Sekretariatit të Këshillit

Sipas Ligjit nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, Sekretariati është njësi e themeluar brenda Këshillit, me qëllim të ofrimit të mbështetjes administrative për Këshillin dhe prokuroritë.

Detyrat dhe përgjegjësitë e Sekretariatit janë përcaktuar me Ligjin për Këshillin dhe Rregulloren nr. 02/2023 për Veprimtarinë, Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Administratës në Këshillin Prokurorial të Kosovës. Kjo Rregullore ka hyrë në fuqi më 26 qershor 2023 dhe struktura e administratës e paraqitur në këtë raport është e paraqitur sipas këtij riorganizimi.

Struktura organizative e Sekretariatit është e organizuar në këtë mënyrë:

- Zyra e Drejtorit të Përgjithshëm Sekretariatit me këtë përbërje:
 - Njësia e Auditimit të Brendshëm;
 - Njësia e Prokurimit;
 - Njësia për Komunikim Publik;
 - Njësia për Panele Hetimore;
 - Njësia për Integrim Evropian dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare;
 - Koordinatori i Komisioneve të Përhershme të Këshillit;
 - Zyrtari Certifikues, si dhe
 - Stafi Profesional dhe Administrativ si në vijim:
 - Zyrtari i Lartë Ekzekutiv dhe
 - Zyrtari i Transportit.
- Departamenti për Burime Njerëzore me këtë përbërje:
 - Divizioni për Paga dhe Shërbime të Prokurorëve;
 - Divizioni për Staf Administrativ.
- Departamenti për Buxhet dhe Financa me këtë përbërje:
 - Divizioni për Buxhet dhe të Hyra;
 - Divizioni për Financa
- Departamenti për Administratë dhe Shërbime të Përgjithshme me këtë përbërje:
 - Divizioni për Arkivim
 - Divizioni për Logjistikë dhe Mirëmbajtje
 - Divizioni për Siguri dhe Transport
 - Divizioni për Përkthim dhe Lekturim.
- Departamenti për Teknologji Informative me këtë përbërje:
 - Divizioni për Infrastrukturë (Rrjet dhe Server) dhe

- Divizioni për Sisteme Elektronike (Softuer).
- Departamenti Ligjor me këtë përbërje:
 - Divizioni për Çështje Ligjore dhe Mbështetje të Komisioneve të Këshilit dhe
 - Divizioni për Përfaqësim Ligjor.

Detyrat dhe përgjegjësitë e njësive organizative të Sekretariatit janë përcaktuar me Rregulloren nr. 02/2023 për Veprimtarinë, Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Administratës në Këshillin Prokurorial të Kosovës.

8.1. Zyra e Drejtorit

Zyra e Drejtorit udhëhiqet nga Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit (Drejtori), i cili është zyrtari kryesor administrativ, me përgjegjësi dhe kompetencë kryesore për administrimin dhe menaxhimin e administratës së Këshillit dhe Prokurorit të Shtetit.

I gjithë aktiviteti, shërbimet dhe mbështetja që i është ofruar Këshillit dhe Prokurorit të Shtetit është e bazuar në Planin strategjik të sistemit prokurorial 2022-2024 dhe Planet vjetore të punës së Këshillit dhe Prokurorit të Shtetit për vitin 2023. Këto aktivitete janë realizuar nën mbikëqyrjen dhe menaxhimin e drejtpërdrejtë të Drejtorit.

Veprimtaria, menaxhimi dhe administrimi i Zyrës së Drejtorit gjatë vitit 2023 në përgjithësi është fokusuar, por pa u kufizuar në veprimtarinë e auditimit të brendshëm, certifikimit, hartimin e planeve të punës për njësitë organizative të Sekretariatit, hartimin e raporteve, dokumenteve, vendimeve, kërkesave dhe shkresave të ndryshme në mbështetje për Këshillin dhe Prokurorin e Shtetit.

Po ashtu, aktivitetet e Zyrës së Drejtorit janë përqendruar në mbështetjen e komisioneve të përhershme dhe ad-hoc, në hartimin e planeve të punës dhe raporteve të ndryshme për Këshillin dhe Prokurorin e Shtetit.

Fokus tjetër shumë i rëndësishëm i Zyrës së Drejtorit ishte edhe fusha e integriteteve evropiane, ku është punuar në raporte shumë profesionale për plotësimin dhe zbatimin e kriterëve të parapara për realizim nga sistemi prokurorial.

Rëndësi të veçantë në vitin 2023 ka pasur edhe fusha e komunikimit publik, në të cilën është punuar dhe angazhuar drejt ngritjes së transparencës dhe orientimeve strategjike.

Gjatë vitit 2023, me qëllim të fuqizimit të administratës së sistemit prokurorial në forma të ndryshme, janë zhvilluar aktivitete të shumta të bashkëpunimit me partnerët vendorë dhe ndërkombëtarë.

8.1.1. Njësia e Auditimit të Brendshëm

Auditimi i Brendshëm si veprimtari e pavarur, mbështet menaxhmentin e subjektit të sektorit publik në përmbushjen e objektivave, gjithnjë duke ofruar siguri objektive dhe këshillim, për të shtuar vlerën e organizatës dhe duke nxitur ndryshime që përmirësojnë veprimtarinë e menaxhimit, efikasitetit dhe rritjen e përgjegjshmërisë.

Në ushtrimin e veprimtarisë, NjAB i është përmbajtur parimeve dhe objektivitetit gjatë kohës së auditimit, ashtu siç është përcaktuar në Ligjin për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, Standardeve të Auditimit si dhe Praktikave Profesionale.

Njësia e Auditimit të Brendshëm është përgjegjëse për kryerjen e auditimeve të brendshme të gjitha njësive strukturale, programeve, aktiviteteve dhe proceseve në organizatë.

Njësia e Auditimit të Brendshëm ka përcaktuar dhe ka specifikuar auditimet kryesore të cilat lidhen me njësitë e synuara, si:

- Rishikimi i procesit të prokurimit.
- Menaxhimi i shpenzimeve.
- Menaxhimi i parasë së gatshme.
- Menaxhimi i logjistikës.
- Menaxhimi i pasurisë.
- Menaxhimi i personelit.
- Përkrahja e vazhdueshme profesionale.
- Dhënia e këshillave për nëpunësit.

NjAB, gjatë vitit 2023, ka kryer auditime të planifikuara sipas planit vjetor. Këtu përfshihen auditimet e pajtueshmërisë, të cilat kryesisht mbulojnë këto fusha: menaxhimi i burimeve njerëzore, procedim i pagave për punonjësit, proceset buxhetore, shpenzimet, të hyrat, paraja e gatshme, menaxhimi i pasurive, të dhënat për pasuritë dhe mirëmbajtja e tyre, prokurimi dhe procedurat e zhvilluara; për punë, furnizime dhe shërbime si dhe auditimi i zhvilluar në ZMNV, për të vlerësuar kontrollin e brendshëm. Sipas planit vjetor ishin planifikuar gjithsej pesë auditime dhe janë realizuar të gjitha në kohë, shprehur në përqindje 100% e planit vjetor është realizuar. NjAB, reflekton në angazhimin sistematik për përmbushjen e objektivave të njësisë me qëllim të funksionimit të organizatës. Informatat tregojnë se me efikasitet është realizuar niveli i planifikuar. Pavarësisht kësaj, NjAB në KPK ende funksionon vetëm me një auditor edhe pse me ligj duhet të jenë së paku tre auditor. Në vazhdim shpalosim njësitë të cilat ju kanë nënshtruar procesit të auditimit për vitin 2023.

- Auditimi i përfunduar në fushën e burimeve Njerëzore me temë: "Funksionimi i sistemit për rekrutimin e stafit dhe procesi i pagave" në këtë auditim janë dhënë katër rekomandime.

- Auditimi në Divizionin e Shërbimeve të Përgjithshme me temë: "Funksionimi i sistemit për shërbimet dhe pasuritë". Ky auditim ka rezultuar me shtatë rekomandime për zbatim;
- Auditimi në Divizionin e Buxhetit dhe Financave me temën: "Funksionimi i sistemit për proceset buxhetore dhe financiare". Në raportin final janë evidentuar dy rekomandime.
- Auditimi për Divizionin e Prokurimit me temë "Funksionimi i sistemit dhe proceset e prokurimit". Në raportin final janë evidentuar katër rekomandime për zbatim;
- Auditimi i përfunduar për Zyrën për Mbrojtje dhe Ndihmë të Viktimave me temë "Sistemi financiar dhe i pasurisë në ZMNV" janë dhënë shtatë rekomandime për zbatim.

Të gjitha të gjeturat dhe rekomandimet ishin trajtuar mirë paraprakisht dhe ishin diskutuar me udhëheqësit e njëjësive, të cilët iu kanë nënshtruar auditimit të rregullt. Për këtë vit, sipas planit vjetor, ishin paraparë të auditohen pesë njësi organizative, prej tyre, tri auditime me rrezikshmëri të lartë dhe dy auditime me rrezikshmëri të mesme. Sipas verifikimit për zbatimin e rekomandimeve deri në fund të vitit 2023, janë zbatuar gjithsej 9 rekomandime, ndërsa 14 rekomandime janë në proces të zbatimit dhe 1 rekomandim i pazbatuar.

8.1.2. Njësia e Prokurimit

Gjatë vitit 2023, Njësia e Prokurimit ka nënshkruar gjithsej 23 kontrata dhe ka përfunduar 2 procedura të prokurimit në vlerë të madhe, 14 procedura të Prokurimit në vlerë të mesme, si dhe 6 Procedura të Koutimeve të çmimeve dhe 1 procedurë me vlerë minimale si në vijim:

Procedurat e prokurimit në vlerë të mëdha:

- Mirëmbajtja Higjienike në Objektet e Sistemit Prokurorial të Republikës së Kosovës
- Sigurimi Fizik i Objekteve të Sistemit Prokurorial të Kosovës

Procedurat e prokurimit në vlerë të mesme:

- Furnizim me pajisje të Teknologjisë Informative
- Ri - tender Finalizimi, Vazhdimi i punimeve për objektin e Prokurorisë Speciale të Kosovës
- Ri - tender Furnizim me Materiale Promocionale Zyrtare të dizajnuara dhe të shtypur për nevojat e Sistemit Prokurorial të Republikës së Kosovës
- Ri- tender Mirëmbajtja Teknike në objektet e Sistemit Prokurorial të Republikës së Kosovës
- Sigurimi i automjeteve të Sistemit Prokurorial të Kosovës dhe sigurimi i shëndetit në udhëtim
- Furnizim me pajisje të TI-së për nevojat e Sistemit Prokurorial-për avancimin e Qendrës së të dhënave në Pallatin e Drejtësisë
- Ri-tender, Furnizim me Licenca Softuerike dhe Mirëmbajtje për nevojat e Sistemit Prokurorial
- Furnizimi me Pelet për Objektin e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë

- Kontrollimi Teknik i Ashensorëve në objektet e Sistemit Prokurorial të Republikës së Kosovës
- Furnizim me Material Zyrtar për nevojat e Sistemit Prokurorial të Republikës së Kosovës
- Mirëmbajtja, Plotësim-ndryshimet, Postimet dhe kohëzgjatjen e Domeneve dhe Hostingut aktual të Ueb portalit të Sistemit Prokurorial të Republikës së Kosovës
- Furnizim me Paisje tjera për nevojat e Sistemit Prokurorial të Republikës së Kosovës
- Ritender Servisimi dhe Mirëmbajtja e Veturave të Sistemit Prokurorial të Kosovës
- Mirëmbajtja Higjienike në Objektin C të Pallatit të Drejtësisë

Procedurat e prokurimit të koutimeve të çmimeve që janë nënshkruar kontratat:

- Shtypjen dhe Furnizimin e Ligjeve për rekrutimin e Prokurorëve
- Mirëmbajtja Higjienike në Objektin C të Pallatit të Drejtësisë
- Paisje me qira për organizimin e konferencave për nevoja të Sistemit Prokurorial të Republikës së Kosovës
- Mirëmbajtja, furnizimi dhe servisimi i aparateve kundër zjarrit dhe hidrantëve të ujit në Objektet e Sistemit Prokurorial të Kosovës
- Furnizimi me kurora dhe buqeta lulesh
- Ritender Furnizimi, Mirëmbajtja dhe funksionalizimi i Vulave për nevojat e Sistemit Prokurorial të Republikës së Kosovës

Procedurat e prokurimit për vlerat minimale që janë nënshkruar kontratat:

- Furnizim me Extenal Hard Drive për nevojat e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës

Aktivitetet e prokurimit të cilat kanë përfunduar procedurat e prokurimit dhe pritjet të nënshkruhen kontratat:

- Mirëmbajtja e Qendrës së të dhënave në Pallatin e Drejtësisë
- Sigurimi fizik i objekteve të Sistemit Prokurorial të Kosovës.
- Ritender Mirëmbajtja dhe servisimi i paisjeve të TI-së në Sistemin Prokurorial të Kosovës
- Janë proceduar gjithësej 231 lëndë me Urdhërblerja për pagesë në vlerë totale prej 1,375,333.00€

Ndër aktivitetet më të rëndësishme në fushën e Njësisë së prokurimit përfshihen:

- përgatitja e planit të Prokurimit i dorzuar në AQP sipas LPP;
- përgatitja e raportit të kontratave të nënshkruara dhe shpenzimi për KRPP sipas LPP;
- Udhëheqja e procedurave sipas planifikimit ;
- ruajtja dhe arkivimi i lëndëve të prokurimit etj.

8.1.3. Njësia për Komunikim Publik

Njësia për Komunikim Publik e Sekretariatit të KPK-së gjatë vitit 2023 është angazhuar në forcimin e kapaciteteve profesionale të shërbimit të komunikimit publik, me ç'rast ka koordinuar aktivitetet trajnuese me Fondacionin Gjerman për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar (IRZ) dhe institucionet e tjera vendore dhe ndërkombëtare për forcimin e kapaciteteve profesionale të komunikimit publik. Me këtë rast është realizuar një punëtori dyditore me ekspertët gjermanë, më 24-25 tetor 2023, si dhe një vizitë studimore e 10 zyrtarëve për komunikim publik të sistemin prokurorial, më 13-17 nëntor 2023, lidhur me punën me shtypin dhe marrëdhëniet me publikun të organeve të drejtësisë gjermane, ku janë vizituar gjykatat, prokuroritë, Ministria e Drejtësisë dhe policia e Dyseldorf-it dhe Wuppertal-it në Landin e Nordrheinwestfahlen-it. Përfitimi i ekipit të zyrtarëve për komunikim publik ishte marrja e përvojës për organizmin dhe shtrirjen e punës të komunikimit, bazuar në parimet dhe direktivat më të mira të punës me mediat dhe publikun nëpërmjet shembujve, standardeve dhe praktikave më të mira të institucioneve gjermane.

Gjithashtu, edhe promovimi i rëndësisë së zbatimit të Ligjit për Qasje në Dokumente Publike dhe ngritja e transparencës në sistemin prokurorial përmes qasjes në dokumente publike dhe në informacion janë trajtuar në një punëtori të organizuar më 28 shtator 2023 me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Qasje Universale në Informacion, me mbështetjen e Ambasadës Amerikane në Prishtinë së bashku me Agjencinë për Informim dhe Privatësi (AIP), në të cilën trajnerë ishin dy ekspertë amerikanë.

Njësia për Komunikim Publik kontribuoi edhe në një punëtori të përbashkët katërditore me përfaqësuesit e organeve të Legjislativit, Ekzekutivit, Gjyqësorit, Zyrës së Presidentes dhe institucioneve të tjera ligjzbatuese për hartimin dhe finalizimin e akteve nënligjore, të cilat derivojnë nga Ligji Nr.08/L - 178 për Mbrojtjen e Informacionit të Klasifikuar për finalizimin e akteve nënligjore që derivojnë nga ky Ligj, punëtori kjo, e cila është mbështetur nga OSBE-ja dhe është mbajtur nga data 3-6 dhjetor 2023.

Rrjedhimisht, në kuadër të transparencës publike, KPK-ja ka caktuar më 27 korrik 2023 me vendim Zyrtarin Përgjegjës për Qasje në Dokumente Publike të Sistemit Prokurorial, i cili vije nga radhët e Njesisë për Komunikim Publik. Më 2023, KPK-ja ka dhënë përgjigje në kohë reale në 43 raste pas kërkesave për qasjen në dokumente publike në kërkesat e parashtruara për qasje në dokumente publike, informata dhe të dhëna statistikore. Ka mbetur në proces një (1) rast. Gjatë vitit 2023 janë hartuar dhe publikuar në uebfaqe: 331 materiale të ndryshme, 68 komunikata, 11 reagime dhe 20 njoftime për media.

Njësia për Komunikim Publik në bashkëpunim me Zyrën për Komunikim Publik në ZKPSH ka përgatitur në muajin mars 2023 një fushatë vetëdijesuese përmes një videospoti lidhur me punën e sistemit prokurorial dhe oraret e mbajtjes së takimeve të prokurorive me qytetarë ku kanë pasur mundësi të parashtronë nevojat dhe ankesat që mund të kenë.

Kryesuesi, anëtarët e KPK-së dhe zyrtarët i Zyrës për Komunikim Publik (tash: Njësia për Komunikim Publik) në vitin 2023 kanë pasur prezencë nëpër media, qoftë përmes dhënies së informacioneve apo intervistave me shkrim.

Ridizajnimi i uebportalit është në procedurë nga UNDP-ja, si donator, kurse Njësia kontribuoi në kuadër të Grupit punues për definimin e kërkesave për zhvillimin e uebportalit të ri të sistemit prokurorial. Pas realizimit të procedurave administrative nga UNDP-ja, gjatë pjesë së dytë të gjashtëmujorit të parë të vitit 2023, është përzgjedhur kompania fituese për ridizajnim, e cila ka kryer shumicën e dizajnit dhe është në proces të bartjes së materialeve dhe funksionalizimit të plotë të tij dhe mbetet që në pjesën e parë të vitit 2024 të lansohet për publikun, ndërsa uebportali aktual në vazhdimësi është përditësuar dhe fuqizuar me informata të reja.

Më 4 shtator 2023 është lansuar edhe rrjeti social i Facebook-ut dhe kanali Youtube për sistemin prokurorial, të financuara nga Ambasada Amerikane në Prishtinë, duke realizuar edhe transmetimin live për publikun të takimeve të Këshillit. Transmetimi direkt, përmes rrjetit social, Facebook, i takimeve të hapura të Këshillit Prokurorial të Kosovës për media dhe publikun, përbën transparencë publike.

Aktivitetet dhe veprimtaria e KPK-së janë publikuar në buletinet mujorë për vitin 2023, kurse akte nënligjore janë vënë në konsultim publik për OJQ-të, mediat dhe palët e interesuara, me ç'rast Njësia ka menaxhuar marrjen e komenteve dhe ua ka proceduar komisioneve përkatëse.

Është organizuar dhe moderuar Konferenca e fundvitit për media e Kryesuesit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, z.Jetish Maloku, më 28 dhjetor 2023, në të cilën është prezantuar puna njëvjeçare të KPK-së

Njësia për Komunikim Publik ka dhënë mbështetje institucionale procese pune, duke dhënë propozime konkrete lidhur me: krijimin e e-bibliotekës së sistemit prokurorial, konkretisht për hartimin e një liste të burimeve elektronike, të lëshuara në përdorim ndërkombëtar lidhur me aspektet e praktikave dhe standardeve më të mira ndërkombëtare, të cilat do t'u hynin prokurorëve në funksion të punës së tyre, ku artikujt mund të shtypen dhe linku përkatës mund t'i lidhë drejtpërdrejt në librat apo materialet online nga google book, saktësisht në rubrikën Praktikant, sigurimin e bazës së linçeve për një bazë të të dhënave që përshtaten apo janë të përafërta me natyrën e sistemit tonë prokurorial, krijimin e një hapësire përbrenda e-bibliotekës, ku mund të vendosen materiale me interes pas vlerësimit nga një panel profesional, ku mund të vendosen literatura dhe materiale të tjera të konsiderueshme nga ligjëratat e mbajtura të ekspertëve vendorë dhe ndërkombëtarë me rastin e programeve të trajnimeve, seminareve, punëtorive dhe tryezave, si resurse shtesë dhe të rëndësishme, në mbështetje të sistemit prokurorial dhe publikut në harmoni me standardet më të larta ndërkombëtare dhe hartimin e një katalogu të plotë të bibliotekës (katalogu udhëzon shpejt dhe qartë përdoruesit), i cili ofron një listë të kompletuar të artikujve që futen në e-bibliotekë.

Po ashtu, Njësia dha kontribut përgjatë tërë vitit 2023 në grupe punuese dhe në proceset e punës së komisioneve përkatëse të KPK-së lidhur me hartimin e drafteve dhe akteve nënligjore të sistemit prokurorial dhe jashtë tij, si dhe ka vënë në dispozicion të dhënat mediale për vlerësimin e performancës së 28 prokurorëve.

Në kuadër të aktiviteteve të veçanta, Njësia, në saje të ekspertizës gjuhësore të Zyrtarit të Lartë për Komunikim Publik në Njësinë (tash U.D. Udhëheqës i Njesisë për Komunikim Publik, edhe

gjatë vitit 2023 ka lekturuar në mënyrë vullnetare dhjetëra e dhjetëra dokumente të KPK-së, përfshirë procesverbalet e takimeve të KPK-së, aktet nënligjore dhe administrative të KPK-së.

Në kuadër të sfidave që ndërliken drejtpërdrejt me Njësine për Komunikim Publik janë: moskompletimi i Njesisë me staf dhe menaxhimi i Njesisë me Ushtrues Detyre; jofunksionaliteti i uebit aktual dhe vonesa e lansimit të uebportalit të ri të sistemit prokurorial dhe migrimi i plotë dhe me kohë i të dhënave nga uebfaqja aktuale në uebportalin e ri dhe Mosmbajtja e takimeve koordinuese përbrenda shërbimit të komunikimit publik dhe mospjesëmarrja në takimet e udhëheqësve institucionalë (në rastet kur nuk ka ndjeshmëri diskutimesh për çështjet e sistemit prokurorial).

8.1.4. Njësia për Panele Hetimore

Njësia për panele hetimore ka ofruar ndihmë profesionale dhe administrative në mbështetje të paneleve hetimore të themeluara nga Këshilli.

Kjo Njësi në kuadër të kompetencave të veta gjatë kësaj periudha ka regjistruar të gjitha kërkesat e pranuar, i ka dorëzuar në Këshill dhe ka ofruar asistencë gjatë takimeve të Këshillit kur janë trajtuar kërkesat për fillimin e procedurës disiplinore ndaj prokurorëve.

Njësia po ashtu ka kryer detyrat e veta sa i përket mbështetjes së paneleve hetimore të themeluara nga Këshilli e ndër të përfshihen:

- Njoftohen anëtarët e Panelit Hetimor me vendim dhe me të gjitha shkresat e lëndës
- Përgatitet seanca konsultative (gjatë seancës anëtarëve të panelit ju ofrohet mbështetje profesionale dhe administrative)
- Njoftohet subjekti i hetimit udhëzohet për të drejtat në procedurë disiplinore
- Organizohet seanca dëgjimore e subjektit të hetimit, seanca e dëgjimit të dëshmitarëve, sigurohen prova shtesë, në raste të veçanta bëhet edhe verifikimi nëse për rastin e hetimit disiplinor ka edhe hetim penal
- Përgatitet draft raporti / Marrëveshja vullnetare
- Përgatitet transkripti i seancave
- Dorëzohet Raporti / Marrëveshja në Këshill

Pas përfundimit të procesit nga ana e panelit hetimor, njësia asiston Këshillin për të përgatitur seancën disiplinore si dhe në përpilimin e akteve dhe shkresave të nevojshme për rastet në fjalë.

Njësia po ashtu përgatit raporte të rregullta dhe sipas kërkesës së njësive të Këshillit apo edhe kërkesave nga jashtë.

8.1.5. Njësia për Integrim Evropian dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare

Njësia për Integrim Evropian dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare është angazhuar gjatë vitit 2023 në koordinimin e aktiviteteve të njësive organizative të Sekretariatit të Këshillit dhe Prokurorit të Shtetit për hartimin e raporteve për çështjet e integritimit evropian, përcaktimin e prioriteve të sistemit prokurorial në fushën e integritimit evropian, përgatitjen e projekt propozimeve dhe

objektivave për përkrahje nga donatorët dhe partnerët zhvillimorë që përkrahin sistemin prokurorial.

Gjatë vitit 2023, në baza tre mujore Njësia ka raportuar në njësitë përkatëse brenda Zyrës së Kryeministrit lidhur me zbatimin e aktiviteteve të sistemit prokurorial në Programin Kombëtar për integrim evropian për vitin 2023 dhe, në koordinim me njësitë brenda sistemit prokurorial ka propozuar masat zbatuese dhe legislative për vitin 2024. Po ashtu, në baza tre mujore Njësia ka raportuar për zbatimin e masave në Agjendën e Reformës Evropiane (ERA II).

Sipas kërkesës së trupave të Bashkimit Evropian, Njësia ka ofruar informata dhe ka hartuar raporte lidhur me kontributin në Raportin për vendin të Komisionit Evropian, nënkomitetin për drejtësi, liri dhe siguri si dhe misionet vlerësuese të Bashkimit Evropian ku ka koordinuar pjesëmarrjen e përfaqësuesve të sistemit prokurorial dhe ka hartuar raporte lidhur me zbatimin e rekomandimeve të këtyre mekanizmave.

u.d. Udhëheqësi i Njesisë është caktuar në rolin e Koordinatorit Nacional në Platformën elektronike të Bashkimit Evropian për rastet e Korrupsionit të Nivelit të Lartë, Krimin të Organizuar dhe shpëlarjes së parasë në kuadër të së cilës ka marrë pjesë në 3 punëtori ndërshtetërore me shtetet e Ballkanit lidhur me funksionalizimin e kësaj platforme.

Njësia po ashtu ka koordinuar procesin e hartimit të Planit Startegjik të Sistemit prokurorial Planit të punës së Këshillit dhe Raportit vjetor të punës së Këshillit si dhe është pjesë e Grupit punues për Monitorimin e Zbatimit të Planit Strategjik të Sistemit Prokurorial 2022-2024.

8.1.6. Koordinator i Komisioneve të Përherhshme të Këshillit

Koordinatori i Komisioneve të Përherhshme të Këshillit në bashkëpunim dhe kërkesë të kryesuesve të komisioneve është angazhuar në koordinimin e aktiviteteve dhe në hartimin e planeve dhe raporteve të punës.

Gjatë vitit 2023 ka hartuar raporte përshkruese periodike (3, 6 dhe 9 mujore) për veprat penale karakteristike të Mekanizmit Përcjellës Ndërinstitucional.

Ka hartuar raportin analitiko-krahasimor 10 vjeçar (2013-2022) për veprat penale karakteristike të Mekanizmit përcjellës ndërinstitucional, përfshirë kapitullin e gjeografisë së krimit. Për më tej, në këtë raport ka ofruar rekomandimet specifike të cilat janë miratuar në Këshill, përfshirë rekomandimin për largimin e subjektit EPK dhe 4 veprave penale të Drogave nga Mekanizmi Përcjellës Ndërinstitucional. Në reflektim të ndryshimeve të Kodit të procedurës penale, ka rekomanduar përfshirjen e të dhënave lidhur me ankesat e palëve në Prokurorinë e Apelit ndaj hudhjes së kallëzimit penal dhe pushimit të hetimeve. Po ashtu, ka rekomanduar dhe ka ofruar mjetet konkrete për hartimin e projektit strategjik “Profilizimi i prokurorëve”.

Është angazhuar në hartimin disa akteve nënligjore, ka dhënë kontributin profesional në punëtorinë lidhur me vlerësimin e performancës nga Eprorët.

Vullnetarisht ka dhënë kontribut në sferën e protokollit zyrtar për organizimin dhe mbarëvajtjen e konferencës vjetore të prokurorëve dhe organizimin e javës për të drejtat e viktimave të krimit.

Në cilësinë e sekretarit të Komisionit për Vlerësimin e Performances së Prokurorëve, i emëruar nga Këshilli Prokurorial i Kosovës, ka hartuar programin e punës, për vitin 2024, për vlerësimin e prokurorëve me mandat të përhershëm dhe fillestar. Për më tej, në aspektin administrativ ka organizuar 22 takime të Komisionit për Vlerësimin e Performances së Prokurorëve, në kuadër të cilave janë vlerësuar 52 prokurorë (48 me mandat të përhershëm dhe 4 me mandat fillestar).

Është angazhuar në hartimin e raportit përmbljedhës vjetor 2022 të vlerësimit të performancës së 170 prokurorëve në sistemin prokurorial, bazuar në vlerësimet vjetore të Eprorëve për prokurorët e prokurorive respektive.

Është angazhuar në hartimin e protokollit nr.1, si pjesë e memorandumit të bashkëpunimit në mes të KPK dhe AD, lidhur me zbatimin e trajnimit të detyrueshëm për prokurorët të cilët në vlerësimin e performancës kalojnë dobët dhe duhet të vijojnë trajnimin në Akademinë e Drejtësisë.

Në cilësinë e ideatorit të planit strategjik “Mbrojtja e votës” në kuadër të zgjedhjeve të përgjithshme dhe lokale në Republikën e Kosovës, ka hartuar aktet e nevojshme dhe ka mbikqyrë zbatimin e tyre në zgjedhjet lokale në katër komuna gjatë vitit 2023.

Për më tej, në cilësinë e ideatorit dhe menaxherit të projektit strategjik “Mbrojtja e votës” së bashku me anëtarët e grupit Kosovar, të përzgjedhur nga Ambasada e Amerikës në Prishtinë, ka marrë pjesë në punëtorinë në Institutin ILEA (Budapesht, Hungari), në temën krimet zgjedhore, në të cilën kanë marrë pjesë 5 shtete të ndryshme.

8.1.7. Zyrtari Certifikues

Procesi i certifikimit është procesi i fundit për pagesat e shpenzimeve të krijuara nga aktivitetet e realizuara brenda Këshillit. Si obligime të bartura nga viti 2022 në vitin 2023 janë në shumën totale 332,550.14 €. Për shpenzimet e krijuara brenda vitit 2023 janë certifikuar 9,885 lëndë në shumën totale prej 3,251,331.18 €, duke përfshirë faturat e muajit dhjetor të vitit 2023, të cilat barten si obligime në vitin 2024. Obligimet e bartura nga viti 2023 në vitin 2024 janë 1,033 lëndë në shumën totale 203,264.09 €.

8.2. Departamenti për Burime Njerëzore

Departamenti për Burime Njerëzore, Prokurim dhe Administratë (DBNJPA), sipas mandatit të përcaktuar në Rregulloren nr. 02/2023 për Veprimtarinë, Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Administratës në Këshillin Prokurorial të Kosovës, renditet në një nga shtyllat e Sekretariatit.

Aktivitetet e Departamentit për Burime Njerëzore kanë qenë të orientuara në përbushjen e detyrave të përcaktuara si dhe objektivave sipas planifikimit duke u realizuar në kuadër të dy divizioneve, si në vijim:

- ❖ Divizioni për Paga dhe Shërbime të Prokurorëve
- ❖ Divizioni për Staf Administrativ

Gjatë ushtrimit të kompetencave të veta, në vitin 2023, duke u bazuar në objektivat e departamentit zhvillimet kryesore ishin:

- Hartimi i planit për procedurat e rekrutimit;
- rekrutimi i personelit administrativ sipas planifikimit;
- mirëmbajtja dhe plotësimi me dokumentacioni i dosjes së prokurorëve dhe krijimi i dosjes për prokurorët e rinj;
- realizimi i transferimeve dhe avancimeve të personelit administrativ bazuar në kërkesat dhe nevojat e sistemit duke mundësuar zhvillimin e karrierës brenda sistemit prokurorial;
- zbatimi i sistemit elektronik të burimeve njerëzore (SIMBNJ), sistem ky që mundëson menaxhimin efikas dhe pasqyrë në kohë reale të të dhënave për të gjithë zyrtarët e administratës së sistemit prokurorial;
- është ofruar mbështetje profesionale dhe administrative për Komisionin e Ankesave dhe Komisionin Disiplinor dhe
- është rritur bashkëpunimi nëpërmjet takimeve me nivele të ndryshme me qëllim të koordinimit, për ngritjen e efikasitetit dhe efektivitetit në procese të punës.

8.2.1. Divizioni për Paga dhe Shërbime të Prokurorëve

Divizioni për Paga dhe Shërbime të Prokurorëve gjatë vitit 2023 ka proceduar pagat në Thesarin e Shtetit, përkatësisht në Ministrinë e Financave, me të gjitha ndryshime dhe pagesat për tërë të punësuarit e Sistemit Prokurorial.

- Janë përgatitur dhe proceduar në Thesar 78 formularë për punëtorë të rinj, 285 formularë për ndryshime, 306 formularë retroaktiv, 41 formular për largime dhe 17 formularë për transfere bankare.
- Në bazë të Rregullores Nr.01/2021 për Dosjen Personale të Prokurorit të Shtetit qëllimi i DPSHP ka detyrë të krijojë, mirëmbajë, përditësojë, ruaj dhe menaxhojë shënimet në dosjen personale të Prokurorit të Shtetit siç është përcaktuar me këtë rregullore dhe legjislacionin përkatës në fuqi.
- Gjatë kësaj periudhe, Divizioni ka bërë përditësimin e Sistemit për menaxhimin e dosjes së prokurorëve me të gjitha lëvizjet e prokurorëve.

Bazuar në Ligjin për Buxhetin për vitin 2023 Këshilli i janë aprovuar 209 pozita për prokurorë të Shtetit.

Numri total i prokurorëve në fund të vitit 2023 në sistemin prokurorial kanë qenë 189.

8.2.2. Divizioni për Staf Administrativ

Në kuadër të Divizionit për Staf Administrativ janë realizuar aktivitete të ndryshme si dhe në zbatim të planifikimit të personelit për vitin 2023 dhe nevojave për plotësim të pozitave të lira ka zhvilluar procedurat të shumta të rekrutimit të pasqyruara si në vijim:

- Gjatë vitit 2023 janë shpallur konkurset për (tetëdhjetenjë) 81 pozita;
- Nga ky numër kanë filluar punën (gjashtëdhjetepesë) 65 zyrtarë të rinj dhe (tridhjetekatër) 34 janë në proces të emërimit, ndërsa (një) 1 ka mbetur në proces deri në Aktgjykimin e Gjykatës.

- Janë avancuar në karrierë (dy) 2 zyrtarë;
- Janë realizuar (tri) 3 transferime brenda sistemit prokurorial dhe (dy) 2 transferim nga institucionet tjera;
- Gjatë vitit 2023 janë anuluar 16 konkurse.
- Gjatë vitit 2023 janë liruar tridhjetegjashtë (36) pozita për shkak të pensionimit dhe dorëheqjeve.
- Divizioni për Staf Administrativ ka mbështetur Komisionin Disiplinor të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial gjatë vitit 2023 në rastet e paraqitura për inicimin e procedurave disiplinore.
- Divizioni ka mbështetur Komisionin për zgjedhjen e kontesteve dhe ankesave në Sekretariatit e Këshillit Prokurorial të Kosovës për trajtimin e ankesave të pranuar.
- Janë përgatitur dhe proceduar përgjigjet në ankesa lidhur me ankesa e ushtruara në KPMSHCK.
- Divizioni për Staf Administrativ në vitin 2023, ka realizuar pesë (5) transferime në pajtim me legjislacionin në fuqi.
- Janë koordinuar dhe caktuar zyrtarët për vijimin e trajnimeve të organizuara nga IKAP-i dhe Akademia e Drejtësisë.
- Janë përgatitur 206 vendime të ndryshme.
- Janë publikuar konkurse dhe kanë vijuar praktikën në të gjitha nivelet e prokurorive.

Numri total i zyrtarëve në fund të vitit 2023 ka qenë (gjashtëqindetëdhjetekatër) 684.

8.3. Departamenti për Buxhet dhe Financa

Bazuar në Rregulloren nr. 02/2023 për Veprimtarinë, Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Administratës në Këshillin Prokurorial të Kosovës, funksionon edhe Departamenti për Buxhet dhe Financa (më tej DBF)² në kuadër të së cilës Rregullore janë të përcaktuara përgjegjësitë e Departamentit dhe Divizioneve të veta.

Aktivitetet e DBF-së realizohen përmes:

- ❖ Divizionit për Buxhet dhe të Hyra dhe
- ❖ Divizionit për Financa

Përgjegjësitë e Departamentit për Buxhet dhe Financa si dhe përgjegjësitë e divizioneve të departamenti janë të përcaktuara me rregulloren Nr. 02/2023 për Veprimtarinë, Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Administratës në Këshillin Prokurorial të Kosovës.

Si aktivitete kryesore dhe të përgjithshme në kuadër të DBF-së janë:³

² Deri në qershor të vitit 2023 në bazë të Rregullos nr. 09/2016 për Veprimtarinë, Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Sekretariatit e Këshillit Prokurorial të Kosovës, ka funksionuar Departamenti për Buxhet, Financa dhe Shërbime të Përgjithshme me dy divizione: Divizionin për Buxhet dhe Financa dhe Divizionin për Shërbime të Përgjithshme.

³ Raportimi i aktiviteteve të realizuara brenda vitit (përfshirë edhe periudhën janar-qershor, që organizimi i brendshëm ka qenë i rregulluar me rreguloren nr.09/2016) për të gjitha njesitë janë pasqyruar sipas strukturës së re organizative.

- identifikimi dhe vlerësimi i nevojave për gjithë sistemin;
- përgatitja e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve dhe e Buxhetit vjetor për vitin 2024 dhe vlerësimet e hershme 2025-2026;
- analiza financiare për sigurimin e rregullores së brendshme për shtesa;
- menaxhimi dhe mbikëqyrja e buxhetit të vitit 2023;
- analiza dhe vlerësimi i shpenzimeve dhe buxhetit në baza të rregullta;
- sigurimi i zbatimit të projekteve kapitale sipas planifikimeve buxhetore;
- përgatitja e raportit dhe pyetësorit të vetëvlerësimit për vitin 2022;
- bashkëpunimi dhe koordinimi i ngushtë me Komisionin për Buxhet, Financa dhe Personel;
- bashkëpunimi dhe koordinimi i aktiviteteve brenda dhe jashtë Këshillit për çështje që lidhen me buxhetin dhe financat;
- koordinimi dhe bashkëpunimi i procesit të auditimit të pasqyrave financiare për vitin 2022 dhe auditimit të ndërmjetëm për vitin 2023;
- Raportimi në Komisionin për Mbikqyrje të Financave Publike për raport të auditimit të vitit 2022.
- Aryetimi i Kërkesës Buxhetore 2024-2026 në dëgjimet buxhetore.

Vlen të theksohet se te raporti final i auditimit për pasqyrat financiare të vitit 2022, opinioni është i pamodifikuar, që do të thotë se pasqyrat financiare paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, me vetëm një rekomandim të ri.

Buxheti dhe ekzekutimi i buxhetit për vitin 2023 është pasqyruar në detaje në pjesën e tretë të këtij raporti.

8.3.1. Divizioni për Buxhet dhe të Hyra

Në kuadër të Divizionit për Buxhet dhe të hyra janë realizuar aktivitete që kanë të bëjnë kryesisht me planifikimin e buxhetit dhe të hyrat për gjithë sistemin prokurorial.

Ndër aktivitetet më të rëndësishme në fushën e buxhetit dhe të hyrave janë:

- përgatitja e draft Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve për vitin 2024-2026;
- përgatitja e draft Kërkeses Buxhetore për vitin 2024 dhe vlereimet e hershme për vitet 2025-2026;
- bashkëpunimi me të gjitha njësit e Këshillit dhe Prokurorit të Shtetit për të identifikuar nevojat për buxhet;
- regjistrimi i buxhetit në BDMS;
- regjistrimi i të hyrave;
- barazimi i të hyrave
- analizat e nevojave për buxhet në raport me aktet e brendshme të Këshillit;

- përgatitja e kërkesave buxhetore për ndryshimin dhe harmonizimin e buxhetit brenda programeve buxhetore dhe kategorive ekonomike për vitin 2023;
- zbatimi i rekomandimeve të auditimit sipas planit të veprimit etj.

8.3.2. Divizioni për Financa

Në kuadër të Divizionit për Financa janë realizuar aktivitete që kanë të bëjnë kryesisht me ekzekutimin e buxhetit dhe menaxhimin e shpenzimeve për gjithë sistemin prokurorial.

Ndër aktivitetet më të rëndësishme në fushën e financave janë:

- përgatitja e rrjedhës së parasë së gatshme për vitin 2023;
- zbatimi i buxhetit sipas planifikimeve;
- përgatitja e Pasqyrave Vjetore Financiar për vitin 2022;
- përgatitja raporteve periodike financiare për vitin 2023;
- zotimi, shpenzimi dhe regjistrimi i mjeteve buxhetore sipas planifikimeve;
- ruajtja dhe arkivimi i lëndëve financiare;
- raportimet e rregullta sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi;
- barazimi i shpenzimeve;
- regjistrimi i pasurisë me vlerë mbi 1000euro;
- zbatimi i rekomandimeve të auditimit sipas planit të veprimit etj.

8.4. Departamenti për Administratë dhe Shërbime të Përgjithshme

Bazuar në Rregulloren nr. 02/2023 për Veprimtarinë, Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Administratës në Këshillin Prokurorial të Kosovës, funksionon edhe Departamenti për Administratë dhe Shërbime të Përgjithshme.

Aktivitetet e Departamentit realizohen përmes:

- ❖ Divizionit për Arkivim;
- ❖ Divizionit për Logjistikë dhe Mirëmbajtje;
- ❖ Divizionit për Siguri dhe Transport dhe
- ❖ Divizionit për Përkthim dhe Lekturim.

Gjatë ushtrimit të kompetencave të veta, në vitin 2023, duke u bazuar në objektivat e departamentit zhvillimet kryesore ishin:

- Është realizuar projektit për hapjen e dritareve në Pallatin e Drejtësisë;
- Është realizuar bartja e stafit të Këshillit dhe PSRK-së në objektin e rinovuar;
- Është realizuar projekti i mobileve për objektin e KPK dhe PSRK-së;
- Është lidhur Marrëveshje me Policinë e Kosovës për sigurinë në objektet e prokurorive;
- Është realizuar kyqja ne ngrohtoren e qytetit të objektit të PSRK-së;

- Është realizuar vlerësimi dhe tjetërsimi i pasurisë jo financiare për Sistemin Prokurorial;
- Është realizuar procesi i inventarizimit të pasurisë jo financiare;
- Është duke u realizuar barkodimi disa asetëve për personelin e Sistemit Prokurorial;
- Është realizuar shpërndarja e materialeve zyrtare;
- Është realizuar procedimi i projektit për barrierat e sigurisë në objektin e PSRK-së;
- Janë realizuar të gjitha për proceset tenderuese që është kërkuar nga plani i prokurimit;
- Është mbështetur procesi i planifikimit vjetor për prokurim;
- Janë proceduar kërkesat lidhur me furnizimet me materiale të nevojshme për punë, mobile, pajisje të teknologjisë informative, derivate, materiale shtypëse, etj;
- Janë kryer të gjitha mirëmbajtjet e objekteve dhe pajisjeve të Sistemit Prokurorial dhe Prokurorit të Shtetit;
- Është duke u realizuar krahasimi i të dhënave individuale me astete e regjistruara në Sistemin Prokurorial;
- Janë realizuar të gjitha procedurat për regjistrimin, shërbimet e qiras, autolarjet, servisimin dhe mirëmbajtjes së automjeteve;
- Janë zhvilluar takime me nivele të ndryshme të bashkëpunimit si brenda Sistemit Prokurorial ashtu edhe me institucione tjera;
- Janë rregulluar hapësirat e punës, depove dhe pjesëve tjera të ndërtesave;
- Është realizuar procesi i servisimit dhe mirëmbajtjes së pajisjeve kundër zjarrit.

8.4.1. Divizioni për Arkivim

Gjatë vitit 2023, në kuadër të Divizionit për Arkivim, dokumente të proceduara të cilat janë evidentuar në librin kryesor të protokollit janë gjithsej 2,067 dokumente të ndryshme, nga të cilat shkresa hyrëse, dalëse, vendime, raporte të ndryshme, autorizime, kontrata, parashtrësia, plane të punës, marrëveshje dhe memorandume bashkëpunimi, rregullore, deklarata, miratim i deklaratave, etj. Janë pranuar gjithsej 8,878 fatura nga prokuroritë të cilat janë pranuar nëpërmjet akteve përcjellëse, janë kontrolluar dhe proceduar tek Divizioni për Buxhet dhe Financa. Ndërsa fatura të pranuar nga operatorët ekonomik janë gjithsej 1,035 fatura.

8.4.2. Divizioni për Logjistikë dhe Mirëmbajtje

Gjatë vitit 2023 janë proceduar **320 lëndë ekzekutive** të evidentuara në librin intern. Lëndët janë një sërë aktivitësh, duke filluar me furnizime, mirëmbajtje apo punë nga shumë mekanizma valid që menaxhohen këto lëndë. Janë realizuar **630 kërkesa**, që kanë të bëjnë me materiale për zyrë, materiale shtypëse, furnizime me inventar, furnizime me pajisje tjera, etj., e që janë bërë dalje dhe furnizime nga depoja qendrore për personelin, njësitë, prokurorit dhe Sekretariatit e KPK-së. Në aplikacionin **E-pasuria** janë regjistruar **gjithsej 15 fatura, ngarkime 811, transfere 241 dhe shkarkime 312 pasuri jo financiare**. Në aplikacionin e Sistemit Informativ për Menaxhimin e Financave të Kosovës, është bërë **regjistrimi i 498 lëndëve**. Lëndët janë të programeve që e përbëjnë organizatën buxhetore të Këshillit Prokurorial të Kosovës.

8.4.3. Divizioni për Siguri dhe Transport

Puna e Divizionit për Siguri dhe Transport pasqyrohet në Urdhërat e Punës që përfshinë mirëmbajtjen e automjeteve të Sistemit Prokurorial të Kosovës dhe daljet sa i përket mirëmbajtjes

dhe servisimit të automjeteve zyrtare. Gjatë vitit 2023 janë lëshuar **205 urdhër të punës**, për mirëmbajtje dhe servisim të automjeteve dhe **67 autorizime** për përdorim të automjeteve zyrtare. Gjithashtu realizimi i projekteve dhe aktiviteteve në fushën e sigurisë në Sistemin Prokurorial të Kosovës.

8.4.4. Divizioni për Përkthim dhe Lekturim

Gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2023 Departamenti për Administratë dhe Shërbime të Përgjithshme ka arritur sipas kërkesave të realizojë përkthimet në gjuhë shqipe, serbe, angleze dhe anasjelltas me gjithsej 3,362 faqe të përkthyer, kurse përkthim simultant 169 orë. Departamenti për Administratë dhe Shërbime të Përgjithshme gjithashtu ka asistuar në disa prokurori me shërbime të përkthimit si përkrahje për materiale dhe përkthim simultant.

8.5. Departamenti për Teknologji Informative

Bazuar në Rregulloren nr. 02/2023 për veprimtarinë, organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e Këshillit Prokurorial të Kosovës funksionon edhe Departamenti për Teknologji Informative (më tej DTI).

Aktivitetet e DTI-së realizohen përmes:

- ❖ Divizionit të Infrastrukturës (rrjet dhe server) dhe
- ❖ Divizionit për Sisteme Elektronike (softuer).

Si aktivitete kryesore dhe të përgjithshme në kuadër të DTI-së janë:

- Gjatë vitit 2023, Departamenti i TI-së ka punuar në realizimin e prioriteteve, të cilat janë shtyllat e Planit strategjik, që ka për qëllim avancimin e digjitalizimit të punës së prokurorisë (e-prokuroria).
- Është përgatitur plani i punës për viti 2023 të Projektit TIK/SMIL të Fazës Tranzitore për gjykatat dhe prokuroritë e Kosovës. Projekti financohet nga ambasada Norvegjeze.
- Janë përgatitur:
 - Draft Udhëzimi Administrative për Sigurinë e Informacionit të sistemit prokurorial.
 - Procedura Standarde e Operimit për qasjen fizike në qendrën e të dhënave në Pallatin e Drejtësisë. Procedura është nënshkruar në mes të Departamentit të TI të Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës.
 - Plani i monitorimit të zbatimit të SMIL për të gjitha prokurorit, përkatësisht ngritja e kualitetit të të dhënave.
 - Raporti i analizës së rrezikut të infrastrukturës së TI në sistemin prokurorial.
- Implementimi dhe zbatimi i Projektit TIK/SMIL. SMIL është duke zbatuar në të gjitha Prokuroritë Themelore, Prokurorinë Speciale dhe Prokurorinë e Apelit ndërsa në Zyrën e

Kryeprokurorit të Shtetit nga data 1 janar kemi filluar në vënien në zbatim të sistemit ku janë duke ofruar asistencë/trajnime në tavolinën e punës për prokurorët dhe stafin administrativë.

- Pjesëmarrje në trajnimin e organizuar nga Projekti CEPEJ në Shqipëri – Durrës lidhur me ngritjen e efikasitetit të sistemit gjyqësor dhe zbatimin e SMIL.
- Është përgatitur raporti i aktiviteteve që janë realizuar në kuadër të Projektit TIK/SMIL për muajin janar - dhjetor '23. Raporti ju është dërguar donatorit (përfaqësuesve norvegjezë).
- Janë mbajtur takimet të rregullta me Komisionin për Administrimin e Prokurorive dhe janë diskutuar të gjitha çështjet që ndërlidhen me SMIL, duke filluar nga zbatimi, kualiteti i shënimeve, raportet statistikore, avancimi i SMIL etj. Në vazhdimësi janë paraqitur raportet për aktivitetet që janë realizuar në kuadër të SMIL.
- Është mbajtur punëtorja dy ditore në Hotel “Trofta” – Istog me temën zbatimin i monitorimit të SMIL të financuar nga Projekti EukoJust. Në këtë punëtori është prezantuar raporti për secilën prokurori lidhur me krahasimin e statistikave (manual – SMIL) si dhe problemet të cilat janë identifikuar.
- Monitorimi i vazhdueshëm i kualitetit të të dhënave në SMIL, përpilimi i raporteve mbi të gjeturat, koordinimi me grupet e interesimit për korrigjimin e gabimeve.
- Është mbajtur takim i përbashkët me Komisionin për Administrimin e Prokurorive dhe me Komisionin për Administrimin e Gjykatave ku janë diskutuar sfidat që janë duke u shfaqur gjatë procesit të punës së prokurorëve dhe gjyqtarëve në SMIL, nevojën e formimit të Grupit të përbashkët të punës së përdoruesve, i cili do të përbëhet nga prokurorë dhe gjyqtarë, si dhe nga stafi profesional, thjeshtësimin të procedurave të futjes së të dhënave në SMIL-it dhe lehtësimin e ndjeshëm të shkëmbimit të tyre ndërmjet instancave prokuroriale dhe gjyqësore në përgjithësi me theks të veçantë Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit - Gjykata Supreme.
- Është mbajtur takim me Drejtorin regjionale të Policisë së Kosovës ku janë diskutuar në mënyrë të detajuar aspektet që kanë të bëjnë me sigurimin e numrit personal për të gjitha llojet e palëve, regjistrimin e tyre, regjistrimin e veprave penale, trajtimin me kujdes të dyfishimit të lëndëve (sidomos ato të krimeve ekonomike), bashkëngjitjen e dokumenteve adekuate dhe dërgimin e kopjeve fizike në prokurori, si procedura të nevojshme që lehtësojnë punën e përbashkët në raportet ndërmjet Prokurorisë dhe Policisë.
- Janë mbajtur takim me përfaqësuesit e CEPEJ, janë diskutuar dizajnimin i raporteve të reja statistikore për punën e prokurorëve të cilat do të zhvillohen në SMIL.
- Është mbajtur takim me Administratorët e prokurorive dhe janë diskutuar të gjeturat të cilat i kemi identifikuar gjatë krahasimit të raporteve statistikore që janë përgatitur në mënyrë manual dhe ato elektronike nga SMIL.
- Bazuar në nevojat që janë paraqitur në sistemin prokurorial të Kosovës është përgatitur kërkesat për mbështetje financiar në IPA për investime në fushën e TI.
- Është përgatitur Raporti për Strategjinë për sundimin e ligjit për fushën e TI në sistemin prokurorial.

- Është përgatitur plani i trajnimeve profesionale përfshirë edhe certifikimet për stafin e Departamenti të TI për periudhën 2023 – 2024.
- Janë mbajtur takime me përfaqësuesit e UNDP lidhur me zhvillimin dhe mirëmbajtjen e portalit ueb portalin e sistemit prokurorial. UNDP ka financuar zhvillimin e ueb portalit të ri të sistemit prokurorial të Kosovës.
- Në bashkëpunim me UNDP, është përgatitur specifikacioni teknik për zhvillimin e sistemit elektronik e-libraria.
- Takim me përfaqësuesit e Akademisë së Drejtësisë, ku është diskutuar shkëmbimi elektronik në mes të sistemit për menaxhimin e dosjeve të prokurorëve dhe sistemit të akademisë për të dhënat e mbajtjes së trajnimeve të prokurorëve.
- Zbatimi, avancimi, mirëmbajtja e sistemeve elektronike të cilat janë në zbatim në sistemin prokurorial të Kosovës.
- Investime në infrastrukturën harduerike – pajisje të TI për sistemin prokurorial.
- Implementimi i rrjetit (Internetit) sekondar (backup) për të gjitha prokuroritë.
- Ngritja e niveli të sigurisë së informacionit.

Aktivitete tjera

- Janë përgatitur komentet lidhur me Draft Strategjinë për Siguri Kibernetike për periudhën 2023-2025.
- Me kërkesë të Komisionit për vlerësimin e sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimit me rëndësi strategjike janë plotësuar pyetësorët për sistemet elektronike të cilat janë duke u zbatuar në sistemin prokurorial. Të gjithë pyetësorë janë dërguar te komisioni për vlerësim.
- Pjesëmarrje në takimin ndërinstitutional për zbatimin e platformës elektronik për mundësimin e hetimeve të organizuar nga UNDP. Si rezultat i takimit pritet të përgatitet marrëveshja bashkëpunimi me institucionet të zbatimit të ligjit me qëllim të shkëmbimit elektronik të të dhënave.
- Pjesëmarrje në takim të grupit punues në Ministrinë e Drejtësisë. Tema e diskutimit: Digjitalizimi i sistemit të drejtësisë.
- Pjesëmarrje në eventin e organizuar nga IMG dhe Ambasada e Norvegjisë në lansimin e platformës elektronike LawData që mundëson qasje të lehtë në të gjitha ligjet dhe aktet nënligjoret të miratuara nga institucionet shtetërore të Republikës së Kosovës që nga viti 2008 në një format të strukturuar dhe të konsoliduar. Po ashtu, janë njoftuar të gjithë Kryeprokurorët për këtë platformë me qëllim të përdorimit gjatë punës së tyre.
- Pjesëmarrje në punëtorinë për hartimin e kurikulave trajnuese për Qendrën Shtetërore Trajnuese për Siguri Kibernetike e cila është organizuar nga Ministria e Mbrojtjes dhe FSK në bashkëpunim me programin e Ambasadën Britanike të implementuar nga Geneva Centre for Cyber Security Governance (DCAF).
- Pjesëmarrje online në programin Her Cyber Tracks që organizohet nga GIZ dhe ITU.
- Kemi bërë analizimin dhe kemi dërguar komentet në Projekt-Rregulloren për detyrat dhe përgjegjësitë e Qendrës Shtetërore Trajnuese për Siguri Kibernetike.

- Në kuadër të qëndrimit në hap me zhvillimet e teknologjisë, nga Divizioni për Infrastrukturë kanë marrë pjesë në edicioni e 12 të KosICT për teknologji informative. KosICT 2023 është një festival ku një here në vit mblidhen figurat më me ndikim në botën e teknologjisë në Kosovë. Edicioni i këtij viti pritet të mirëpres 35 folës, mbi 100 kompani vendase dhe te huaja si dhe mbi 3 mijë pjesëmarrës, një pjesë e madhe e të cilëve janë drejtues kompanish duke theksuar rëndësinë e festivalit në industrisë.
- Pjesëmarrje në eventin Cisco Security & Data Center Event të organizuar nga NOVUS.
- Pjesëmarrje në punëtori për përgatitjen e Draft Udhëzimin administrativ për procedurën e njoftimit dhe përmbajtjen e raportit të incidentit kibernetik. Kjo punëtori është nga Ministria e Punëve të Brendshëm.
- Janë përgatitur përgjigjet për pyetjet e parashtruar nga Rrjeti i Grave të Kosovës lidhur me digjitalizimin e procesit të punës në sistemin prokurorial.
- Pjesëmarrje në punëtori e cila është organizuar nga Këshilli Gjyqësor i Maqedonisë së Veriut me temën: Zhvillimet bashkëkohore në digjitalizimin e gjyqësorit. Në këtë punëtori, me ftesë të Këshillit Gjyqësor kemi prezantuar Sistemi për Menaxhimin Informativ të Lëndëve të prokurorisë.
- Pjesëmarrje në Punëtorinë e dytë të ekipit punues për hartimin e akteve nënligjore që dalin nga ligji për siguri kibernetike, e cila është mbështetur nga DCAF dhe OSBE; Në këtë punëtori janë diskutuar dhe dhënë komente në dy udhëzime administrative që dalin nga ligji për sigurinë kibernetike;
- Pjesëmarrje në Punëtorinë e organizuar nga Agjencia e Shoqërisë së Informacionit, me qëllim të thellimit të bashkëpunimit e bashkërendimit dhe koordinimit të aktiviteteve, si dhe planifikimit për vitin e ardhshëm me institucionet në fushën e TIK, me përkrahje të OSBE, me titull: “Workshop on digitalization of services and e-governance strategic objectives with government IT offices”.

8.5.1. Divizioni i Infrastrukturës (rrjet dhe server)

Në kuadër të Divizionit për Infrastrukture janë realizuar aktivitete që kanë të bëjnë kryesisht me çështje të rrjetit dhe serverit për gjithë sistemin prokurorial.

Aktivitet me më rëndësi për këtë vit janë si në vijim:

- Është bërë furnizimi dhe monitorimi i vazhduar të shërbimit të rrjetit në sistemin prokurorial të Kosovës. Gjatë viti 2023 shërbimet e rrjetit në të gjitha objektet e prokurorive ka qenë aktiv 100% të kohës dhe tërësisht funksional me kapacitete të plota dhe trafik të enkriptuar, po ashtu është monitoruar edhe ngarkesa e kapacitetit për 12 muajt e fundit si në grafikun e mëposhtëm:
- Është trajtuar niveli i sigurisë brenda infrastrukturës së TI-së me prioritet të lartë, duke aplikuar praktikat më të mira për mbrojtjen ndaj qasjeve të paautorizuara, sulmeve kibernetike, mesazheve me përmbajtje të padëshiruar, etj. Janë implementuar të gjitha masat e sigurisë së rrjetit, edhe për kundër sulmeve dhe viruseve të ndryshme kemi qenë të mbrojtur mjaft mirë, ku kemi monitoruar vazhdimisht avarit e mundshme brenda

rrjetit, në skemën e mëposhtme janë të paraqitura sulmet dhe tentimet për ndërhyrje brenda rrjetit:

- Është bërë avancimi dhe ndryshimi i konzoles menaxhuese për aplikacionin për mbrojtje nga viruset, për të minimizuar rrezikun që mund të shkaktojnë virusët e ndryshëm. Me qëllim të instalimit në mënyrë automatike të antivirusit te gjithë klientët në kuadër të domenit kpk-rks është instaluar versioni i fundit i Windows 10 22H2.
- Infrastruktura e serverëve është rritur dukshëm gjatë vitit të fundit, si rezultat i rritjes së shërbimeve, aktualisht kemi 58 serverë virtual të gjithë janë 24/7 up time, vetëm gjatë vitit 2023 janë instaluar dhe konfiguruar 14 server virtual dhe 3 server fizik me role të ndryshme të cilët ofrojnë shërbime të ndryshme brenda sistemit prokurorial.
- Është bërë furnizimi me pajisje me TI për nevojat e sistemit prokurorial (gjithsejtë 70 shtëpiza, 70 monitor dhe 7 llaptop). Është bërë shpërndarja e kompjuterëve sipas kërkesave të pranuar nga prokurorit si dhe servisimi i fotokopjeve dhe të printerëve.
- Janë bërë investime në rritjen e kapaciteteve të serverëve fizik në Qendrën e të Dhënave. Me rritjen e sistemeve është e nevojshme edhe avancimi i kapaciteteve harduerike.
- Janë realizuar të gjitha proceset e Backup sistemeve në pajtim me procedurën standarde për menaxhimin e proceseve. Të njëjtat janë validuar dhe janë konfirmuar.
- Është përgatitur raporti vjetor i shpenzimeve të telefonisë fikse për vitin 2023 për sistemin prokurorial.
- Është përgatitur raporti vjetor 2023 i shpenzimeve për printim, fotokopjim dhe skanim për të gjitha prokuroritë.
- Është instaluar sistemi i telefonisë VoIP në Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe Prokurorinë Speciale, janë furnizuar stafi me tel. si dhe është bërë demolimi i numrave të telefonisë fikse.
- Është bërë instalimi i pajisjeve simultante dhe zërimit si dhe funksionalizimi i tyre për përdorim në sallën e takimeve të KPK dhe në objektin e Prokurorisë së Shtetit. Po ashtu është bërë bartja e pajisjeve simultante si dhe instalimin e tyre në Prokurorinë Themelore Gjakovë.
- Përkritazi me njoftimin e pranuar nga Agjensioni i Shoqërisë së Informacionit, për përhapjen e email-ve keqdashës janë ndërmarrë të gjitha masat e rekomanduara si dhe është ofruar përkrahje teknike përmes telefoni dhe email-it për stafin të cilët kanë hasur në email-a të tillë.
- Janë mbajtur takime të rregullta me zyrtarët e TI-së regjional, ku janë diskutuar gjendja e pajisjeve të TI, infrastruktura e rrjetit dhe platformat elektronike në zbatim.
- Janë përgatitur specifikacionit teknik për furnizim me pajisje e TI (kompjuter, monitor dhe projektor) për nevojat e sistemit prokurorial të Kosovës.
- Është bërë servisimi i rregullt në Qendrën e të Dhënave, që përfshin servisimin e pajisjeve të klimatizimit, pajisjeve UPS-ve dhe koneksionet me energji elektrike, sistemi i kontrollit të qasjes dhe kamerave, sistemi për alarmim dhe fikje të zjarrit si dhe sistemi për detektimin e lagështisë.
- Është përgatitur specifikacioni teknik për mirëmbajtjen e Qendrës së të dhënave në Pallatin e Drejtësisë, e cila shfrytëzohet nga KPK dhe KGJK.

- Është përgatitur lista e të gjitha llojeve të licencave softuerike për vitin 2024 si dhe është dërguar Agjencionit të Shoqërisë së Informacionit për planifikim.
- Është bërë inicimi i procedurave për mirëmbajtjen e pajisjeve të TI-së. Kjo lëndë është në përputhje me planin e prokurimit me kohëzgjatje prej 3 vitesh.
- Është bërë pranimi i gjithsejtë 10 aparateve të sistemit të vijueshmërisë në punë nga Agjensioni i Shoqërisë së Informacionit. Është bërë ndërlidhje e barrierave në objektin e PSRK me sistemin e vijueshmërisë, janë shtuar 4 pajisje të reja të kontrollit të qasjes dhe është bërë regjistrimi i kartelave për të gjithë personat që kanë qasje në objekt (më shumë se 150 persona).
- Janë mbajtur trajnime për ngritjen e vetëdijes të përdoruesve në fushën e sigurisë kibernetike, stafit të Prokurorisë së Apelit, Prokurorive Themelore në Prishtinë, Prizren, Gjilan, Mitrovicë, Gjakovë, Pejë dhe Ferizaj.
- Është përgatitur raporti për gjendjen e infrastrukturës së TI (pajisje dhe rrjeti) për Prokuroritë Themelore Prizren, Gjilan dhe Ferizaj, përfshirë edhe gjendjen funksionale të pajisjeve.
- Në sistemit prokurorial janë realizuar 9335 intervenime të stafi i sistemin prokurorial për ofrimin e mbështetjes për përdorimin e pajisjeve të TI dhe sistemeve elektronike.

8.5.2. Divizioni për Sisteme Elektronike (softuer)

Në kuadër të Divizionit për Sisteme Elektronike janë realizuar një sërë aktiviteteve sipas planifikimit dhe nevojave.

- Ndër aktivitetet kryesore të zhvilluara nga ky divizion janë:
- Është bërë bartja e kodit burimor dhe të gjitha shënimeve të ueb faqes së sistemit prokurorial nga operatori ekonomik. Po ashtu është funksionalizuar dhe është bërë e qasshëm për publikun.
- Janë publikuar raportet të cilat janë zhvilluar në SEMDP për gjenerimin e informatave për prokurorët e avancuar, transferuar (përkohshëm dhe përhershëm), degraduar etj.
- Kemi mbajtur takim me stafin e Zyrës për Mbrojtje dhe Ndihmë të Viktimave me qëllim të përcaktimit të nevojave avancimin e sistemit elektronik të menaxhimit të rasteve si dhe zbatimi i plotë i sistemit elektronik në të gjitha regionet. Si rezultat i këtyre takimeve është përgatitur dokumenti i cili përmban kërkesat për avancimin e sistemit elektronik për menaxhimin e rasteve në ZMNV
- Është bërë administrimi dhe përkrahja e stafit për qasje dhe përdorim të sistemit e-pasuria dhe e-arkiva.
- Është zhvilluar versioni i parë i sistemit elektronik për menaxhimin e dokumenteve dhe takimit të KPK (e-këshilli). Kjo do të mundësojë që gjatë takimeve të KPK, anëtarët të kenë mundësi të qasjes në të gjithë materialit që do të diskutohet.

- Është përgatitur drafti i parë i Procedurës Standarde të Veprimit për Testimin e sistemeve elektronike. Kjo procedurë është përgatitur në bashkëpunim me ekspertet të cilët i ka angazhuar Projekti EukoJust.
- Është ofruar mbështetje stafit të gjykatave për regjistrimin e rasteve të nivelit të lartë në sistemin elektronik top50.
- Është përgatitur specifikacioni teknik për zhvillimin, implementimin dhe mirëmbajtjen e sistemit elektronik menaxhimin e buxhetit, financave dhe shërbimeve të përgjithshëm për sistemin prokurorial të Kosovës. Projekti është dërguar te EukoJust për mbështetje financiare.
- Është bërë hapja e rrjeteve sociale në Facebook dhe në kanalin Youtube për sistemin Prokuroria. Ky Projekt është në bashkëfinancim me Ambasadën Amerika. Po ashtu është mundësuar publikimi i takimeve drejtëpërdrejtë të KPK.
- Kemi filluar instalimin e sistemit elektronik e-learning apo mësimi në distancë. Ky sistem do të mundësojë mbajtjen e trajnimeve nga distanca për të gjithë të punësuarit në sistemin prokurorial.
- Është mbajtur takim me përfaqësuesit e Administratës Tatimore të Kosovës dhe është diskutuar mundësia e shfrytëzimit të veglës që mundëson gjenerimin e informatave për personat e dënuar përkatësisht pasurinë e tyre sipas kërkesave të prokurorëve në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit.
- Mirëmbajtja dhe ofrimi i përkrahjes për Sistemin Elektronik për Menaxhimin e Vijueshmërisë në Punë.
- Mirëmbajtja dhe ofrimi i përkrahjes për Sistemin Elektronik për Menaxhimin e Rasteve të Profilit të Lartë, bashkërendimi i aktiviteteve me institucionet e tjera si KGJK, Policia e Kosovës, ATK, Dogana dhe Njësia e Inteligjencës Financiare, institucione këto që përdorin sistemin.
- Mirëmbajtja dhe ofrimi i përkrahjes për Sistemin për Menaxhimin e Rasteve të Krimin të Organizuar dhe Korrupsionit - KrimKORR.
- Mirëmbajtja dhe ofrimi i përkrahjes për Sistemin për Menaxhimin e Veturave.
- Mirëmbajtja dhe ofrimi i përkrahjes për Sistemin për Menaxhimin e Arkiva.

8.6. Departamenti Ligjor

Bazuar në Rregulloren nr. 02/2023 për Veprimtarinë, Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Administratës në Këshillin Prokurorial të Kosovës funksionon edhe Departamenti Ligjor

Aktivitetet e Departamentit Ligjor realizohen përmes:

- ❖ Divizionit për Çështje Ligjore dhe Mbështetje të Komisioneve të Këshillit dhe
- ❖ Divizionit për Përfaqësim Ligjor

Si aktivitete kryesore dhe të përgjithshme në kuadër të Departamentit Ligjor janë:

- Gjatë vitit 2023 Departamenti Ligjor ka ofruar mbështetje ligjore në hartimin e dokumenteve strategjike nga fushëveprimtaria e Këshillit dhe ofrimin e mbështetjes ligjore në hartimin e legjislacionit sekondar;
- Hartimi i më shumë se 190 draft akteve nënligjore nga fushëveprimtaria e Këshillit dhe trupave të tjerë, si:
 - gjashtë draft rregulloreve, të miratuara nga Këshilli dhe një draft rregullore, e cila është në procedurë në Komisionin për Çështje Normative;
 - tri draft udhëzimeve administrative, të miratuar nga Këshilli;
 - 190 draft vendime të Këshillit.
- Kontrollim i pajtueshmërisë së akteve nënligjore të Këshillit me Kushtetutën e Kosovës dhe legjislacionin në fuqi në Kosovë;
- Ofrim i mbi 5 opinioneve dhe analizave ligjore për nevojat e Këshillit dhe trupave të tjerë;
- Hartim dhe shqyrtim i afro 552 shkresave të ndryshme nga fushëveprimtaria e Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe njësisve organizative të tij, duke përfshirë kontrollin ligjor të tyre, gjegjësisht:
 - Hartim i 422 draft vendimeve;
 - Hartim i 99 draft autorizimeve dhe
 - Hartim i 31 shkresave të ndryshme.
- Ofrimin e mbështetjes profesionale në grupe punuese dhe në komisionet e ndryshme të Sekretariatit;
- Është përfaqësuar Këshilli Prokurorial i Kosovës në 50 seanca gjyqësore;
- Janë draftuar gjithsej 30 përgjigje në padi për Gjykatat e Kosovës;
- Janë draftuar gjithsej 4 përgjigje në ankesa për Gjykatat e Kosovës;
- Është hartuar 1 ankesë për Gjykatën e Apelit;
- Janë hartuar 3 prapësime;
- Janë hartuar 6 parashtresa;
- Është bërë përditësimi i data bazës së seancave gjyqësore;
- Janë mbajtur gjithsej 14 takime në mbështetje të Komisionit për Çështje Normative.

8.7. Projekti TIK/SMIL

- Sistemi për Menaxhimin Informativ të Lëndëve është duke u zbatuar në prokuroritë themelore në Prishtinë, Pejë, Gjiilan, Gjakovë, Ferizaj, Prizren, Prokurorinë Speciale, Prokurorinë e Apelit dhe në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit.
- Janë trajnuar të gjithë stafi i Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit për përdorimin e SMIL. Po ashtu janë në proces të regjistrimit të lëndëve të cilat janë pranuar dhe statusi i tyre është e pazgjidhur.
- Janë vendosur të gjitha llojet e shablloëve të SMIL të Zyrës së kryeprokurorit të Shtetit.

- Është përgatitur Raporti i progresit për periudhën janar – dhjetor 2022 për Projektin TIK/SMIL, i cili përfshinë realizimin e të gjitha aktiviteteve në zbatimin e SMIL në prokurori dhe gjykata.
- Është zhvilluar pjesa e ankesës në SMIL sipas Kodit të Procedurës Penale duke u mundësuar Prokurorive Themelore regjistrimin si dhe dërgimin në Prokurorinë e Apelit.
- Është zhvilluar dhe publikuar në SMIL raporti statistikor për Prokurorinë e Apelit dhe Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit për punën e prokurorëve lidhur me lëndët e trashëguara, pranuar, të zgjidhura dhe mënyra e zgjidhjes së lëndëve.
- Është bërë avancimi i SMIL për pjesën e Prokurorisë së Apelit duke i vendosur të gjitha llojet e regjistrave sipas rregullores në fuqi.
- Sipas kërkesës së Komisionit për Vlerësimin e Performancës së Prokurorëve, është përgatitur raporti për përdorimin e SMIL për prokurorët që janë në proces të vlerësimit.
- Është bërë rialokimi i lëndëve të prokurorëve të transferuar dhe avancuar.
- Sipas kërkesave që kemi pranuar nga prokurorët është përgatitur raporti për ngarkesën me lëndë në punë si dhe shpërndarja e lëndëve të prokurorëve të pensionuar nga SMIL.
- Është përgatitur koncept dokumenti për formimin e grupit punës të Projektit TIK/SMIL si dhe përgjegjësit e këtij grupit. Komisioni për Administrimin e Prokurorive ka formuar grupin punës për monitorimin e zbatimit të SMIL.
- Në bashkëpunim me grupin punues për zbatimin e SMIL janë bërë vizita në Prokuroritë Themelore dhe në Prokurorinë e Apelit. Janë përgatitur për secilën prokurori – prokuror raporte ku janë krahasuar të dhënat statistikore në mes të raportit manual dhe atë elektronik si dhe janë njoftuar për dallimet në të dhënat. Janë mbajtur takime të rregulltat fizike dhe Online me Administratorët e Prokurorive si dhe me stafin administrativ ku janë njoftuar me raportin krahasues si dhe veprimet të cilat duhet të ndërmerren.
- Është përgatitur forma e raportimit për Administratorët e prokurorive lidhur me monitorimin e kualitetit të të dhënave në SMIL.
- Janë mbajtur takime me Komisionin për Administrimin e Prokurorive ku janë prezantuar aktivitetet që i kanë realizuar stafi mbikëqyrës për zbatimin e SMIL. Po ashtu me kërkesë të komisionit është përgatitur agjenda dhe lista e pjesëmarrëseve në punëtori që është mbajtur në fillim të muajit korrik.
- Është mbajtur punëtorja dy ditore e organizuar nga Projekti TIK – SMIL në Hotel “Dukagjini” – Pejë. Në këtë punëtori janë përgatitur katër lloje të pyetësorëve që kanë për qëllim matjen e përshtypjes në aspektin e përdorimit të SMIL, sa e ka ndihmuar procesin e punës si dhe cilat hapa duhet të avancohen.
- Kemi avancuar SMIL duke e vendosur dashboard (pamjen informuese) që tregon informatat për secilin prokuror në formë të diagrameve për lëndët e pranuar, të zgjidhura, mesatarja e lëndëve të zgjidhura dhe të pa zgjidhura etj.
- Është përgatitur raportit analitik për secilën prokurori i cili përmban të dhënat: Nr. i palëve të regjistruar me nr. personal, regjistrimi i Profesionit të palës, kohës së kryerjes së veprës etj.

- Në bashkëpunim me stafin e DTI së KGJK, janë definuar kërkesat për avancimin e SMIL për shkëmbimin elektronik të të dhënave në mes të Prokurorisë së Apelit - Gjykatës së Apelit dhe të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit – Gjykatës Supreme.
- Kemi mbajtur takim të vazhdueshme me përfaqësuesit Norvegjezë (donatorit të SMIL) ku kemi diskutuar aktivitetet të cilat janë realizuar në kuadër të Projektit TIK/SMIL të fazës tranzitore.
- Janë mbajtur takime të rregullta me Trajnerët e Projektit TIK/SMIL ku është diskutuar ri-trajnimi i prokurorëve dhe stafit administrativ si dhe kualiteti i shënimeve në SMIL.
- Janë mbajtur takim me përfaqësuesit e BE, EULEX dhe Projekti CEPEJ dhe EukoJust, pjesë e diskutimit ka qenë dizajnimi i raporteve të reja dhe ngritja e kualiteti të të dhënave.
- Pjesëmarrje në takim të kolegjiut të kryeprokuroreve dhe një ndër temat e diskutimit ishte zbatimi i SMIL me ç’rast janë njoftuar lidhur me të gjetura që kemi hasur gjatë monitorimit që kemi bërë në secilën prokurori për përdorimin e SMIL.
- Janë prezantuar regjistrat elektronik për kryerësit madhore, kryerësit e panjohur dhe lëndët e ndryshme të cilat gjenerohen nga SMIL. Përmes këtij aktiviteti planifikohen në të ardhmen të bëhet zëvendësimin i regjistrave fizike.
- Është përgatitur draft pyetësori për të matur kënaqshmërinë e zbatimit të SMIL si dhe modulet të cilat kërkohen nga përdoruesit të avancohen.
- Gjatë viti 2023 është bërë rekrutimi i një trajnerit i cili do të ofrojë mbështetje për përdorimin e SMIL stafit të Prokurorisë Themelore Prishtinë dhe Prokurorisë së Apelit.
- Është dërguar kërkesa në Odën e Avokatëve dhe është kërkuar lista e avokatëve të ri, me qëllim të regjistrimit në SMIL.
- Është ofruar përkrahje Trajnerëve të Projektit TIK/SMIL në fshirjen e të dhënave të regjistruar në mënyrë të gabuar, bartjen e lëndëve, përditësimin e të dhënave etj.
- Janë mbajtur takimet e rregullta të Bordit të Projektit si dhe të Grupit Punues të përdorueseve për mbikëqyrjen e zbatimit të Projektit TIK/SMIL.
- Është përgatitur raporti i shkëmbimit elektronik të të dhënave në mes të prokurorisë dhe Policisë i cili përmban informatat lidhur me sfidat të shfaqura nga Policia gjatë dërgimit të lëndëve përmes sistemit në prokurori.
- Janë mbajtur takime të rregullta me zyrtarët e Policisë së Kosovës dhe janë diskutuar sfidat të cilat janë identifikuar gjatë shkëmbimit elektronik të të dhënave në mes prokurorisë dhe policisë.
- Është mbajtur punëtorja me temën Prezantimi i raporteve për monitorimin e zbatimit të SMIL. Kjo punëtori është organizuar nga Komisioni për Administrimin e Prokurorive në bashkëpunim me Projektin EUKOJUST dhe pjesëmarrës ishin: Administratorët, Udhëheqësit e shkrimores dhe trajnerët e TI.
- Është përgatitur plani për ri-trajnimin e të gjithë prokurorëve dhe stafit administrativ në përdorimin e SMIL. Po ashtu janë mbajtur trajnime për të gjithë stafin të cilët janë identifikuar që kanë nevojë në përdorimin e SMIL.

- Është mbajtur takim me përfaqësuesit e Doganave dhe pjesë e diskutimit ishte mundësitë teknike për shkëmbimin elektronik të të dhënave në mes të prokurorisë (SMIL) dhe Doganës, përkatësisht përgatitja e Procedurës Standarde të Operimit.
- Kemi avancuar ndërlidhja e SMIL të prokurorisë dhe gjykatave duke mundësuar shkëmbimin elektronik të pothuajse të gjitha llojeve të veprimeve që ndërmerren nga ana e përdoruesve gjatë procesit të trajtimit të lëndëve.
- Është shtuar regjistri për bashkëpunim juridik ndërkombëtar për të gjitha prokurorit themelore dhe Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës.
- Me qëllim të rritjes së nivelit të sigurisë së të dhënave në SMIL është mundësuar auditimi i kërkimeve të dhënave për palë si dhe shkarkimi i dokumenteve të përdoruesve në sistemin SMIL
- Janë shtuar funksionalitetin në SMIL, si vijon:
 - ✓ Për rastet kur prokurorët janë avancuar ose janë bartur në prokurori tjetër;
 - ✓ Shtimin e dy profileve të reja si administrator i prokurorisë dhe analist i sistemeve;
 - ✓ Kërkimi i lëndëve përmes numrit të gjykatës;
 - ✓ Përditësimi i listës së dokumenteve që e ndryshojnë statusin e lëndës në të zgjidhur;
 - ✓ Përditësimi i detyrës bartë lëndës, ku është shtuar mundësia për referentët regjistruar ta përcaktojnë numrin e lëndës në regjistra gjatë pranimit të lëndës në kompetencë.
- Është përgatitur dhe publikuar raporti i ngarkimit me lëndë brenda vitit të caktuar me të dhënat të grumbulluara sipas regjistrimit përkatës.
- Është përgatitur dhe publikuar raporti për listën e rasteve të pranuar nga prokurori me mundësi filtrimi sipas prokurorisë, prokurorit, llojit të rastit, vitit të pranimit etj.
- Është përgatitur dhe publikuar raporti që mundëson filtrimin e të dhënave sipas datës së pranimit prej/deri, prokurorisë, departamentit, prokurorit, llojit të regjistrimit, parashtruesit dhe veprës penale.
- Është bërë instalimin e certifikatave digjitale në serverët e dedikuar për sistemin SMIL me qëllim të kalimit të trafikut nga kanale të ekriptuara dhe ekriptim të kopjeve rezervë.

VII. PJESA E SHTATË

9. Aktivitetet e Njësitit për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorisë

Njësitit për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorisë (tutje: Njësitit), duke u bazuar në kompetencat ligjore, gjatë vitit 2023 ka realizuar mbështetjen për Këshillin në proceset, si: rekrutimin, transferimin dhe avancimin e prokurorëve të Shtetit, emërimin e Kryeprokurorëve të Prokurorisë Speciale, Prokurorisë Themelore në Prishtinë dhe si dhe Prokurorisë Themelore në Gjakovë, Komisionin për vlerësimin e performancës së prokurorëve, Komisionin për administrimin e prokurorive, mbikëqyrjen dhe raportimin për punën e prokurorive, vlerësimin e nevojave për trajnim të prokurorëve dhe mbajtjen e shënimeve dhe bazave të të dhënave për punën e prokurorive.

Gjithashtu, Njësitit është angazhuar në ofrimin e mbështetjes për hartimin e akteve nënligjore të Këshillit, hartimin e dokumenteve strategjike dhe mbështetjen gjatë implementimit të SMIL-it. Njësitit i ka zhvilluar këto aktivitete nën mbikëqyrjen dhe koordinimin e drejtpërdrejtë të U.D. Drejtorit të NJSHP-së dhe përmes:

- Zyrës për Verifikim Prokurorial;
- Zyrës për Monitorim dhe Analitikë;
- Zyrës për Statistika dhe
- Zyrës së Trajnime dhe Zhvillim Profesional.

9.1. Zyra për Verifikim Prokurorial

Zyra për Verifikim Prokurorial (ZVP) bazuar në përgjegjësitë dhe mandatin e saj të përcaktuar me rregullore, gjatë vitit 2023 ka realizuar aktivitetet të cilat kanë pas në fokus zbatim e këtij mandati, me theks të veçantë në ofrimin e mbështetjes profesionale, administrative dhe teknike për Këshillin, Prokurorin e Shtetit dhe komisionet të Këshillit, në të gjitha proceset e zhvilluara për rekrutimin, avancimin, transferimin dhe emërimet e Kryeprokurorëve të Prokurorisë Speciale si dhe të prokurorive themelore në Prishtinë dhe Gjakovë.

9.1.1. Mbështetja e komisioneve të Këshillit

ZVP-ja ka ofruar mbështetje të vazhdueshme për Këshillin, Prokurorin e Shtetit, si dhe komisionet e Këshillit, si në vijim:

- Komisionet për rekrutimin, emërimin, dhe riemërimin e prokurorëve të Shtetit;
- Komisionin për transferimin dhe avancimin e prokurorëve;
- Panelet vlerësuese dhe Komisionet për Rishqyrim për proceset e kryeprokurorëve të prokurorive në kuadër të proceseve të zhvilluara gjatë vitit 2023;

9.2. Zyra për Monitorim dhe Analitikë

Zyra për Monitorim dhe Analitikë (më tej: ZMA) bazuar në përgjegjësitë dhe mandatin e saj të përcaktuar me rregullore, gjatë vitit 2023 ka realizuar aktivitetet të cilat kanë pas në fokus zbatim e këtij mandati, me theks të veçantë në ofrimin e mbështetjes profesionale, administrative dhe teknike për Këshillin, përkatësisht Sekretariatit e Këshillit Prokurorial të Kosovës (më tej: SKPK), Prokurorinë e Shtetit dhe komisionet e përhershme dhe ad hoc të Këshillit, në të gjitha proceset e zhvilluara, ku roli i Njësitit përkatësisht ZMA-së ka qenë i përcaktuar me akt normativ apo në secilin rast kur është kërkuar mbështetja.

ZMA, përmes angazhimit të zyrtarëve të caktuar, ka mbështetur Këshillin dhe Komisionin për Administrimin e Prokurorive në hartimin e raporteve periodike (tre, gjashtë, nëntëmujore dhe vjetore) të punës së Prokurorit të Shtetit, gjithashtu edhe raporte analitike, krahasuese dhe të punës së mekanizmave të ndryshëm të sistemit prokurorial.

9.2.1. Mbështetja e komisioneve të Këshillit

ZMA-ja ka ofruar mbështetje të vazhdueshme për Këshillin, Prokurorin e Shtetit, komisionet e përhershme dhe ad hoc të Këshillit, si dhe Sekretariatit (SKPK), si në vijim:

- ZKPSH-në, në raporte statistikore për Konferencën Vjetore të Prokurorëve si dhe Raportet e rregullta tremujore, gjashtëmujpre, nëntëmujore si dhe vjetore;
- Këshillin dhe Sekretariatit në hartimin e draftit të Planit të Punës për vitin 2023 dhe Raportin e punës për vitin 2022;
- Komisionin për Vlerësim të Performancës së Prokurorëve (KVPP) gjatë vlerësimit të performancës së prokurorëve përmes ofrimit të informatave të kërkuara;
- Komisionin për Administrimin e Prokurorive si komision i përhershëm në organizimin e takimeve dhe vizitave në terren të Komisionit dhe hartimin e raporteve analitike dhe krahasuese për Komisionin;
- Komisionin për Çështje Normative, si komision i përhershëm, për hartimin e draft rregulloreve të përcaktuara me planin e punës së Komisionit dhe Këshillit;

9.2.2. Hartimi i raporteve

Gjithashtu, ZMA-ja ka hartuar raporte pune, analitike, krahasuese dhe raporte të tjera, si më poshtë:

- Raporti i punës së Prokurorit të Shtetit për vitin 2022;
- Raportet periodike (3, 6 dhe 9 mujore) të punës së Prokurorit të Shtetit për vitin 2023;
- Raport për përputhshmërinë dhe saktësinë e shënimeve nga regjistri fizik në krahasim me SMIL-in për lëndët e ndryshme penale (PPN);

- Raport krahasues për numrin e lëndëve nga raportet fizike dhe SMIL-i për tremujorin e parë 2023;
- Raport analitik me ndryshimet e Kodit të procedurës penale dhe nevojat e rritjes së numrit të prokurorëve në Prokurorinë e Apelit;
- Raport me numrin e rasteve të ngarkuar në Departamentin për Krime të Rënda të Prokurorisë Themelore në Prishtinë, konkretisht në Njësitin për krime ekonomike dhe korrupsion;
- Raport analitik për ngarkesën e prokurorive me lëndë për tremujorin e parë 2023 krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2022 (ky raport është pjesë e Planit të Punës së KPK-së për vitin 2023);
- Raport për numrin (më të lartë) të prokurorëve që kanë pasur prokuroritë themelore gjatë periudhës 6 vjeçare (2017-2022) sipas kërkesës së Komisionit për Administrimin e Prokurorive;
- Raport krahasues të lëndëve të raportuara nga Shkrimorja dhe prokurorët për të gjitha PTH sipas kërkesës së Komisionit për Administrimin e Prokurorive dhe krahasimin me lëndët e regjistruara në SMIL;
- Raporte për ngarkesën me lëndë të prokurorive, departamenteve dhe prokurorëve si dhe numrin e nevojshëm të prokurorëve nëpër prokurori;
- Raport informues për partnerë ndërkombëtarë, lidhur me numrin e përgjithshëm të prokurorëve dhe anëtarëve të KPK-së, moshën, strukturën etnike, gjinore dhe nivelit të prokurorive për periudha konkrete kohore;

9.2.3. Aktivitete të tjera

Përveç mbështetjes për Këshillin dhe komisionet, hartimit të raporteve të ndryshme analitike dhe krahasuese, ZMA-ja ka realizuar edhe aktivitete të tjera, si më poshtë:

- janë mbajtur takime dhe janë dhënë komentet përkatëse për funksionimin e moduleve të zhvilluara nga kompania në databazën SEMDP si dhe forma e raporteve;
- janë përditësuar shënimet në databazën SEMDP që kanë të bëjnë me avancimin dhe transferimin e prokurorëve;
- janë hartuar raportet statistikore infografike për uebportalin e sistemit prokurorial;
- janë dhënë komentet dhe rekomandimet për zhvillimin e formave të raporteve statistikore, të cilat do të zhvillohen për përdorim në SMIL;
- janë hartuar raportet për buletine për aktivitetet e realizuara nga ZMA/NJSHPP-ja;
- është përgatitur raport informues lidhur me aktivitetet e realizuara nga ZMA/NJSHPP të përcaktuara me Planin Strategjik të sistemit prokurorial 2022-2024;
- është përgatitur raport për zbatimin e Planit të Punës së KPK-së për periudha të caktuara të vitit 2023, në aktivitetet ku ka qenë i përfshirë ZMA/NJSHPP;

- pjesëmarrje në takime pune, punëtori, tryeza pune dhe trajnime për ngritje të kapaciteteve dhe rritjen e performancës në punë;
- janë realizuar edhe aktivitete të tjera sipas kërkesave të autoriteteve kompetente të sistemit prokurorial të Kosovës.

9.3. Zyra për Statistika

Zyra për Statistika (më tej: ZS) gjatë vitit 2023 ka kryer punët sipas Planit të punës të ZS-së, si dhe punët e tjera nga kompetenca e përcaktuar me Rregulloren e NJSHPP-së. ZS, gjatë kësaj periudhe, ka grumbulluar të dhëna statistikore për punën e prokurorive dhe prokurorëve, ka përpunuar ato dhe ka hartuar-përpiluar raporte statistikore dhe narrative (përshkruese) në baza: mujore, periodike (tremujore, gjashtëmujore, nëntëmujore) dhe vjetore. Ka mbështetur me të dhëna të nevojshme statistikore Komisionet e përhershme të KPK-së; Koordinatorët nacional për luftimin e krimit, sipas grupeve të veprave penale, të caktuar nga KPK. Po ashtu, ZS, ka mbështetur dhe DTI-në gjatë fazës së implementimit të SMIL në veçanti Modullit për Statistika.

ZS ka ofruar mbështetje profesionale dhe të dhëna statistikore për komisionet e përhershme të KPK-së, Koordinatorët nacional për luftimin e krimit sipas grupeve të veprave penale, DTI dhe ZMA, si në vijim:

- Komisioni për vlerësimin e performancës së prokurorëve është mbështetur me informata dhe të dhëna statistikore specifike, për punën e 54 prokurorëve, të cilët gjatë këtij viti i janë nënshtruar procesit të vlerësimit të performancës;
- Komisioni për Administratë është mbështetur me të dhëna statistikore për gjendjen numerike të rasteve, sipas departamenteve dhe llojeve të regjistrave, po ashtu ky Komision është mbështetur edhe gjatë vizitave monitoruese që ndërliken me implementimin e SMIL-it;
- Zyra e Koordinatorit Nacional për Luftimin e Krimeve Ekonomike është mbështetur me të dhëna statistikore dhe informata nga Grupi i këtyre veprave penale;
- Koordinatori Nacional për Luftimin e Trafikimit të Qenieve Njerëzore është mbështetur me të dhëna statistikore për rastet dhe personat nga ky grup i veprave penale. Po ashtu, ZS-ja ka grumbulluar edhe të dhëna specifike statistikore për këto vepra, sipas kërkesave nga DASH-i (Departamenti Amerikan i Shtetit);
- Koordinatori Nacional për Luftimin e Veprave Penale të Korrupsionit është në mbështetje të vazhdueshme nga ZS-ja me të dhëna të ndryshme statistikore për këtë grup të veprave penale;
- Departamenti i Teknologjisë Informative është mbështetur gjatë implementimit të SMIL-it, konkretisht modullit të raporteve statistikore nga katër zyrtarë të ZS-së, të cilët në cilësinë e anëtarëve të Grupit punues për monitorimin e zbatimit të SMIL-it kanë dhënë kontribut gjatë vizitave të planifikuara në prokurori, në të cilat janë identifikuar pengesat dhe problemet gjatë implementimit të SMIL-it;

- Sipas Vendimit nr.415/2023 i datës 15 mars 2023, është themeluar grupi punues për monitorimin e zbatimit të SMIL-it, ku janë caktuar si Mbikëqyres të Regjioneve zyrtarët e ZS-së. Zyrtarët e ZS-së kanë bërë monitorimin për zbatimin e SMIL-it në prokuroritë përkatëse, ku janë caktuar me Vendim. Zyrtarët e ZS-së kanë gjeneruar të dhënat statistikore mujore nga SMIL-i dhe kanë bërë krahasime me raportet fizike;
- ZS përpilon raporte statistikore periodike për Dhunë në Familje sipas kërkesave të Koordinatorës për Dhunë në Familje;
- Zyrtarët e ZS-së rregullisht bëjnë testimin e raporteve që gjeneron SMIL-i dhe rregullisht njoftojnë DTI-në në lidhje me problemet e shfaqura (deri më tani asnjë raport statistikor i gjeneruar nga SMIL-i, nuk përdoret për raportim zyrtar);
- ZMA-ja dhe ZS-ja bëjnë një punë të përbashkët në verifikimin e të dhënave statistikore të raportuara. ZS, sipas nevojës dhe kërkesës, këtë zyrë e mbështet në aspektin teknik dhe profesional në përdorimin e të dhënave statistikore si dhe interpretimin e tyre.

Zyra për Statistika gjatë vitit 2023 ka grumbulluar të dhëna statistikore, i ka përpunuar dhe ka përpiluar raporte statistikore standarde dhe të veçanta, në baza mujore, periodike dhe vjetore, sipas llojeve në vijim:

- Raportet mujore statistikore, për ngarkesën e prokurorëve me lëndë si dhe efikasitetin në zgjidhjen e tyre, sipas departamenteve dhe llojit të regjistrave, për secilin prokuror veç e veç, të prokurorive themelore, Prokurorisë Speciale dhe Prokurorisë së Apelit;
- Raportet statistikore për gjendjen numerike të rasteve në prokurori sipas prokurorive, departamenteve si dhe sipas llojit të regjistrave;
- Raportet statistikore për gjendjen numerike të rasteve sipas grupeve të veprave penale nga mekanizmi përcjellës nga regjistri PP dhe PPN;
- Raportet vjetore statistikore për përqindjen e përmbushjes së Normës Orientuese për vitin 2023, për 179 prokurorë të prokurorive themelore, Prokurorisë Speciale dhe Prokurorisë së Apelit. Raporti me normën e llogaritur për secilin prokurorë është vendosur si dokumentacion në Dosjen personale në sistemin elektronik (SEMDP);

Raportet periodike statistikore të cilat pasqyrohen për secilën prokurori dhe departament: tremujore, gjashtëmujore, gëntëmujore dhe vjetore:

- Raporte standarde për punën e prokurorive themelore dhe PSRK, për:
 - kryes të veprave penale me persona madhor (PP);
 - kryes të veprave penale persona të mitur (PPM);
 - kryes të panjohur të veprave penale (PPP);
 - pretendimet për kryerjen e veprave penale (PPN, PPNM);
 - ndihmë juridike ndërkombëtare (NJN);

- raportet për aplikimin e procedurave alternative;
- raportet për integritet evropian, veprat penale: dhunë në familje, kundër komunitetit të gazetarëve dhe Komunitetit LGBTI.
- Raporte statistikore për punën e Prokurorisë së Apelit sipas departamenteve dhe llojit të regjistrave;
- Raporte statistikore për punën e Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, sipas llojeve të regjistrave;
- Raporte standarde për grupet e veprave penale nga Mekanizmi përcjellës, siç janë: armët, droga, krimi i organizuar, krimet ekonomike, korrupsioni, kontrabanda e migrantëve, shpëlarje e parave, veprat penale të motivuara nga urrejtja dhe trafikimi i qenieve njerëzore;
- Raporte përshkruese për punën e prokurorive dhe veprave penale karakteristike nga Mekanizmi përcjellës;
- Raporte të veçanta:
 - Raporte statistikore për shqiptimin e masave të diversitetit për persona të mitur-fëmijë sipas: gjinisë, grupmoshave, llojit të masës së shqiptuar, llojit të veprës penale si obligim ndaj Ministrisë së Drejtësisë (raport vjetor);
 - Regjistri-lista-raportit statistikor për veprat penale të trafikimit të qenieve njerëzore duke përfshirë edhe të dhënat për viktimat: gjinia, mosha, shtetësia, qëllimi i trafikimit, periodike dhe vjetore për nevojat e Koordinatorit Nacional për Luftimin e Veprave Penale të TQNJ-së.
- Raporte statistikore periodike, për të drejtat e njeriut-DASH:
 - Raport statistikor për veprat penale ku viktima janë GRATË, lëndët penale me kryes të MADHOR (PP);
 - Raport statistikor për veprat penale ku viktima janë GRATË, lëndët penale me kryes të MITUR (PPM);
 - Raport statistikor për veprat penale ku viktima janë FËMIJTË, lëndët penale me kryes MADHOR (PP);
 - Raport statistikor për veprat penale ku viktima janë GAZETARËT, ndërsa kryesit e veprave penale janë persona MADHOR (PP);
 - Raport statistikor për veprat penale ku viktima janë FËMIJËT (që kanë kanë të bëjnë me punën e fëmijëve), lëndët penale me kryes MADHOR (PP).
- Raportet për MSA-në;
- Raporte të tjera statistikore, sipas kërkesave:
 - Raporte të veçanta mujore, për rastet dhe personat me vepra penale të korrupsionit për lëndët e pazgjidhura, lëndët e pranuar, lëndët e zgjidhura sipas numrit të lëndës, datës së pranimit të lëndës, parashtruesit të kallëzimeve penale, mënyrës së zgjidhjes, datës së zgjidhjes dhe vendimeve të gjykatave përkitazi me aktet akuzuese sipas kërkesës së IKD-së.

- Raporte të ndryshme statistikore për lloje të ndryshme të veprave penale dhe për periudha të ndryshme kohore, sipas kërkesave të institucioneve kombëtare dhe ndërkombëtare, prokurorëve pjesëmarrës në konferenca dhe punëtori, botës akademike dhe mediave.

9.4. Zyra për Trajnime dhe Zhvillim Profesional

Zyra për Trajnime dhe Zhvillim Profesional gjatë këtij viti, ka zhvilluar aktivitetet për zhvillimin profesional të prokurorëve të shtetit dhe personelit administrativ në sistemin prokurorial, për ofrimin e trajnimeve dhe aktivitetet e edukimit ligjor dhe studime me qëllim të përmirësimit, rritjes së aftësive, shkathtësive dhe njohurive të tyre, që lidhen me detyrat e punës, si vijon:

- Në bashkëpunim me Akademinë e Drejtësisë së Kosovës dhe donatorë të tjerë si institucionet ndërkombëtare siç janë: Ambasada Amerikane në Prishtinë, Këshilli i Evropës dhe BE-ja, ka koordinuar aktivitetet për ngritjen profesionale të prokurorëve dhe personelin administrativ të prokurorëve;
- Hartimi i dokumentit për Monitorimin e procesit të zhvillimit profesional në sistemin prokurorial për “Mbrotjen e fëmijëve nga dhuna”;
- Ka koordinuar punën me Kryeprokurorët, administratorët, Drejtorin e Përgjithshëm të SKPK-së dhe Drejtorin e NJSHPP-së me qëllim të vlerësimit të nevojave për trajnimin e prokurorëve dhe stafit administrativ në sistemin prokurorial të Kosovës;
- Ka hartuar planin e detajuar për nevojat e trajnimit për prokurorët dhe personelin administrativ të sistemit prokurorial;
- Ka hartuar dokumentin e politikave të trajnimit ku përcaktohen, parimet, objektivat, përmbajtja, metodologjia dhe kornizat e programit trajnues për prokurorët dhe personelin administrativ;
- Në kuadër të Sistemit Elektronik për Menaxhimin e Dosjeve të Prokurorëve (SEM DP) janë regjistruar dhe përditësuar me kohë të gjitha aktivitetet trajnuese për prokurorë;
- Ka hartuar raportet periodike për pjesëmarrjen e prokurorëve në aktivitetet e edukimit ligjor;
- Ka hartuar raporte për pjesëmarrjen e prokurorëve në trajnime sipas kërkesës së KVPP-së për 54 prokurorë që i janë nënshtruar procesit të vlerësimit të performancës;
- Ka hartuar raporte për pjesëmarrjen e prokurorëve në trajnime e që i janë nënshtruar procesit të avancimit dhe transeferimit të prokurorëve për Komisionin për transferim dhe avancim të prokurorëve, janë ofruar të dhënat për gjithsejt 54 prokurorë;
- Ka hartuar raportin për Kordinatorin kombëtar kundër krimeve ekonomike me të dhënat për pjesëmarrjen e prokurorëve në trajnime me temën “Programi i specializuar i trajnimit për pastrim të parave”.

10. Sfidat

Gjatë veprimtarisë së Këshillit për vitin 2023 sfidat kryesore ishin:

- Mosplotësimi i përbërjes së Këshillit me dy (2) anëtarë joprokurorë, që me hyrjen në fuqi të Ligjit për Këshillin Prokurorial në prill vitit 2019, nuk është përgjegjësi e Këshillit as përzgjedhja dhe as procedurat teknike të shpalljes së konkursit;
- Buxheti i pamjaftueshëm për të mbuluar të gjitha obligimet e krijuara;
- Pengesat në dekretimin e Kryeprokurorit të Shtetit;
- Ndërmarrja e aktiviteteve të shumta për mbrojtjen e pavarësisë së Këshillit dhe Prokurorit të Shtetit që ndërlidhen me iniciativat për ndryshime ligjore;
- Shkarkimi i anëtarit jo prokurorë të Këshillit nga ana e Kuvendit;
- Vendimi i Qeverisë për uljen e pagave të prokurorëve;
- Specializimi i prokurorëve për trajtimin e krimeve karakteristike (korrupsioni, krimi i organizuar, krimi ekonomik dhe krimet kibernetike);
- Mosrespektimi i parimit të transparencës përmes disa publikimeve mediale që ndikojnë drejtpërdrejt në dëmtimin e besimit të publikut në sistemin prokurorial;
- Infrastruktura fizike (zgjerimi i hapësirave për Këshillin dhe Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit) dhe
- Ngritja e kapaciteteve profesionale të personelit të sistemit prokurorial.

